



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 NËNTOR 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 30. NOVEMBRA 2015. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mjekësinë ligjore,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patentë shofer,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet,
19. Zgjedhja e një anëtar i joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
20. Zgjedhja e një (1) anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
21. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të Posaçëm për zgjedhjen e dy gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
22. Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës,
23. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
24. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor, të misionëve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës,
25. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014,
26. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015,
27. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për personat e verbër,
28. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014,

29. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integritetit Evropiane për vitin 2014,
30. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të performancës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare, si dhe raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014,
31. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014,
32. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit,
33. Kërkesa e kryetarit të Komunës së Prishtinës për dhënien e pëlqimit për rinovimin e sheshit “Adem Jashari” në Prishtinë,
34. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
35. Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma između Vlade Republike Kosova i Vlade Velikog vojvodstva Luksemburga,
5. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji bilateralnog sporazuma između Vlade Kosova i Vlade Velikog vojvodstva Luksemburga o projektu saradnje za razvoj: “KSV/018: Institucionalna i tehnička podrška za sistem vodosnabdevanja u regionu Mitrovica”,
6. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-048 o menadžiranju javnih finansija i odgovornostima, izmenjen i dopunjen zakonima br. 03/L-221, br. 04/L-116 i br. 04/L-194,
7. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona br.04/L-042 o javnoj nabavki Republike Kosova, izmenjen i dopunjen zakonom br.04/L-237,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Generalnom revizoru i Nacionalne kancelarije za reviziju u Republici Kosovo,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o upravljanju zaplenjenom i konfiskovanim imovinom,
10. Prvo razmatranje o reguliranim profesijama u Republici Kosova,
11. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 02/L-31 o verskoj slobodi na Kosovu,
12. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-224 o tužilačkom savetu Kosova,
13. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sudskoj medicini,
14. Prvo razmatranje Nacrta zakona o vozačkoj dozvoli,
15. Prvo razmatranje Nacrta zakona o spoljnoj službi Republike Kosovo,
16. Prvo razmatranje Nacrta zakona o statusu i pravima paraplegičara i tetraplegičara,
17. Drugo razmatranje Nacrta zakona o ličnoj karti,
18. Drugo razmatranje Nacrta zakona o osiguranjima,

19. Izbor jednog neizvršnog člana Odbora Centralne banke Republike Kosova,
20. Izbor jednog člana Borda Radiotelevizije Kosova,
21. Razmatranje Preporuke Posebne komisije za izbor dvoje (2) sudije u Ustavnom sudu Republike Kosova,
22. Imenovanje predsedavajućeg i članova Rukovodećeg borda Kosovskog penzijskog fonda za štednju,
23. Imenovanje članova Saveta za besplatnu pravnu pomoć,
24. Razmatranje Izveštaja Komisije za spoljne poslove o nadgledanju sprovođenja Zakona o konzularnoj službi, diplomatskoj i konzularnoj misiji Republike Kosova,
25. Razmatranje Izveštaja Regulativnog autoriteta za elektronsku i poštansku komunikaciju za 2014. god.,
26. Razmatranje Izveštaja o životnoj sredini na Kosovu za 2015. god.
27. Razmatranje Izveštaja Komisije za ljudska prava, ravnopravnost polova, nestala lica i peticije o nadgledanju sprovođenja Zakona o slepim licima,
28. Razmatranje Godišnjeg finansijskog izveštaja Kancelarije generalnog revizora za 2014. godinu,
29. Razmatranje preporuka u vezi izveštaja o reviziji finansijskih pregleda Ministarstva za evropske integracije za 2014. god.,
30. Razmatranje preporuka u vezi izveštaja o reviziji performanse o održavanju i servisiranju službenih vozila, kao i Izveštaja o reviziji finansijskih pregleda Ministarstva za javnu administraciju, Sudski savet Kosova, Carine Kosova i Kosovske policije za 2014. god.,
31. Razmatranje preporuka u vezi izveštaja o reviziji Kancelarije generalnog revizora za 2014. god.,
32. Razmatranje preporuka Komisije za ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju, u vezi aktuelnog položaja proizvođača i prerađivača mleka,
33. Zahtev predsednika Opštine Priština za davanje saglasnosti za renoviranje Trga "Adem Jashari" u Prištini.
34. Formiranje Ad hoc Komisije o izboru kandidata za članove Borda Radiotelevizije Kosova,
35. Predlog PG Srpske liste o zameni članova u parlamentarnim komisijama.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës së sotme plenare, sipas rendit të ditës.

Opozitë e nderuar, ju kisha lutur të jemi të qetë, të jemi dinjitozë. Është javë me rëndësi. Kemi vizitë shumë me rëndësi. Mos e inkriminoni vetveten! Mos e përjashtoni vetveten!

Prapë ia filluat!

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

Pauzë! Ju lutem, pauzë! Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare! Pauzë! Ju lutem, të qetë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Zoti zëvendëskryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës së sotme plenare, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Paraprakisht më lejoni ta konstatoj numrin e deputetëve. Janë gjithsej 81 deputetë të pranishëm në sallë. Realisht, kolegët tanë të nderuar të opozitës, po shihet pjesa më e madhe e tyre janë duke e vetëpërfshirur vetveten, qoftë me përdorimin e gazit lotsjellës, qoftë me pengimin e mbajtjes normale të seancës. I ftoj më që të vijnë të marrin pjesë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku e kanë vendin, në mënyrën që të kemi debat të përbashkët për interesa të qytetarëve tanë. Vërtet kjo nuk është pamje e mirë, por ne jemi të obliguar të vazhdojmë, edhe në bazë të Rregullores së Kuvendit, i plotësojmë të gjitha kushtet që seanca ta vazhdojë punën e vet parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Nuk ka asnjë të lajmëruar.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 16 pyetje parlamentare.

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Nuk është këtu. Deputetja Blerta Deliu-Kodra, pyetje për ministrin Lutfi Zharku. Dëshironi ta bëni pyetjen deputete? Jo! Deputeti Pal Lekaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Nuk është këtu. Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi. Nuk është këtu. Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Nuk është këtu. Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Nuk është këtu. Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Nuk është këtu. Deputeti Faton Topalli, pyetje për ministrin Arban Abrashi. Nuk është këtu. Deputetja Aida Dërguti, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Nuk është këtu. Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Nuk është këtu. Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Nuk është këtu. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Kujtim Shala. Urdhëro, i nderuar deputet!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Po e thej më pak akullin.
I nderuar ministër,

Në fillim të vitit 2015, takimin që e kemi mbajtur së bashku me Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, bazuar edhe në rekomandimet e Kuvendit të Kosovës e kemi aprovuar agjendën legislative ku ka qenë e planifikuar që në sesionin e parë pranveror miratimi dhe dërgimi, sjellja nga ju e Projektligjit për sponsorizim. Projektligji për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre dhe Projektligji kundër organizimit dhe dukurive tjera negative në sport, por deri më tani, me përjashtim që këto ditë ka arritur Ligji kundër huliganizmit.

Gjithashtu në muajin mars 2014 Qeveria ka vendosur për ndërtimin e Stadiumit Kombëtar prej 25 mijë deri 30 mijë ulëse. Në buxhetin e vitit 2015 janë ndarë mjetet për financimin e këtij projekti, mirëpo deri më tani punët për këtë stadium kanë ngecur dhe siç shihet që edhe në vitin 2016 do të kemi ngecje në këtë projekt. Shqetësuese është edhe ngecja në projektet tjera infrastrukturore, projekti i shtigjeve të atletikës dhe sistemi i ujitjes në Mitrovicë, më duket se nuk do të përfundojë as në këtë vit dhe sigurisht që as vendosja e reflektorëve nuk do të bëhet, edhe pse kanë qenë të planifikuara, buxheti i këtyre reflektorëve do të shkojë në suficit dhe kjo është shumë shqetësuese për arsye se Stadiumi i Mitrovicës nuk do të jetë i gatshëm për gara ndërkombëtare dhe kur ta kemi parasysh që ministria vitin e ardhshëm bashkë me Komunën do t'i fillojë edhe investimet në Stadiumin e Prishtinës dhe në pranverë do të kemi ndërtime, punime në Stadiumin e Qytetit në Prishtinë, atëherë kjo mbetet shumë shqetësuese.

I nderuar ministër, kur pritet që viti 2016 të jetë vit i futbollit dhe i shpërthimit në arenën ndërkombëtare, këto ngecje që i ka bërë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, atëherë seriozisht rrezikohet mbarëvajtja e këtyre garave ndërkombëtare.

Prandaj, kërkoj nga ju që të jepni një sqarim lidhur me këtë.

KRYETARI: Urdhëro, i nderuar zëvendëskryeministër për përgjigje.

ZËVENDESKRYEMINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti deputet,

Janë shtatë çështje, unë do të përpiqem të jap përgjigje shumë shkurt.

Projektligji kundër huliganizmit është miratuar nga Qeveria dhe i është dërguar Komisionit Parlamentar.

Projektligji për sponsorizim dhe donacione është dërguar për deklaratë financiare dhe shumë shpejt do t'i përcillet Qeverisë.

Projektligji për objektet sportive dhe menaxhimin e tyre është në fazën e fundit të draftimit dhe të konsultave.

Punimet në stadiumin olimpiq janë finalizuar sipas kontratës, është edhe faza e katërt e cila s'është kontraktuar, që nënkupton ndriçimin dhe zgjerimin. Sa i takon projektit të renovimit të Stadiumit të Qytetit të Prishtinës, pas negociimit me KRRPPN-në, tenderi publik do të dalë nesër ose pasnesër, do të thotë brenda këtyre dy ditëve.

Ndërkaq sa i takon stadiumit nacional, ne jemi ende në fazën e kompletimit të dosjes, meqë ka pasur pak probleme me titullarin me pronarin e parcelave dhe Zyra Ligjore e Ministrisë, të cilën

e drejtoj unë, është duke negociuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme nëse pronar është Ministria e Punëve të Brendshme dhe për atë do ta kemi një përgjigje shumë shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë. Urdhëro! Deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Për shkak të ndershmërisë, mendoj që Ligji për luftime të dukurive negative dhe Ligji për menaxhimin e objekteve sportive do të duhej që njëkohësisht të vijnë në Kuvend dhe t'i trajtojmë për arsye se janë të lidhura njëra me tjetrën dhe pyetja konkrete është: Nëse për stadiumin në Mitrovicë keni lejuar që mjetet të shkojnë për reflektorët në suficit dhe nuk i keni inplementuar dhe nuk është i gatshëm për gara ndërkombëtare, dhe nëse në pranverë fillojnë ndërtimet në Stadiumin e Prishtinës, pyetja është në stadiumin kombëtar nuk e kemi bërë dhe as nuk duket që do të fillojë së shpejti ndërtimi. Pyetja është: Në vitin 2016, pasi Federata e Futbollit të Kosovës të pranohet në UEFA dhe FIFA, ku do t'i zhvillojë garat ndërkombëtare, duhet shkuar për të luajtur në Tiranë, apo në Shkup?

KRYETARI: Urdhëroni zoti zëvendëskryeministër në qoftë se dëshironi të përgjigjeni.

ZËVENDESKRYEMINISTRI KUJTIM SHALA: Për projektin e zgjerimit dhe të ndriçimit janë kontraktuar tri kompani njëra pas tjetrës, por asnjëra nuk ka qenë në gjendje ta përmbushë projektin dhe ne nuk do të lejojmë që punët të cilat kryhen të mos jenë cilësore. Duhet të kemi një tender ndërkombëtar që ta bëjmë nëpërmjet një kompanie ndërkombëtare dhe ajo do të bëhet shumë shpejt. Garat ndërkombëtare ekipet do t'i fillojnë në shtator dhe ai stadium do të jetë gati. Ndërsa sa i takon Stadiumit të Qytetit të Prishtinës, ai është një projekt i përbashkët me Komunën e Prishtinës dhe ai do të kontraktohet që të finalizohet brenda vitit 2016. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Sipas Ligjit për odat shëndetësore, i miratuar më 3 maj 2013, janë formuar Oda e mjekëve, stomatologëve, farmacistëve, fizioterapeutëve, infermierëve dhe mamive dhe profesioneve tjera shëndetësorë.

Themelimi dhe konstituimi i odave shëndetësore tani është punë e kryer, por përkundër kësaj Ministria e Shëndetësisë nuk ka filluar bartjen e kompetencave të oda sipas ligjit, me çka profesionistëve shëndetësorë do t'u sigurojë pavarësia profesionale dhe qeverisja, e kjo do të mundësonte përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor. Përgjithësisht në nenin 9 dhe 10 të Ligjit janë paraparë kompetencat e odave, të cilat do të duhej të barteshin nga Ministria e Shëndetësisë tek oda.

Gjithashtu, ministria ka qenë e obliguar që një pjesë e stafit administrativ ta bartë tek oda me qëllim të mbarëvajtjes së punës së odave për profesionistët shëndetësorë dhe funksionalizimin e tyre.

Sipas nenit 38 të këtij ligji, mjetet për themelimin dhe funksionimin e odës sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës për fazën kalimtare trevjeçare, mjete të realizuara nga anëtarësia, taksa licencimi dhe ri-licencimi. Mirëpo, deri më tani kjo nuk ka ndodhur nga ministria dhe ka një ngecje për mbarëvajtjen e punës së themelimit të odave. Kryetarët e odave të zgjedhura ende nuk paguhen dhe nuk e kemi një konstituim të mirëfilltë të tyre.

Prandaj, i nderuar ministër, pyetja është: Kur do të përfundojë konstituimi i odave të profesionistëve shëndetësorë dhe kur Ministria e Shëndetësisë do t'i bartë kompetencat e parapara sipas Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë? A mund të na njoftoni nëse Ministria e Shëndetësisë është duke i grumbulluar mjetet për funksionimin e odave sipas Ligjit për odat e profesionistëve shëndetësorë dhe kur pritet që ju t'i siguron kushtet elementare për punë dhe udhëheqje të odave të profesionistëve shëndetësorë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputetë, faleminderit për pyetjen!

Është një nga objektivat për të cilat kemi punuar mjaft shumë kohëve të fundit. Ashtu siç e thatë edhe vetë, ka përfunduar procesi zgjedhor dhe konstituimi i pesë odave të profesionistëve shëndetësorë. Kohëve të fundit ky proces po mbyllet me sukses shumë të mirë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike dhe të tjerat ne kemi siguruar hapësira të nevojshme të ish-objektit të "Rilindjes" për akomodimin e pesë odave dhe funksionimin normal të tyre. Tash do të kalojmë, pas zgjidhjes së disa dilemave në krijimin e sekretarisë, e cila do të jetë mbështetëse në funksionimin e odave.

Natyrisht që parashihen që diku të jenë aty rreth 20 vende pune. I kemi disa dilema me odat dhe jemi duke u koordinuar me odat. Kohëve të fundit jemi dakorduar që t'i bëjmë nën-kodet dhe mjetet të grumbullohen në nën-kode, në funksion të krijimit të buxhetit për funksionimin normal të odave.

Natyrisht që ka ende punë për t'u bërë, mirëpo ne jemi afër fillimit të bartjes së kompetencave varësisht prej ngritjes së kapaciteteve që duhet ta dëshmojnë odat. Disa nga odat kanë votuar dhe i kanë miratuar statutet e tyre dhe janë duke punuar në krijimin e dokumenteve tjera operative.

Dhe, për fund, them që të deleguarit e odave janë nëpër komisione dhe nëpër borde përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë për ta krijuar përvojën për bartjen, respektivisht për marrjen dhe ushtrimin e obligimeve dhe kompetencave sipas ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Slavko Simiq, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi. I nderuar deputet, ministri këtu nuk është. Faleminderit! Nuk do ta lexosh. Deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër Thaçi, Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Për të folur shkurt, ministri veç e ka pyetjen në formën e shkruar, unë vetëm do ta kisha plotësuar, e pyetja ka të bëjë: A do t'u mundësohet këtyre banorëve qasja në autostradën në fshatin ..., zoti ministër, e nëse po kur do të ndodhë kjo? Sa për informacione tjera, Komuna e Mamushës nuk ka problem me çështjen pronësore. Buxheti i Komunës është ndarë për kyçje dhe mendoj se kyçja është e mundur nëse lejohet nga ministria përkatëse për arsye se ekziston edhe ura mbi autostradë në fshatin Po ashtu, një pjesë e madhe e asfaltit është shtruar, ka mbetur përafërsisht edhe një kilometër e gjysmë deri te autostrada. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, i nderuari zoti ministër.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,
Të nderuar deputetë,

Projekti i autostradës ER7 i ka përcaktuar zhvillimin e autostradës si një investim me prioritet të lartë. Për këtë projekt është themeluar Komiteti Ndërministror, i cili ka menaxhuar me ecurinë e përgjithshme të projektit dhe ka marrë vendime adekuate.

Gjatë fazave të projektimit të trasesë së autostradës janë punuar raportet e ndikimit social dhe mjedisor, si dhe është bërë studimi i fizibilitetit për lokacionet e kyçjeve dhe trasenë e autostradës, duke marrë parasysh parametrat teknikë dhe ekonomikë të zonave përgjatë korridorit të autostradës.

Në këto studime janë shqyrtuar zgjidhjet optimale për të gjithë banorët, përfshirë edhe ata të Komunës së Mamushës.

Të gjitha kyçjet dhe traseja e autostradës janë të aprovuara nga Komiteti Ndërministror, të cilat përfshijnë edhe sheshet e pagesave që do të aplikohen në të ardhmen.

Ministria e Infrastrukturës e ka shqyrtuar kërkesën e Komunës së Mamushës dhe ju njofton se nuk ka në plan të lejojë kyçje apo ndërhyrje të reja në autostradën "Ibrahim Rugova", pasi intervenimet e tilla do ta dëmtonin funksionalitetin e autostradës.

Kjo kyçje do t'i cenonte standarde teknike të parapara për autostrada, kurse në anën tjetër do ta hapte një proces zinxhiror të kërkesave nga banorët e fshatrave tjera përgjatë autostradës, e të cilat është e pamundur të plotësohen.

Komuna e Mamushës ka qasje në autostradë nëpërmjet të rrugëve nacionale, të cilat janë të lidhura me nyjat ekzistuese. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, deputet! Ke pyetje shtesë?

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit për përgjigjen, zoti ministër!

Ne diskutuam dhe sqarova. Ajo çka është pozitive nga Komuna e Mamushës, vetë buxhetin e ka përcaktuar dhe e ka ndarë. I ka mjetet për buxhet, ata kanë kërkuar vetëm kyçje dhe mendoj se për aspektin ekonomik dhe lidhjet tjera, qasja prej komunës së Mamushës për Prizren duhet mbi

11 kilometra, apo deri 16 km, varësisht nga fshatrat, sepse janë 17 fshatra, janë rreth 22 mijë banorë, por me autostradë kyçja bëhet për tre kilometra. Kjo është ajo që kërkojnë ata për të pasur lehtësim shumë më të shpejtë, më të mirë, më ekonomik dhe më fleksibil. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër! Megjithëse është e vetmja komunë në Kosovës që e prek autostrada, e që nuk lidhet, është një çështje e cila duhet adresuar më seriozisht. Faleminderit!

Nuk ka pyetje tjera.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Të nderuar deputetë,

Nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 15, 23 e 24 tetor, më 2 nëntor dhe 17 nëntor, urdhëroni! Nëse nuk ka vërejtje, sa po shoh nuk ka, vazhdojmë.

Konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 15, 23 e 24 tetor 2015, më 2 nëntor 2015 dhe procesverbalin e seancës së jashtëzakonshme, të mbajtur më 17 nëntor 2015.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentin e propozuar.

Ministri i Shëndetësisë, zoti Imet Rrahmani, ftohet që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Ai shkoi.

Atëherë nga Qeveria nuk është dikush.

Kryetari i Komisionit Funkcional, zoti Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandime, urdhëro!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse kemi dy ratifikime për të njëjtën çështje, ky është besoj ratifikimi që ka të bëjë me çështjen e programit për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë, faza e dytë. Komisioni për të e ka bërë një amendament në fund, nëse jam i saktë, që Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për projektin e bashkëpunimit për Zhvillim KSV/017, programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë, faza e dytë, kështu duhet të jetë. Komisioni e ka shqyrtuar dhe e ka mbështetur në parim aprovimin e kësaj marrëveshjeje, e cila duhet të votohen në seancë më 2/3. Fjala është për 6 milionë euro, të cilat Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut do t'ia ofrojë Kosovës në realizimin e këtij projekti të fazës së dytë.

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë ka ardhur ministri i Shëndetësisë. Urdhëro, zoti ministër, bëje arsyetimin e projektligjit.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Marrëveshja KSV/017, programi i përkrahjes për shëndetësinë e Kosovës, e arritur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Qeverisë së Dukës së Madhe të Luksemburgut është e bazuar në marrëveshjen kornizë ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës së Madhe të Luksemburgut, e arritur më 23 prill 2013.

Projekti KSV/017 synon të kontribuojë në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore nëpërmjet përmirësimit të planifikimit, të udhëheqjes dhe të ngritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përkrahjes në arritjen e synimeve të reformës në shëndetësi.

Projekti synon t'i arrijë këto rezultate: T'i përmirësojë kapacitetet institucionale dhe organizative të institucioneve shëndetësore në funksion të përmbushjes së rolit dhe përgjegjësi të tyre; ta përmirësojë performansën dhe kualitetin e shërbimeve shëndetësore në institucione shëndetësore të sektorit publik dhe ta përmirësojë dhe ngrejë sistemin e informimit shëndetësor të integruar në të gjitha institucionet publike shëndetësore, përfshirë këtu edhe pjesën e pilotuar këtë vit, domethënë vitin 2015.

Projekti KSV/017 përkrahet nga Qeveria e Luksemburgut në vlerë prej 6 milionë euro, ndërsa Ministria e Shëndetësisë është e zotuar se do të kontribuojë në zhvillimin e këtij projekti në lartësi prej 3,6 milionë euro.

Ratifikimi i këtij projekti mundëson fillimin e implementimit dhe me këtë sigurohet baza materiale për zhvillimin e plotë të projektit të sistemit të integruar të informimit shëndetësor, por edhe të sistemit të formimit të fondit të sigurimeve shëndetësore si pjesë integrale e SISH-it.

Prandaj, për të mos e zgjatur, të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës, duke pasur në konsideratë nevojën dhe efektet të këtij projekti, ju sugjeroj ta përkrahni procesin e ratifikimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kush ka problem me kartelë, ndërmoni vendet, vendosini që ta kemi praninë.

Tani radhën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare në qoftë se dëshirojnë të deklarojnë. Safete Hadërgjonaj është lajmëruar nga Partia Demokratike e Kosovës.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës së Madhe të Luksemburgut dhe ka arritur në përfundim që ta përkrahë këtë projektligj. Njëkohësisht e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ta ratifikuar këtë projektligj për marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës së Madhe të Luksemburgut dhe njëkohësisht e përkrah edhe amendamentin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të cilin e kemi në rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismet Beqiri, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah ratifikimin e këtij projektligj, njëkohësisht edhe rekomandimin e Komisionit lidhur me këtë projektligj dhe ne do të votojmë për. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk është këtu. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nuk është këtu. Nga Grupi Parlamentar Lista serbe, zoti Slavko Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče Vlade, poštovani ministri, dame i gospodo narodni poslanici, I Poslanička grupa Srpske liste razmatrala ovaj Nacrt sporazuma između Kosova i Vlade Velikog vojvodstva Luksemburga, i mi ćemo glasati za ovaj Nacrt sporazuma, i takođe podržavamo amandman koje je predložila Komisija za budžet i financije. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Fikrim Damka nga “6+” e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Nisma” nuk është këtu. Nuk kemi deputetë të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë, nëse e kërkon fjalën, apo se konsideron më të arsyeshme.

Do t’i them këshillat juridike për këtë vendimmarrje.

Në bazë të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e 2/3 të të gjithë deputetëve i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare. Pra, ratifikimi i marrëveshjes kërkon së paku 80 vota për.

Ndërsa në bazë të Rregullores së Kuvendit, neni 60, paragrafi 3, procedimi i projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë, i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Të nderuar deputetë,

Po lëvizin, më herët ishin 81 të pranishëm me kartela, tash janë 80. Sa vetë janë pa kartela? 79-80. Jemi 79 apo 80, se po lëvizin kartelat. 80 jemi aktualisht.

Urdhëro, zoti Osmani ndërkohë e ka kërkuar fjalën.

NASER OSMANI: Kryetar!

Është me rëndësi që kur të hidhet në votim marrëveshja të precizohet që ajo votohet së bashku me amendamentin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Jemi gjithsesi në atë pjesën e procedurës, do ta futim në rend të parë amendamentin në votim, po dëshiroj ta dimë sa jemi të pranishëm.

80 deputetë janë me kartelë të pranishëm në sallë. E si është e mundur një pa kartelë, atëherë? Ajo zonja po thotë ‘jam pa kartelë’, gjersa ne i kemi 80 të pranishëm me kartelë. Atëherë, e presim edhe deputetin Rashiq të vijë. I kemi 80 deputetë të pranishëm me kartelë dhe një është pa kartelë, që do të votojë me dorë.

I kemi 81 deputetë të pranishëm me kartelë. Të gjithë janë me kartelë. A ka ardhur edhe deputeti Rashiq? Atëherë, të pranishëm të gjithë në sallë jemi 81 deputetë. Vazhdojmë me votimin e amendamentit të propozuar nga Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa. Është vetëm një amendament, nuk po e lexoj. E lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim për amendamentin. Jemi duke votuar! Votojmë tash!

Atëherë, i kemi 81 deputetë që kanë marrë pjesë në votim, 80 kanë votuar për, zero-zero, as nuk ka kundër, as abstenim.

Vetëm pak, do ta qartësojmë këtë situatë. 81 deputetë i kemi të pranishëm në sallë me kartelë, gjersa një deputete lajmërohet se nuk i punon kartela. Si është e mundur, 81 të pranishëm e një pa kartelë? Qartësojeni këtë, s’do të bëjmë gabime procedurale, që të rikthehemi prapë rreth të njëjtës çështje.

Ju kisha lutur qetë që ta qartësojmë. Deputetja lart lajmërohet se nuk ka kartelë. Atëherë, kështu, sipas të gjitha gjasave, mund të ketë edhe kartela të opozitës të futura. 81 janë të pranishëm. Megjithatë, 80 deputetë kanë votuar, amendamenti kalon. Ta kemi parasysh për arsye se 80 vota ashtu-kështu i kemi, por për praninë e kisha lutur Administratën para votimit në tërësi edhe një herë.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentin e miratuar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! 80 vota janë për, dhe e nderuara deputete për me dorë, domethënë plus një votë, d.m.th. 81 vota.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim “KSV/017” programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë, faza e dytë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. E ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, zotëriun Blerand Stavileci që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Bazuar në Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare, i cili, ndër të tjera, e përcakton procedurën e lidhjes, nënshkrimit, ratifikimit dhe zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në Republikën e Kosovës, ju paraqes për shqyrtim dhe aprovim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim, me fokus mbështetjen institucionale dhe teknike për sistemin e furnizimit me ujë në rajonin e Mitrovicës.

Marrëveshja e cila do të ratifikohet nëpërmjet këtij projektligji parasheh që Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Qeverinë e Dukatës së Madhe të Luksemburgut të sigurojë kontribute financiare për implementimin e projektit të furnizimit me ujë në rajonin e Mitrovicës sipas kontributeve të përbashkëta financiare, si në vijim: lirim nga TVSH-ja dhe taksat e importit në kontributet e Luksemburgut në vlerë prej 774 mijë eurosh, kontributet financiare nga Komuna e Mitrovicës 600 mijë, Komuna e Skenderajt 200 mijë dhe Vushtrrisë 300 mijë, si dhe Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut 500 mijë euro.

Ndërsa Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut do të ofrojë në dispozicion mjete financiare për zbatimin e këtij projekti në shumë prej 4,5 milionë eurosh. Meqenëse ky projekt ka për qëllim përmirësimin e furnizimit me ujë për qytetarët që shërbehen nga kompania rajonale e ujësjellësit të Mitrovicës, ju ftoj në miratimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zotëri ministër! E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukës së Madhe të Luksemburgut ka për qëllim financimin e projektit që do të kontribuojë në realizimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë për banorët që shërbehen nga rajoni i Mitrovicës.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut zotohet që të ofrojë në dispozicion mjete financiare apo donacionin në shumë prej 4 milionë e 500 mijë euro, ndërsa Qeveria e Republikës së Kosovës do të monitorojë zbatimin e projektit dhe do të sigurojë 2 milionë e 374 mijë euro, ashtu siç e përmendi edhe vetë ministri.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka vlerësuar rëndësinë e financimit të projektit në bazë të kësaj marrëveshjeje që do të ndihmojë përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë në rajonin e Mitrovicës dhe meqë kostoja financiare është dhe do të jetë pjesë e kornizës buxhetore, i rekomandojmë Kuvendit që ta ratifikojë këtë marrëveshje.

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë e mora një njoftim, por, megjithatë, kush dëshiron prej grupeve parlamentare të shprehet se në parim e përkrahin, ose nga deputetët. Nuk ka. Atëherë, përfaqësuesi i Qeverisë e kërkon fjalën sërish? Këshillat juridike për vendimmarrje janë po të njëjtat me atë të pikës së mëhershme.

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me votimin konstatoj sa deputetë janë të pranishëm në sallë, Regjia, i thërret deputetët mundësisht. Mund të kalojmë në votim kur të bëhen 81 deputetë. Ok! Ziles, regjia!

Shefave të grupeve parlamentare u kisha kërkuar që për hir të kohës t'i mbajnë deputetët se duhen 2/3. Ndërkohë, të nderuar kolegë deputetë, derisa të bëhet numri i deputetëve, të cilët janë të pranishëm në sallë, gjatë kohës sa jemi në seancë, në kohën e pauzës pas një gjysmë ore, të gjithë deputetët do të keni ushqim në pjesën e bufesë. Kuvendi shtron drekë për deputetët dhe për të gjithë mysafirët, edhe për gazetarët.

Atëherë, i kemi 81 deputetë të pranishëm në sallë. Urdhëroni, përgatituni për votim! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

E kemi 1 abstenim, 80 vota për. Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: "KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në rajonin e Mitrovicës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Në bazë të Nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin e Financave zotërinë Abdullah Hoti që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, i nderuari ministër!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes para jush propozim-ndryshimet në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Ky projektligj do të inkluadrojë në Ligjin bazik obligimet që dalin nga marrëveshja që kemi me FMN-në si Qeveri e Kosovës.

Ndryshimi më i madh ka të bëjë me futjen e një rregulle të re fiskale, e cila i mundëson Qeverisë që të hyjë në borxhe ndërkombëtare për të financuar projekte zhvillimore përtej rregullës fiskale prej 2%. Ndryshimi i dytë i rëndësishëm është përcaktimi i një rregulle fiskale, në bazë të së cilës në baza vjetore rriten pagat dhe kjo rritje pagave dhe buxhetit për paga do të jetë në përputhje me mundësitë buxhetore që ka vendi. Ndryshimi i tretë, janë ndryshimet kryesisht teknike sa i përket organizimit më të mirë të Ministrisë së Financave, të disa departamenteve sa i përket unifikimit të shërbimeve të përbashkëta, rregullimit të departamenteve të buxhetit, menaxhimi i llogarive bankare të ambasadave jashtë vendit, rregullimi më i mirë i buxheteve komunale pas datës 1 mars në rast se kuvendet komunale nuk i miratojnë ato dhe disa ndryshime të tjera.

Unë ju falënderoj për vëmendje dhe ju propozoj ta aprovoni këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër! E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Naser Osmani, ta marrë fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Ndryshimet dhe plotësimet esenciale që janë propozuar në ligjin bazik për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë janë heqja e kufizimeve nga kufiri i deficitit prej 2% për shpenzimet për projekte strategjike zhvillimore kapitale që do të financohen nga huamarrja që Republika e Kosovës do të huazojë nga institucionet financiare ndërkombëtare, institucionet e Bashkimit Evropian, Qeveritë e huaja apo agjencitë e tyre të zhvillimit, me kusht që borxhi total publik nuk mund të kalojë më shumë se 30% të bruto-produktit vendor.

Ky përjashtim i rregullës fiskale do të fuqizohet në periudhën prej 10 vjetësh që nuk do të aplikohet për huamarrje të brendshme nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë, ku edhe më tutje do të vlejë rregulla fiskale prej 2%.

Ndryshimi tjetër esencial, i propozuar në këtë projektligj, përfshin obligimet që dalin nga marrëveshja e re me Fondin Monetar Ndërkombëtar, që kanë të bëjnë me ruajtjen e stabilitetit makrofiskal dhe politikave të qëndrueshme afatgjata buxhetore nëpërmjet kushtëzimit të rritjes së buxhetit total në paga, mëditje, kompensime dhe shtesave tjera në nivelin e rritjes nominale vjetore të bruto-produktit vendor që merr parasysh nivelin e rritjes reale ekonomike dhe përqindjen e inflacionit bazuar në të dhëna statistikore të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Çështjet tjera janë më tepër të përmirësimeve të karakterit teknik, ashtu siç e përmendi edhe vetë ministri. Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë në leximin e parë projektligjin dhe të gjitha këto çështje që janë ngrehur, komentet dhe sugjerimet që do të bëhen, do të analizohen me kujdes me rastin e amendamentimit të projektligjit dhe do të propozohen ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme që e bëjnë atë më të zbatueshëm dhe më transparent.

Prandaj, edhe në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, ju ftoj që projektligji në fjalë të votohet.

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë nga grupet parlamentare, Safete Hadërgjonaj për Partinë Demokratike të Kosovës.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësim ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe ka ardhur në përfundim që ta përkrahë rekomandimin e komisionit për ta votuar në parim këtë projektligj.

Projektligji kryesisht përfshin ndryshimet që kanë dalë nga marrëveshja e re me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i ka edhe disa vërejtje për këtë plotësim-ndryshim të Ligjit për financat publike dhe përgjegjësitë, sidomos në nenin 5, që ka të bëjë me nenin 4 të Ligjit bazik, e ky nen faktikisht ka të bëjë me Thesarin, dhe ne rekomandojmë që ky nen, domethënë neni i 5, që ka të bëjë me nenin 4, të fshihet nga

projektligji, kurse ne i kemi edhe disa vërejtje në lidhje me nenin 6 të projektligjit, të cilat qëndrime do t'i paraqesim në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ku do të kontribuojmë në drejtim të përmirësimit të projektligjit për plotësim-ndryshim të Ligjit për menaxhimin e financave publike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah në parim Projektligjin për plotësim ndryshimin e Ligjit për financat publike dhe përgjegjësitë dhe i fton të gjithë deputetët që ta përkrahin këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, zonja Hadërgjonaj! Tani në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Naser Osmani. Mirë! Zoti Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe e përkrah në parim. Vërejtjet tona do t'i paraqesim në Komisionin Funksional.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Listës serbe, zoti Slavko Simiq.

SLAVKO SIMIQ: Hvala, predsedniče!

Poštovani poslanici,

I Poslanička grupa Srpske lista razmatrala Nacrta zakona i mi ćemo podržati ovo prvo razmatranje o izmeni i dopuni bazičnog zakona javnih financija i odgovornosti, i mi ćemo svoj doprinos dati kroz Funkcionalne stalne komisije, u koju su poslanici Srpske liste zastupljeni kao potpredsednici, kao članovi. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur ta marrë fjalën. As përfaqësuesi i Qeverisë. Të nderuar deputetë, jemi në procedurën e deklarimit me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 76 vota për, asnjë abstenim, asnjë kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Kërkohet nga Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Programi i Qeverisë 2015-2018 parasheh avancimin e praktikave të prokurimit publik në Kosovë me qëllim të rritjes së efikasitetit të shpenzimeve publike dhe kursimit në buxhet.

Në përputhje me këtë objektiv, Ministria e Financave, së bashku me të gjithë aktorët relevantë, e ka hartuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për prokurim publik në Republikën e Kosovës. Ky projektligj avancoi prokurimin publik duke e bërë procesin më efikas nëpërmjet rishikimit të procedurave ekzistuese dhe inkuadrimit të procedurave të reja. Këto modifikime janë bazuar në nevojat e identifikuara gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, si dhe me ndryshimin në legjislacionin përkatës të Bashkësisë Evropiane.

Ndryshimet që do t'i sjellë ky projektligj do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit, transparencës, cilësisë së punëve, të materialeve që prokurohen në shmangien e procedurave të komplikuar dhe në shtimin e vlerës për para.

1. Projektligji i ka definuar qartë procedurat e prokurimit nga momenti i shpalljes së tenderit deri te nënshkrimi i kontratës, i ka definuar autorizimet, kompetencat dhe përgjegjësitë e secilit zyrtar të prokurimit.

2. Projektligji mundëson aplikimin e sistemit të ri të trajnimeve për të gjithë zyrtarët që janë të inkuadruar në këtë proces.

3. Krahasuar me ligjin aktual, projektligji rregullon më në detaje prokurimin në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes duke siguruar që vetëm për mallra që janë specifike mund të evitohen procedurat e prokurimit standard.

4. Projektligji i definon shumë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit zyrtar në secilin nivel të procesit të prokurimit.

5. Me qëllim të riorganizimit të trajnimeve dhe certifikimit të zyrtarëve të prokurimit është bërë ndarja ndërmjet kompetencave të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Institutit të Kosovës për Administratë Publike.

Me këtë projektligj autorizohet drejtori i institucioneve arsimore të nënshkruajë kontratë me vlerë minimale që zhvillojnë këto institucione.

Ky projektligj mundëson ndarjen e kontratave publike me loto homogjene dhe heterogjene me qëllim të përfshirjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në tregun kombëtar të prokurimit publik.

Projektligji krijon mundësinë e pagesës së drejtpërdrejtë për nënkontraktorët nga autoriteti kontraktues. Me qëllim të ekonomizimit, Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës dhe ministritë obligohen që t'i kryejnë prokurimet për ato agjenci të tyre që kanë më pak se 50 punonjës. Autoritetet kontraktuese mund të vendosin kushte specifike në kontratat publike me të cilat realizojnë objektivat sociale, siç është rekrutimi i personave të papunë, personave me aftësi të kufizuara, ose personave të grupeve të marginalizuara të tjera.

Me këtë projektligj modifikohen procedurat konkurruese me negociata, ku kjo procedurë rekomandohet në situata kur procedurat e hapura ose të kufizuara nuk i japin rezultatet e nevojshme të prokurimit. Me qëllim të rregullimit të tenderit me çmimin jonormalisht të ulët është autorizuar tani Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, që këtë fushë ta rregullojë me akt nënligjor. Është inkuadruar procesi i zgjedhjes së mosmarrëveshjeve pa shkuar nëpër instanca gjyqësore, por nëpërmes bisedave nëpërmjet pretenduesit dhe autoritetit të kontraktuesit.

Me qëllim të adresimit të strategjisë së Qeverisë për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017, projektligji ka evituar pengesat për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në procesin e prokurimit publik. Projektligji e ka përafruar këtë pjesë të legjislacionit të Kosovës me direktivat e Bashkësisë Evropiane. Ajo që është më e rëndësishmja, është që nëpërmjet këtij projektligji tani mundësohet aplikimi i plotë i prokurimit elektronik nëpërmjet një vendimi të Qeverisë, në momentin që ky ligj hyn në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve ose e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike e Kosovës, zonja Labinotë Demi-Murtezi.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Kërkoj falje, e kam bërë një gabim! Fjalën le ta marrë kryetari i Komisionit Funkcional, zoti Naser Osmani, pastaj ju! Fjalën e ka zoti Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, kryesisht e trajton modifikimin e çështjeve të prokurimit publik ndërmjet freskimit të procedurave dhe mekanizmave ekzistues për inkuadrimitin e mekanizmave dhe procedurave të tjera. Këto modifikime janë bazuar në nevojën e identifikuar gjatë zbatimit të Ligjit publik, si dhe në ndryshimet në legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

Me propozimet dhe ndryshimet e bëra janë definuar mirë procedurat e prokurimit, që të mos jenë të stërzgjatura dhe të jenë të definuara autorizimet e secilit zyrtar të prokurimit. Ndryshimet tjera të propozuara kanë të bëjnë me ndarjen e kontratave publike në lote homogjene dhe heterogjene, me qëllim të përfshirjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në tregun kombëtar të prokurimit publik.

Po ashtu, projektligji mundëson pagesën e drejtpërdrejtë për 9 kontraktorët nga autoriteti kontraktues. Është krijuar baza ligjore, që të gjitha agjencitë në organizata të ndryshme buxhetore, që janë nën autoritetin e Kuvendit apo Qeverisë, që kanë më pak se 50 të punësuar, shërbimet për këto organizata t'i kryejë Kuvendi apo ministritë përkatëse, që është në funksion të ekonomizimit të shpenzimeve publike.

Projektligji ka krijuar bazë ligjore, që autoriteti kontraktues të mos vendosë kushte specifike në kontratat publike, me të cilat realizojnë objektivat sociale, siç është rekrutimi i personave të papunë dhe personave me aftësi të kufizuara, nxitja e barazisë gjinore, nxitja e diversitetit etnik. Shuma e sigurisë së tenderit, e cila kërkohet nga autoriteti kontraktues është propozuar të ulet nga 3% në 1% të vlerës së parashikuar të kontratës, ose kontraktuesit të projektimit.

Ndryshimi i rëndësishëm i këtij projektligji është, siç e tha edhe vetë ministri, krijimi i bazës juridike për fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, që njëherësh është edhe arsyeja kryesore e ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji.

Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa në vitin 2013 e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit të prokurimit publik dhe ka nxjerrë disa rekomandime, që janë miratuar në Kuvend dhe që shihet se në këtë projektligj janë marrë parasysh shumica prej tyre dhe ato kanë mbetur të patrajuara, e që do të analizohen gjatë amendamentimit dhe të jenë pjesë e këtij ndryshimi.

Komisioni në mbledhjen e vet, të mbajtur më 4 nëntor 2015, i ka rekomanduar Kuvendit që ta votojë ndryshimin e ligjit në fjalë. Po ashtu, edhe qëndrimi i Grupit Parlamentar të LDK-së është që ta aprovojë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Osmani! Urdhëroni, zonja Demi-Murtezi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë, deputetë,

Edhe grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-327, dhe u rekomandon të gjithë deputetëve që të votojnë dhe të miratohet në parim ky projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Fatmir Rexhepi, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, zoti kryeministër!

Kolegë deputetë,

Meqë e kemi para vetes ndryshimin dhe plotësimin e Projektligjit për prokurim, duke i përkrahur në parim këto praktika të reja që po vendosen në këtë projektligj, unë do t'i kisha propozuar edhe Komisionit Funkcional që deri në leximin e dytë ta shohë mundësinë se si mund të vendoset një

kategori e vlerës gjatë prokurimit për prodhimet vendore, diku 10-20%, të cilat mund të përfshihen, në mënyrë që të kemi një nxitje dhe një stimulim të përdorimit të produkteve vendore në proceset e prokurimit në vendin tonë.

Kjo lejohet dhe është e mundur, prandaj le ta marrin parasysh. Besoj që kjo do ta ndihmojë shumë prodhimin vendor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë do të shkoj në radhitjen e paraqitjeve, megjithëse Slavko Simiq e ka fjalën në emër të grupit parlamentar, pastaj je ti Gëzim pa grup. Urdhëro, zoti Slavko, Grupi Parlamentar i Listës serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa Srpske liste je razmatrala ovaj Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona o javnoj nabavki Kosova. Mi ćemo modifikovati ovaj Nacrt zakona kroz funkcionalne i stalne komisije, u kojima smo zastupljeni. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Fikrim Damka, nga “6+”.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah në parim Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për prokurim publik të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Gëzim, e ke fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Shqetësimi im kryesor lidhur me këtë projektligj është i njëjti me atë paraprak të menaxhimi i financave publike, por me qëllim që t’ua kursej kohën tuaj nuk e mora fjalën tek ai paraprak, por po mundohem ta shpreh të njëjtin shqetësim për të dy projektligjet.

Ministri e prezantoi projektligjin e ri, i cili synon reformimin komplet të sistemit të prokurimit publik, por ajo që është kryesore dhe shqetësuese, fatkeqësisht në Kosovë, gjendja në terren dhe gjendja praktike është shumë e rëndë, zaten i kemi edhe vërejtjet e Raportit të Progresit, fenomene të cilat lidhen me proceset e prokurimit publik, e që ndërlidhen me procesin e tenderimit, kanë ndikuar që Kosova të radhitet në vendin me shkallën më të lartë të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Dilema ime është ajo që e prezantoi ministri, se është bërë një përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ajo është një gjë e mirë, por, në anën tjetër, gjendja praktike në terren është shumë më e rëndë, veçanërisht nëse ndalemi te proceset e prokurimit publik, te fenomeni i tenderëve.

Ne e dimë që në Kosovë, nuk po them 100%, por 80-90% të proceseve tenderuese, pas luftës kanë fituar jomeritorët, nuk kanë fituar ata që kanë qenë meritore, duke filluar nga procesi i

privatizimit të ndërmarrjeve të ndryshme publike dhe furnizime të ndryshme në institucione të ndryshme publike. Prandaj, kjo është shumë e rëndë në terren.

Ministër, e kam një kërkesë konkrete për ju, duke u bazuar në përvojën e mandatit të kaluar. Që nga mandati i kaluar, ne në këtë Kuvend kemi miratuar shumë projektligje, të cilat në parim kanë qenë të mira në letër, por në praktikë janë ende të pazbatueshme dhe për të mos thënë se nuk kanë ndikuar në aspektin pozitiv. Unë propozoj që, në bashkëpunim konkret me ministrin e Punëve të Brendshme, ta organizoni një “task-forcë” për luftimin konkret të tenderomanisë në Kosovë. Ajo është kanceri i Kosovës. Ajo po e fundos Kosovën.

E njëjta gjë është për shumë projektligje, siç e përmenda, që në letër kemi shumë projektligje të mira. Është i pranishëm edhe kolegu i juaj nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ministri i Shëndetësisë, e kemi Ligjin e punës, i cili e rregullon shumë mirë sistemin e punës në Kosovë. Por, është e tmerrshme se si shkelen të drejtat e punëtorëve në Kosovë në aspektin privat. Kryesisht në sektorin privat nuk respektohet orari i punës. Punëtorët privatë punojnë shtatë ditë në javë.

Pastaj, te Ligji për shëndetësi, Ligji për duhanin, i cili është një projektligj shumë i mirë nga mandati i kaluar, por gjendja në terren është shumë e rëndë. Edhe te ky projektligj dhe te menaxhimi i financave publike dhe te projektligji, për të cilin po flasim, për prokurimin publik, mund të jetë një projektligj i mirë në letër, i përafuar me sistemin e legjislacionit të Bashkimit Evropian, por gjendja në terren e tregon të kundërtën, se kemi probleme shumë serioze me prokurimin publik, e veçanërisht kur është fjala për tenderët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë tjerë të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë, në qoftë se prapë e kërkon fjalën? S’ka.

Atëherë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Administrata t’i thërrasë deputetët. Janë 73 deputetë në sallë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

E kemi një abstenim, 67 vota janë për. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

Ftohet përfaqësuesi i Qeverisë, zoti ministër Arban Abrashi, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Në këtë sesion plenar të Kuvendit të Republikës së Kosovës paraqes para jush Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-31 për liritë fetare në Kosovë.

Qeveria e Kosovës, më 9. 9. 2015, me vendimin 02/48 e ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-31 për liritë fetare në Kosovë. Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në eliminimin e zbrazësive ligjore, të cilat ekzistojnë në ligjin aktual.

Me këtë projektligj synohet të rregullohet statusi juridik i bashkësive fetare, sepse një grup fetar pa statusin e personit juridik nuk mund të zotërojë, ose të ushtrojë të drejtat e saj, që lidhen me statusin juridik të entitetit.

Me ligjin në fuqi njihen pesë bashkësi fetare në Kosovë, të cilat përbëjnë edhe trashëgiminë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit. Si bashkësi që përbëjnë trashëgiminë historike, kulturore dhe shoqërore të vendit, në projektligj është shtuar edhe Bashkësia e Tarikateve të Kosovës.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-31 për liritë fetare në Kosovë e rregullon mënyrën dhe kushtet e regjistrimit të bashkësive të reja fetare në Kosovë. Shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin dhe çregjistrimin e bashkësive fetare në Republikën e Kosovës e kryen komisioni për regjistrimin e bashkësive fetare të reja. Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët zgjidhen ad hoc, duke e respektuar përbërjen etnike dhe gjinore në Kosovë. Bashkësitë fetare nuk janë të detyruara të regjistrohen dhe ta pranojnë statusin e personit juridik kundër vullnetit të tyre.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë e rregullon çështjen e varrezave dhe të riteve të varrimit. Vendet e varrezave caktohen në baza neutrale dhe jodiskriminuese nga autoritetet publike, pa ndërhyrje të bashkësive tjera fetare dhe se ritet fetare kryhen në përputhje me dëshirën e të ndjerit apo në mungesë të dëshirës së tij/saj, në përputhje me dëshirën e familjeve të afërmve të të ndjerit, përderisa nuk bien ndesh me rendin publik.

Në këtë projektligj ceket se shteti nuk e financon asnjë bashkësi fetare, por bashkësitë fetare mund të konkurrojnë në oferta të Qeverisë për marrjen e fondeve, që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e monumenteve kulturore, që janë në pronësi të bashkësive fetare.

Me këtë ligj, kryeministri e cakton zyrën përkatëse për bashkësitë fetare në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë ka dhënë opinion edhe Komisioni Evropian për Demokraci nëpërmjet ligjit, opinionit të Komisionit

të Venedikut me nr. 743/2013, i miratuar në sesionin 98 plenar. Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit gjatë hartimit të këtij projektligji ka marrë parasysh dhe i ka inkorporuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e marra nga ky komision.

Duke pasur parasysh që kjo fushë nuk ka qenë e mbuluar me ligjin në fuqi, miratimi i këtij ligji do ta plotësojë infrastrukturën ligjore për këtë çështje, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kam nderin që para jush pata rastin të informoj në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji dhe propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet që rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Ju lus për qetësi në sallë! E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Lirije Kajtazi, që ta marrë fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Sot e kemi në rend dite plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për liritë fetare në Kosovë. Çështjet e rregulluara me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji për lirinë fetare nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së, siç e tha edhe ministri që në fillim. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton plotësisht liritë fetare, por me qëllim të shprehjes së tolerancës fetare në Kosovë dhe një rregullimi më të mirë ligjor për ndryshim plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, ka dhënë opinion Komisioni Evropian për Demokraci, Komisioni i Venedikut, Opinioni 743/213 i miratuar në sesionin e 98-të plenar, prapë po them, siç e detajoi edhe më mirë ministri Abrashi.

Megjithëkëtë, besoj se Komisioni për të Drejtat e Njeriut si Komision Funkcional, por edhe të gjithë ju, deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës, ju mbetet mjaft punë gjatë amendamentimit për t'i saktësuar kushtet për njohjen e statusit juridik të një bashkësie fetare, ngase siç e keni parë gjatë leximit, ka nevojë që më shumë të saktësohet kjo gjë.

Për fund, Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Persona të Pagjetur dhe Peticione i rekomandon Kuvendit të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Republikën e Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Tani radha është e kryetarëve, ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Zonja Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe përkrah në parim projektligjin në fjalë. Ndërsa, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i kemi vërejtjet tona, që do t'i përcjellim gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Lirije Kajtazi, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, sërish e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka vërejtjet e veta, të cilat mendoj se vëmendshëm deputetët gjatë punës së amendamentimit do t'i inkorporojnë në plotësim-ndryshime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kujtim Paçaku, në emër të "6+". Ju lutem!

KUJTIM PAÇAKU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar "6+" e përkrah në parim ligjin dhe në lexim të dytë do t'i japë propozimet e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, zoti Slavko Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa Srpske liste razmatrala prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona o verskoj slobodi, i mi čemo svoj doprinos dati kroz funkcionalne i stalne komisije, kako bi se rešio pravni status verskih zajednica na Kosovu. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Shpejtim Bulliqi, diskutues nga radhët e deputetëve.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të respektuar kolegë deputetë,

Ky ligj, përkatësisht ky projektligj mbi rregullimin e pozitës juridike të bashkësive fetare në vendin tonë është i rëndësisë së veçantë. Sigurisht që ky projektligj me këto plotësime dhe ndryshime, të cilat sigurisht i kanë munguar ligjit të mëhershëm, do të kontribuojë në një mënyrë apo tjetrën që problemet dhe parregullsitë, të cilat janë paraqitur në organizatat fetare në vend, përfshirë këtu edhe Bashkësinë Islame të Kosovës si organizatën më të madhe fetare, që kanë vepruar pa ndonjë mbështetje juridike dhe ligjore, duke mos qenë për kaq kohë të gjatë të regjistruara në asnjë institucion juridik të vendit tonë, në rrethanat tona të reja shtetërore dhe demokratike, do të jetë i mirëseardhur.

Draft-ligjin e përgatitur për këtë çështje nga Qeveria për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës e përshëndetim dhe e shohim si të përgatitur mirë, por ka disa mangësi dhe vërejtje, për të cilat ne mendojmë që si projektligj do të plotësohej shumë më mirë, po që se do të përfshiheshin në draftimin e tij përfundimtar edhe disa çështje të rëndësishme, siç janë:

1. Të ketë kritere më të qarta dhe më të detajuara sa i përket themelimit të bashkësive të reja fetare.

Konsiderojmë se nëse çdokujt i jepet mundësia që nëpërmjet këtij numri kaq të vogël të anëtarësisë të themelojë bashkësi të re fetare, siç është paraparë me draftimin e tanishëm, atëherë nëpërmjet tij, pa asnjë pengesë, mund të themelohen drejtime fetare të cilat në të ardhmen mund ta dëmtojnë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e paqes fetare dhe ta shkaktojnë jostabilitetin e shoqërisë. Po të mos ekzistojnë kritere më të qarta dhe më të ashpra se këto tani, atëherë xhema

i ndryshëm, si vehabizmi, selifizmi, satanizmi e tjerë, si drejtime të njohura tashmë fetare me orientime radikale dhe ekstreme, shumë lehtë do të mund të themelonin bashkësi të reja fetare në vend, të cilat do ta dëmtonin imazhin tonë karshi botës së qytetëruar dhe të civilizuar demokratike.

2. Regjistrimi i bashkësive të tanishme fetare të bëhet pasi të verifikohen rregulloret e tyre të brendshme të punës, të cilat në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që të bien ndesh me të drejtat civile të lirisë dhe humanizmit.

3. Të shikohet mundësia e futjes në këtë draft-ligj të pikës për mbështetje financiare shtetërore të bashkësive fetare të regjistruara në proporcion me numrin e ithtarëve të tyre që e kanë. Sepse, nëse edhe në të ardhmen bashkësitë fetare vazhdojnë ta shikojnë mundësinë e mbijetesës dhe aktivitetit të tyre vetëm nëpërmjet donacioneve të jashtme, atëherë pengimi i ndikimit të jashtëm fetar dhe politik do të jetë i pamundur.

Një rregullim dhe mbështetje e tillë financiare për bashkësitë fetare kanë aprovuar edhe disa vende evropiane, siç është rasti me Kroacinë, Norvegjinë, Luksemburgun, Austrinë, Turqinë, e kështu me radhë. Besoj se këto vërejtje dhe sugjerime që i paraqita këtu në draftimin final të këtij projektligji do të merren parasysh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e kanë kërkuar deputetja Labinotë Demi-Murtezi, pastaj le të përgatitet deputeti Gëzim Kelmendi.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit, kryetar!

Konsideroj se Projektligji për liritë fetare është njëri nga projektligjet më të rëndësishme, është një nga projektligjet që na ka munguar.

Identiteti fetar i çdo njeriu, çdo qytetari të Republikës së Kosovës, është pjesë e identitetit të tij të përgjithshëm, andaj duhet të kemi konsideratë të posaçme në amendamentimet që do të bëjmë për këtë projektligj. Si projektligj që është parë deri më tani nuk i ka përmbushur kërkesat apo dëshirat, apo atë çfarë kanë pritur qytetarët. Kemi pasur edhe reagime të bashkësive fetare, siç është fjala për Bashkësinë Islame të Kosovës.

Konsideroj se të gjithë si deputetë kemi çfarë të japim, ngase bashkësitë fetare në përgjithësi kanë kontribuar mjaft në rrjedhat e vendit tonë, si në aspektin kulturor, ashtu edhe në aspektin humanitar. Bashkëpunimi duhet të vazhdojë. Duhet të bëjmë pak më shumë, ngase shumë herë është lënë për t'u dëshiruar dhe për t'u keqkuptuar në këtë kontekst.

Shpreh pakënaqësitë e mia për këtë projektligj, që nuk është ashtu siç ne kemi menduar. Duhet plotësuar shumë më shumë dhe do ta japim kontributin, unë personalisht, sigurisht se edhe anëtarët e tjerë të grupit parlamentar dhe të Kuvendit, në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni Gëzim, fjala është juaja.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Ashtu si shumica e kolegëve deputetë, edhe unë i kam pa dyshim vërejtjet e mia, por duke pasur parasysh që çdo përfaqësues nga grupet parlamentare pati vërejtje, edhe unë i kam vërejtjet e tilla dhe propozoj që ky projektligj nuk duhet të amendamentohet, por duhet t'i kthehet prapa Qeverisë. Ministri duhet të bashkëpunojë me të gjitha bashkësitë fetare në Kosovë, që ta sjellë para nesh një ligj, i cili është në harmoni me tolerancën dhe bashkëjetesën fetare të të gjitha komuniteteve fetare në Kosovë dhe të mos shkaktojë pakënaqësi te qytetarët e ndryshëm apo te bashkësitë fetare, për faktin se nëse hapet rruga e amendamentimit do të shkaktohet shumë mjegulli dhe do të shkohet më shumë në turbullime sesa veprime konkrete, prandaj është moment i duhur që Qeveria ta kthejë prapa këtë projektligj dhe ta sjellë para nesh një projektligj, i cili do ta rregullojë statutin e mirëfilltë juridik të bashkësive fetare në Kosovë, sepse 15 vjet pas luftës nuk e kanë dhe të mos lejojnë në asnjë moment që të prishet kjo tolerancë, kjo bashkëjetesë fetare, për faktin se në këtë projektligj ne shohim qartë se komunitetet e ndryshme të vogla, me numër të vogël, kanë të drejtë të formojnë bashkësi të ndryshme fetare dhe kjo gjë e tillë e rrezikon stabilitetin ndërfetar në Kosovë.

Prandaj, është momenti i fundit që Qeveria ta kthejë prapa këtë projektligj, e jo deputetët ta amendamentojnë në mënyrë që ta kemi një projektligj konkret, që do ta ruajë në radhë të parë bashkëjetesën dhe tolerancën ndërfetare, do të jenë të kënaqura të gjitha bashkësitë fetare në Kosovë dhe të mos shkaktojë pakënaqësi apo turbullira të ndryshme brenda komuniteteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait Hasani e ka kërkuar fjalën! Urdhëro, Nait!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Kosovës i ka munguar një ligj i tillë, i ka munguar që herët kur është miratuar edhe Pakoja e Ahtisarit. I ka munguar për shkak se e vetmja Bashkësia Islame nuk ka qenë pjesë e institucionit, ka qenë një organizatë joqeveritare. Ndërsa, Kisha Ortodokse ka qenë pjesë e institucionit, pjesë e marrëveshjeve, pjesë e diskutimeve, pjesë e trashëgimisë kulturore.

Kjo tregon se diferencimi, privilegjet dhe diskriminimi që i është bërë kulturës në Kosovë, nga ajo ortodokse, është mjaft i rëndësishëm të thuhet se ne kemi pësuar mjaft shumë, sidomos edhe me mospranimin në UNESCO.

Mund të themi se priftërinj serbë nëpër kisha ortodokse kanë nxitur vazhdimisht urrejtje, urrejtje nacionale, madje edhe një formë fashizmi. Këtë e ka treguar dhe e ka dëshmuar sidomos prifti në kohën e UNESCO-s, kur ne bëmë përpjekje që Kosova të jetë pjesë e UNESCO-s, ndërsa priftërinjtë serbë deklarorin që edhe luftë në Kosovë do të ketë, nëse ajo pranohet në UNESCO. Kjo tregon që e kemi lirinë fetare, ndërsa kemi edhe urrejtje nacionale. Pikërisht të priftërinjve, ata që nuk kanë mundur dhe nuk mund ta durojnë Kosovën shtet.

Për ne, ky Kuvend duhet nëpërmjet këtij ligji t'i disiplinojë apo edhe t'u ndalojë veprimtarinë disa priftërinjve nëpër kisha ortodokse pikërisht për shkak të urrejtjes nacionale që e kanë vazhdimisht.

Kosova e ka përfunduar luftën me Serbinë. Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë është kishë ortodokse e Kosovës, e shtetit të Kosovës, e trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe e së ardhmes së Kosovës, por nuk është kishë ortodokse e Beogradit, që ai të na mbajë ligjërata dhe të na bëjë kërkesa e të nxisë urrejtje në Kosovë.

Dhe derisa kryeministri, edhe Qeveria vazhdimisht thërrasin për tolerancë, thërrasin për bisedime, thërrasin për integritet, ne na dalin priftërinjtë me forma të tilla të urrejtjes, nxitjes së urrejtjes dhe të diskriminimit.

Pra, kjo kërkesë për luftë tregon se Kosova nuk e ka një të ardhme në formën e tillë, prandaj duhet kërkuar një masë e cila duhet të tregojë se Kisha Ortodokse, Qeveria dhe të gjithë se është Kishë Ortodokse e Kosovës, e jo në bazë të asaj marrëveshje të planit të Ahtisarit se Kisha Ortodokse është serbe.

Kisha Ortodokse do të jetë kishë ortodokse e kulturës dhe trashëgimisë shqiptare që ka qenë dhe është në Kosovë, prandaj ky ligj duhet ta zgjidhë këtë çështje.

Dhe, nëse nuk e zgjidh këtë çështje, konfliktin në vazhdimësi do ta kemi ndërmjet bashkësive fetare.

KRYETARI: Faleminderit, Nait! Më nuk ka të lajmëruar për të diskutuar. Shpresoj se këto vërejtjet të cilat u dhanë, do t'i marrë parasysh Komisioni Funkcional, veçanërisht të bisedojë me bashkësitë fetare të cilat e kanë luajtur një rol të jashtëzakonshëm. Pra, edhe Komisioni Funkcional do ta ketë përkrahjen e plotë, por është mirë të kontaktohen gjithsesi bashkësitë fetare, dhe Bashkësia Islame e ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm, por edhe Ipeshkvinë e Kosovës dhe atë që e tha Naiti - Kishën Ortodokse gjithsesi, për të pasur ndikim edhe kosovar, e të mos jetë çdoherë e politizuar.

Prandaj, duhet bashkërisht, sepse është përkrahje shumë e madhe për tri bashkësitë fetare, në qoftë se bëhen bashkë, e pastaj edhe ato grupe të vogla që të mos ketë keqkuptime, na vyen pra toleranca e përbashkët.

Profesor, në ndërkohë e keni kërkuar fjalën! Urdhëro! Fjalën e ka Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Faleminderit!

Unë e kam lexuar këtë projektligj, sepse ta dimë që një ligj e kemi pasur, kurse ky është plotësim-ndryshim, e të mos mbetet publikisht se po ndërtojmë ligj, së pari. Kjo është nën një!

Nën dy, pikërisht amendamentet të cilat janë në ligin e kaluar janë amendamente që do të ngjallin diskutime dhe ngjallën diskutime të gjithë deputetët që folën. Te të gjithë!

Kështu që e kemi një ligj shumë sensitiv. Ju e dini që pak shtete kanë ligje për fe. Nuk kanë shumë shtete, se këtu po flitet sikur të gjitha i kanë. Jo s'i kanë! Nëse është përcaktimi kushtetues dhe liria fetare garantohet me kushtetutë, ligjin dikush e ka, dikush s'e ka. Ne e kemi, por duam ta bëjmë më të përshtatshëm.

Problemi është nëse do të jetë më i përshtatshëm në gjendjen që e kemi ne. Ne e kemi një deklaram, dhe po flas këtu për shqiptarët si nacion, me një tolerancë të jashtëzakonshme në mes të besimeve dhe s'kemi pse të mos i kemi, sepse i kemi brenda nacionit.

Problemi është dhe ndodh atje ku besimet e ndryshme fetare nuk i përkasin një nacioni, pra një kombi.

Ne në Kosovë tani po e ndërtojmë një plotësim ligji, mirëpo që me këtë draft-propozim ka bashkësi fetare që shpallen me draft, që s'e kanë pasur këtë funksion që e kanë pasur tjerët. Duhet të specifikohet. Kjo është nën një.

Dhe, nën dy, do të thotë shumëzohen bashkësitë fetare legale në Kosovë me këtë projektligj. Dhe, e dyta, është mënyra se si mund të regjistrohen bashkësitë e reja, e aty pastaj e kemi së paku nivelin e konkurrencës, një liberalizim total, sepse është një pesëdhjetësh që mund ta nënshkruajnë një kërkesë që hyn në lojën e vërtetë ligjore të legalizimit.

Duke e pasur parasysh këtë, unë vetëm dua të tërheq vërejtjen, që ne kemi tradicionalisht një traktat nacional - ai është i Sami Frashëri "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet". Pse po them t'i kthehem? Atje ekziston vetëm një faqe tekst mbi besën të thuhet.

Dhe, unë deri sot nuk kam parë bazament më të mirë se të ndërtohet një ligj për këtë problem të feve. Absolutisht! I cili përjashton edhe këto rrymime, të cilat po artikulojnë sot dhe të cilat do të dalin në diskutim sidomos me njërin bashkësi që quhet bashkësi, po thënë shumë - tarikatet. Kini kujdes, nuk është njëjës. Të gjitha tjerat janë njëjës, kjo është shumë. Do të shihet çka do të thotë ai shumë.

Dhe, për të mos e zgjatur, sepse i këtille siç është, unë nuk do ta jap votën për as tash. Do të abstenoj, sepse do të pres bashkësitë fetare, realisht, qysh do të diskutojnë publikisht për ligjin e tyre, sepse unë i kam përcjellë deklaratat e tyre. Tjetër po del atje çka merren vesh në grupacione të vogla të hartimit dhe tjetër po del deklarata publike.

Kur këta t'i barazojnë deklaratimet publike dhe formulimet ligjore, për ne deputetët nuk është kurrfarë problemi, dhe mendoj që Kuvendi duhet të flasë hapur për këto çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në ndërkohë Melihate Tërmkollit e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni!

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Mendoj se ky projektligj vërtet është njëri nga ato projektligje shumë të ndjeshme, të cilat rregullojnë çështje të ndjeshme, sidomos duke pasur parasysh aktualitetin tonë.

Kolegu deputet i përmendi disa të Kishës Ortodokse, por po harron që ka edhe do tjerë që po deklarohen hapur edhe në mënyrë antikushetuese në emër, qoftë të Bashkësisë Islame, qoftë në emër të Islamit, qoftë të kujtdo qoftë, e unë kujtoj se me këtë projektligj kam frikë se më shumë që rregullohen këto marrëdhënie, çrregullohen. Prandaj, do të ishte shumë mirë dhe nuk është fundi i botës nëse Qeveria e tërheq.

Unë do ta votoj kundër, nëse hidhet në votim, por mendoj se duhet të trajtohet në mënyrë shumë më serioze kjo çështje. Nuk është problemi këtu vetëm i çështjes së imazhit të Kosovës, mbi të gjitha dhe para se gjithash është çështja e sigurisë së qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani më nuk ka deputetë të lajmëruar për të diskutuar. Patëm edhe qëndrime të ndara rreth kësaj çështjeje. Përfaqësuesi i Qeverisë, e kërkon fjalën?

Unë do ta jap vetëm aspektin juridik për këtë çështje. Duke u bazuar në nenin 81, amendamenti 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve me interes vital, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë në shumicë. Pra, nevojiten të paktën 61 vota për, përfshirë këtu të paktën edhe 11 vota për të komuniteteve që nuk janë shumicë.

Në ndërkohë, duhet ta dimë numrin e deputetëve të pranishëm. Atëherë, në sallë janë të pranishëm 75 deputetë, përfshirë këtu edhe 18 deputetë nga komunitetet tjera, që nënkupton plotësimin e kushteve për votim.

Ishte numërimi me ngritje dore, dhe paska qenë varianti tjetër. Pra, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

I kemi 37 vota për, 20 abstenime dhe 12 kundër, prandaj ky ligj nuk kalon.

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë.

E ftoj ministrin e Punëve të Jashtme dhe zëvendëskryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Veseli!

I nderuar kryeministër Mustafa,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Shërbimi i Jashtëm i Kosovës është i ri sa edhe vetë shteti i Kosovës. Si i tillë ka arritur që të konsolidohet shpejt dhe ta përfaqësojë denjësisht Kosovën në botë.

Pas 8 vjetësh kemi grumbulluar mjaft përvojë që ta konsolidojmë edhe më tutje Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, prandaj edhe është përpiluar Projektligji për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Ligji i ri do ta sigurojë një kornizë ligjore koncize dhe koherente, duke e harmonizuar Ligjin në fuqi për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, që deri më tani ka qenë i shpërndarë në akte të ndryshme ligjore.

Pra, Ligji i ri do të krijojë qartësi juridike, do të avancohet roli i akademisë diplomatike dhe do të ketë rol shumë më të rëndësishëm në pranimin dhe aftësimin profesional të diplomatëve. Kjo do të sjellë rritje të standardit profesional me provime për t'u bërë pjesë e shërbimit dhe për avancimin në kuadër të Shërbimit të Jashtëm të Kosovës. Do të ketë edhe më shumë stimulim për diplomatët që do të bëhen pjesë e shërbimit.

Shërbimi i Jashtëm do të jetë shërbim i specializuar, që do të rezultojë për më shumë siguri dhe stimulim për diplomatët që shërbejnë, por do të instalojë edhe më tepër përgjegjësi dhe standarde më të larta profesionale.

Ligji i ri do ta përmirësojë kompensimin financiar për diplomatët që do të garantojnë punë dhe jetë të dinjitetshme për diplomatët tanë. Pra, do të ketë avancim në bazë të përgatitjes profesionale dhe të meritave në punë.

Me Ligjin e ri do të krijohet edhe pozita e Inspektoratit Diplomatik. Ky post do të kujdeset që misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Kosovës të veprojnë në mënyrë të ligjshme, etike, ekonomike dhe në interes të gjithë qytetarëve e institucioneve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pas këtij prezantimi të projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. E ftoj nënkryetaren e Komisionit për Punë të Jashtme, zonjën Teuta Rugova ta marrë fjalën. Nuk është këtu! Urdhëro, zotëri Hoxhaj, në emër të Komisionit!

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të respektuar deputetë,

Ky projektligj që e rregullon fushën e Shërbimit të Jashtëm është një projektligj i cili i plotëson të gjitha standardet dhe përvojat më të mira në rajon dhe Evropë.

Komisioni për Politikë të Jashtme e ka mbathur një mbledhje më 13 tetor 2015 dhe këtë ligj e kemi shqyrtuar në parim dhe ne si komision rekomandojmë që sot të miratohet nga kjo seancë e Kuvendit të Kosovës dhe ftojmë çdo deputet që ka sugjerime e propozime dhe në takimet e komisionit t'i ndërmarrim disa ndryshime të cilat ne si deputetë na duken të nevojshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani, radhën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Elmi Reçica, nga Partia Demokratike e Kosovës!

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin, si dhe për Qeverinë në tërësi!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe realisht e ka vërejtur se është një ligj mirë i strukturuar dhe normalisht se një pjesë e deputetëve kanë vërejtje dhe do t'i shfaqin apo prezantojnë ato

ndërmjet dy leximeve. Ka edhe ide të reja, dhe ka njëfarë mospërputhje ndërmjet Shërbimit Konsullor dhe Shërbimit të Jashtëm, të cilat ne do t'i paraqesim ndërmjet këtyre dy leximeve dhe sigurisht që do të kontribuojmë që ai ligj të vijë më i plotësuar dhe më real sa u përket rrethanave tona.

Unë mendoj se ky ligj duhet të votohet në parim dhe besoj që shumë shpejt do të vijë në leximin e dytë dhe duhet ta mbështetim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Ismet Beqiri, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës!

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Edhe ne e kemi analizuar. Normalisht jam edhe anëtar i komisionit përkatës dhe ne i kemi disa vërejtje, por si Grup Parlamentar ato do t'i themi ndërmjet dy leximeve, kurse tash në parim e përkrahim një projektligj të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Qerim Bajrami, nga "6+", e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem se predsedniĉe!

I Parlamentarna grupa "6+" je razmatrala zakon o Vanjskoj suĉbi i u naĉelu ĉe glasati za ovaj predlog, s tim Ńto ĉe u komisijama, posebno u Funkcionalnoj, dati svoj dopune i izmene. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! I nderuar Sasha Milosavljeviq e ka fjalën, në emër të Listës serbe.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniĉe!

I Poslaniĉka grupa Srpske liste je razmotrila Zakon u prvom ĉitanju - Zakon o spoljnoj sluĉbi Kosovam, i mi ĉemo danas ovaj zakon podrĉati u naĉelu!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Vjosa Osmani e ka kërkuar fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Unë kisha dëshirë që të sqarohen disa prej çështjeve, në mënyrë që edhe ne si deputetë të dimë me cilat prej tyre të shkojmë me amendamente ndërmjet dy leximeve.

E para ka të bëjë me nenin 37, pikë 4, që parasheh kalimin e diplomatëve politikë në diplomatë të karrierës.

E konsideroj si problematikë që lë hapësirë për keqpërdorime, prandaj do të doja të dëgjoj, në qoftë se kanë pasur parasysh si precedent ndonjë shtet tjetër demokratik, ku është bërë një kalim i tillë nga diplomatët, që konsiderohen të emëruar politikë, pra automatikisht në diplomatë të karrierës.

Çështja e dytë ka të bëjë me përgjegjësitë e inspektorit diplomatik dhe në qoftë se është shqyrtuar që këto përgjegjësi mund të bien ndesh me ato të Auditorit të Brendshëm.

Çështja e tretë ka të bëjë me mbajtjen e pasaportave diplomatike për të gjithë anëtarët e Shërbimit të Jashtëm, dhe kjo do të duhej të ishte e paraparë, sepse për momentin sekretari i përgjithshëm apo drejtori i përgjithshëm në MPJ, si zyrtarë të rangut më të lartë aty nuk kanë të drejtë ta mbajnë këtë pasaportë përderisa bashkëshortët dhe fëmijët e atasheut diplomatik për momentin e kanë këtë të drejtë, këtë privilegj, apo imunitet.

Një çështje tjetër ka të bëjë me nenin 40.2, për zhvillim të karrierës diplomatike për anëtarët e jashtëm, pra që fare nuk janë pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kjo po ashtu është problematike, sepse do të duhej të caktohej një gradë maksimale për ta. Pra, jo më e lartë se sa ajo e sekretarit të parë, për shembull, sepse në këtë mënyrë dikush që nuk ka qenë fare pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo e Shërbimit të jashtëm deri tani mund të futet automatikisht dhe menjëherë t'i jepet grada më e lartë, për shembull grada ambasador, apo grada ministër këshilltar.

Neni 42.1, punësimi jashtë Shërbimit të Jashtëm është po ashtu problematik, sepse e ngarkon Ministrinë e Punëve të Jashtme me shumë zyrtarë, të cilët e mbajnë ministrinë si punë apo angazhim dytësor dhe pastaj, në qoftë se nuk gjejnë diku tjetër më mirë, automatikisht mund të kthehen prapë aty.

Gjithashtu një çështje shumë e rëndësishme është dashur që me këtë ligj të shkëputet lidhshmëria e anëtarëve të Shërbimit të Jashtëm me Ligjin për shërbim civil. Pra, njëjtë sikur që e ka Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, që konsiderohen anëtarë të karrierës, pra që nuk i nënshtrohen Ligjit për shërbimin civil, është dashur që të bëhet kjo shkëputje edhe për anëtarët e Shërbimit Diplomatik të Kosovës.

Neni 44.3 i lejon anëtarët e shërbimit ta vazhdojnë punën edhe pas moshës së pensionit, pa përjashtim dhe pa u përcaktuar kriteret. Me këtë moshë të popullatës që e kemi, ku rreth 70% të popullatës në Kosovë janë nën 30 vjet, është e pakuptueshme dhe besoj absurde që të mos caktohet një moshë, pra që edhe pas pensionimit të vazhdohet pozita e diplomatit, për shembull në moshën 80 apo 85-vjeçare.

Neni 48.5 parasheh kriteret shumë të ulëta, pra vetëm 2 vjet përvojë pune për gradim, dhe duhet të shihen vendet që kanë përvojë më të mira në këtë aspekt.

Po ashtu, neni 56.4 i paguan bashkëshortët e diplomatëve me 50% të gradës së atasheut, që i bie diku 700-800 euro përafërsisht në muaj dhe po ashtu 20% për çdo fëmijë. Dhe, ju e dini që anëtarët e Shërbimit Civil, përfshirë edhe ata që punojnë në MPJ, disa prej tyre paguhet me 200-300 euro.

Pra, përfundimisht ka mjaft vërejtje në këtë projektligj dhe shpresoj që Ministria e Punëve të Jashtme qysh tani mund t'i sqarojë disa prej tyre, në mënyrë që të mos shkojmë me amendamente për secilën veç e veç, sepse në qoftë se amendamentohet 50% e projektligjit të propozuar, atëherë sipas praktikave që i kemi ndërtuar në Parlament del se po hartojmë ligj të ri si Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë tjetër të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë?

Mbeten të vihen vërejtjet ndërmjet dy leximeve. Në vazhdim kërkohet pra deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, 68 deputetë jemi në sallë. Votojmë tash!

Konstatoj se me 59 vota për, 5 kundër dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit!

Ka kërkesa nga shumë deputetë, kemi një pauzë 30-minutëshe. Ka bukë në pjesën e pasme për punë, pesë minuta dhe vazhdojmë seancën për 30 minuta. Urdhëro, Ismet. Vetëm pak ju lutem, Ismet Beqiri e ka një propozim.

ISMET BEQIRI: Unë vetëm kisha propozuar ta kryejmë edhe votimin për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese gjatë numërimit pastaj ka kohë, dikush e bënë numërimin, ne e kryejmë votimin edhe e kryejmë të njëjtën kohë sepse, kryetar, po ikin disa nga deputetët dhe unë kisha propozuar, e normalisht që seanca vendos, deputetët vendosin që veç të bëhet një zhvendosje e rendit të ditës me këtë pikë, të shkojmë të votojmë për dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese pastaj e vazhdojmë ashtu siç e thatë ju. Nuk prish besoj asgjë në këtë që duhet të jetë pauzë pastaj.

KRYETARI: Atëherë, kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj, ndërkohë ne mund ta shfrytëzojmë edhe këtë kohë pothuajse është pauzë. A ulemi pra e vazhdojmë me mirëkuptimin e juaj. Atëherë kërkojmë të ulemi e të vazhdojmë.

21. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit të Posaçëm për zgjedhjen e dy gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

E ftoj deputeten Selville Halimi që në emër të Komisionit të Posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese para deputetëve ta paraqesë raportin me rekomandime.

SELVILLE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese në bazë të nenit 114 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ka zhvilluar të gjitha procedurat e parapara për zgjedhjen e dy gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Komisioni i Posaçëm, në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2015, vendosi që Kuvendit t'i rekomandon për votim katër kandidatë për gjyqtarë në gjykatën Kushtetuese të radhitur sipas rezultateve të poentimit, si në vijim.

1. Resa Cakaj Nimani,
2. Rexhep Gashi,
3. Selvete Gërxhaliu dhe
4. Hashim Çollaku.

Kuvendi prej katër kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese i propozon dy kandidatë për emërim nga presidentja e Republikës së Kosovës dhe së paku njëri duhet të jetë nga gjinia femërore.

Deputetë të nderuar,

Meqë në Kushtetutën dhe në Ligjin për gjykatën Kushtetuese nuk është definuar procedura e votimit në seancën plenare, propozoj që para se të procedohet me votim të miratohet procedura e votimit, si në vijim.

1. Votimi i kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese bëhet me votim të fshehtë.
2. Deputeti i Kuvendit prej katër kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese të rekomanduar nga Komisioni i Posaçëm voton për dy kandidatë për pozitën e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese.
3. Nëse në rundin e parë të votimit vetëm një kandidat e fiton numrin e nevojshëm të votave e që është 2/3 të pranishëm në sallë, atëherë votimi përsëritet për dy kandidatët tjerë që kanë fituar më së shumti vota. Ndërsa nga lista e fletëvotimit për rundin e dytë hiqet emri i kandidatit me më së paku vota. Nëse në rundin e parë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk e fiton numrin e nevojshëm, atëherë përsëritet konkursi.

I ftoj deputetët që të miratojnë procedurën e votimit për zgjedhjen e dy gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete!

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim të propozimit për procedurën e votimit.

Ju kisha lutur jemi në votim, deputetja e nderuar i lexoi procedurat e votimit për procedurën e votimit votojmë tash.

63 deputetë kanë votuar, 63 janë për. Konstatoj se Kuvendi i miratoi procedurat e votimit për zgjedhjen e dy gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet formimi i Komisionit votues me përbërje nga një deputetë prej secilit grup parlamentar të mbështetur nga zyrtarët e administratës së Kuvendit.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të bëjnë propozimin e emrave si anëtar për komisionin votues. Partia Demokratike e Kosovës.

ADEM GRABOVCI: Partia Demokratike e Kosovës e propozon Rafet Ramën.

KRYETARI: Lidhja Demokratike e Kosovës?

ISMET BEQIRI: Ne e propozojmë Salih Morinën.

KRYETARI: Lista serbe?

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče, mi predlažemo Srđana Popovića.

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”?

MYFERA SHINIK: Grupi “6+” e propozon Kujtim Paçakun.

KRYETARI: Lus deputetët që me ngritje formale të dorës ta miratojmë këtë komision. Shumica është për.

Konstatojmë se Kuvendi i emëroi anëtarët në Komisionin votues.

Kush është kryetar? Rafet Rama është kryetar. Atëherë komisioni me anëtarët të cilët u përmendën. A ka dikush kundër? Konstatoj se Kuvendi i emëroi anëtarët në Komisionin votues.

Lus komisionin që të fillojë me procedurat e votimit, ndërsa deputetët do të ftohen të votojnë sipas listës.

Komisioni ju lutem le t’i zërë vendet.

Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Syla, Voja Osmani edhe Kadri Veseli,

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu – Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaç – Bujupi, Doruntinë Maloku – Kastrarti, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq...

(Ndërprerje e incizimit)

Komisioni fillon numërimin e votave dhe pastaj shohim se si është gjendja. Regjia, fjalën komisionit.

RAFET RAMA: Atëherë po fillojmë me numërimin për kandidatët të cilët janë votuar:

Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, e pavlefshme, Rexhep Gashi, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj -Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Rexhep Gashi, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Gresa-Cakaj Nimani, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj Nimani, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj Nimani Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj Nimani, Hashim Çollaku, Rexhep Gashi, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Rexhep Gashi, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj Nimani, Selvete Gërxhaliu, e pavlefshme, kemi katër votime që ka votua deputeti. Gresa Cakaj Nimani, Rexhep Gashi, Selvete Gërxhaliu, e pavlefshme, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj Nimani, Hashim Çollaku, Rexhep Gashi, Gresa Cakaj Nimani, Rexhep Gashi, Gresa Cakaj-Nimani, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Rexhep Gashi, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj Nimani, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Rexhep Gashi, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Hashim Çollaku, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj Nimani, Rexhep Gashi, Hashim Çollaku, e pavlefshme, Gresa Cakaj-Nimani, Hashim Çollaku, Rexhep Gashi, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Gresa Cakaj-Nimani, Rexhep Gashi, Gresa Cakaj-Nimani, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Gresa Cakaj-Nimani, Rexhep Gashi, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, e pavlefshme, Gresa Cakaj-Nimani.

(Ndërprerje e incizimit)

Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni votues për propozimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në mbështetje të nenit 65, pika 11 dhe 114 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Komisioni votues i formuar me vendim të seancës plenare të datës 30 nëntor 2015 në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar. Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për propozimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese në seancën plenare të mbajtur më 30 nëntor 2015 konstaton: Në votim kanë marrë pjesë 79 deputetë, të pavlefshme janë 5 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

Gresa Cakaj-Nimani i ka fituar 58 vota,
Rexhep Gashi i ka fituar 10 vota,
Selvete Gërxhaliu i ka fituar 46 vota dhe
Hashim Çollaku i ka fituar 23 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit në pajtim me nenin 65, pika 11 dhe 114, pika 3 të Kushtetutës së republikës së Kosovës, konstatohet se zonja Gresa Cakaj-Nimani propozohet për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese ose zgjidhet kandidate për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa në rundin e dytë shkojnë Selvete Gërxhaliu dhe Hashim Çollaku. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë lus Administratën t'i përgatisë fletëvotimet, janë të gatshme. Sa veta janë në sallë, besoj që ka kuorum të mjaftueshëm.

Fillojmë! Komisioni, a jeni në rregull ju? Atëherë po fillojmë me votimin:

Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Kadri Veseli, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylja, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti,

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq,

Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmeti, Mexhide Mjaku, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashić, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavljević, Selviqe Halimi, Srđan Popović, Shqip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Sllavko Simiq, Slobodan Petrović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahir Izmaqi, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

Në qoftë se ka ndonjë deputetë, gjithë emrat janë thirrur le të shkojnë le të votojnë edhe një herë. Komisioni, a ka votuar Xhavit Haliti, se ka qenë kryesues i seancës veç nëse ka konfirmim.

Të nderuar deputetë,
Ka buzëqeshje nga anëtari i komisionit, ta dëgjojmë rezultatin përfundimtar.

Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu,
 Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu,
 Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Selvete Gërxhaliu,
 Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu,
 Hashim Çollaku, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, e pavlefshme, Selvete Gërxhaliu, Selvete
 Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, e pavlefshme, Selvete Gërxhaliu, Hashim
 Çollaku, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Selvete
 Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, e pavlefshme, Selvete Gërxhaliu, Selvete
 Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete
 Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete
 Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Selvete Gërxhaliu, Hashim Çollaku, e pavlefshme, Selvete
 Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete
 Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete
 Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete
 Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu, Selvete
 Gërxhaliu, Hashim Çollaku, Selvete Gërxhaliu, Selvete Gërxhaliu.

Komisioni votues për propozimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, në mbështetje të nenit 65, pika 11 dhe 114, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Komisioni votues i formuar më vendim të seancës plenare të datës 30 nëntor 2015 në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, Rafet Rama, Grupi Parlamentar PDK, Salih Morina, Grupi Parlamentar LDK, Sërgjan Popoviq, Grupi Parlamentar LS dhe Kujtim Paçaku, Grupi Parlamentar “6+”.

Selvete Gërxhaliu, ka fituar 66 vota,
Hashim Çollaku, ka fituar 9 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit në pajtim me nenin 65, pika 11 dhe 114, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konstatohet se zonja Selvetë Gërxhaliu, zgjidhet gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Në bazë të rezultateve të votimit, vendimi për propozimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese, zonja Gresa Caka-Nimani dhe Selvetë Gërxhaliu i dërgohen Presidentes së Republikës së Kosovës për emërim.

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për projektligj dhe votimi i amendamenteve nga 1 deri me numër 8 kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 30 dhe 31 korrik 2015.

Ka mbetur për votim amendamenti numër 9 dhe teksti i Projektligjit në tërësi.

Para se të procedojmë në votimin e amendamentit numër 9, ju njoftoj për një sqarim procedural.

Amendamenti numër 9 nuk është propozuar në pajtim me nenin 57, paragrafi 3 dhe 4 të rregullores së Kuvendit.

Në raportin e Komisionit funksional nuk ka amendament me shkrim të propozuar nga deputeti zotëri Qerim Bajrami.

Andaj kërkoj sqarim nga raportuesi i Komisionit Funksional, zoti Fadil Demaku. Lidhur me amendamentin numër 9. Nëse nuk është propozuar nga Komisioni Funksional, atëherë nuk kemi amendament të propozuar në pajtim me nenin 57, paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores së Kuvendit dhe si i tillë nuk mund të i nënshtrohet votimit.

Urdhëro, zoti Demaku!

FADIL DEMAKU: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket këtij amendamenti kur ka qenë edhe një herë këtu në seancë Projektligji për letërnjoftimet, unë e kam shpreh mendimin se Komisioni në mbledhjen që e ka mbajtur sa i përket këtij projektligji e ka përkrahur këtë amendament dhe më s'ka pasur asnjë diskutim brenda komisionit rreth kësaj çështjeje.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë ne duhet rreth këtij amendamenti të përgatitim për votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Amendamenti 9.

I deputetit Qerim Bajrami me përkrahjen e Komisionit Funksional, neni 10 shtohet paragrafi i ri me përmbajtje, si në vijim:

“Formularët dhe letërnjoftimet për pjesëtarët e komunitetit joshumicë shtypen edhe në gjuhët e tyre të cilat janë në përdorim në nivel lokal”.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim amendamentin 9. Votojmë tash!

Me 43 vota për, 8 kundër dhe 10 abstenime, kalon amendamenti.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash ligjin.

Kuvendi me 62 vota për, 3 kundër dhe 3 abstenime, e miratoi Ligjin për letërnjoftimin.

I nderuar deputet,

Unë bazohem vetëm në materialin të cilin e marr nga Komisioni Funkcional që e kam marrë edhe Administrata e ka sjellë dhe e ka vënë në rend të ditës, Kryesia e ka aprovuar.

Ta lejojmë zotin Hasani, vetëm një qartësim po dëshiron.

NAIT HASANI: Kryetar!

Unë e kam Projektligjin për letërnjoftimin dhe amendamenti 9 është pas amendamentit 7 dhe amendamentit 8. Edhe këtu nuk i ke shqyrtuar asnjërën, e fute vetëm amendamentin 9, dhe kjo është një shkelje që është bërë drejtpërdrejtë në Kuvend të Kosovës. Prandaj, derisa nuk i ke votuar këto le ta mohojnë, le ta votojnë kundër, por jo të anashkalohen amendamentet.

KRYETARI: Derisa i nderuari zoti Hasani, ju biseduat, Administrata thotë se do të na sjellin gjithë sqarimet dhe merret përgjegjësia edhe për këtë çështje, ta kemi parasysh.

Ne po vazhdojmë në pikat e rendit të ditës. Se unë nuk po e nënvlerësoj atë çfarë the, unë veproj vetëm në bazë të materialit të cilën e posedoj këtu. Po në qoftë se ka materie e cila vjen në kontestim do të kihet parasysh atë çfarë e the. Ta presim administratën, para se të vazhdojmë. Jemi te pika e radhës. Unë po e dorëzoj menjëherë te administrata le ta qartësojnë. Nuk do të nënvlerësohet.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Financave, zoti Abdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit në Republikën e Kosovës, përcakton fushëveprimin për auditimin e jashtëm të fondeve publike, ekzekutimin e buxhetit, përdorimin dhe qeverisjen e burimeve publike.

Si synim kryesor ky projektligj ka përputhje me standarde ndërkombëtare për institucione supreme të auditimit të ofrojë një nivel më të lartë të pavarësisë funksionale dhe operacionale të auditorit të përgjithshëm, por duke qartësuar njëkohësisht edhe obligimet e tij institucionale dhe raportuese.

Duke marrë parasysh statusin dhe rolin që ka ky institucion për auditimin e parasë publike ky projektligj u shërben prioriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave.

Ky projektligj synon të rrisë nivelin e transparencës në funksionimin e Auditorit të Përgjithshëm.

Në këtë kontekst edhe raporti i progresit ka konstatua se Kosova duhet të siguroj miratimin e shpejtë të një ligji në përputhje me standardet e organizatës ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit për Zyrën Kombëtare për Auditim dhe emërimin e Auditorit të Përgjithshëm.

Ky projektligj do ta adresojë këtë kërkesë të BE-së dhe do t'i shërbejë objektivit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Gjatë hartimit të projektligjit, Ministria e Financave ka marrë parasysh dokumentet relevante të Komisionit Evropian dhe institucioneve tjera vendorë dhe ndërkombëtarë që rregullojnë këtë fushë si dhe praktikatat më të mira evropiane dhe rajonale.

Të gjitha institucionet për zbatimin e këtij projektligji kanë qenë të përfshira gjatë hartimit të projektligjit.

Po ashtu, edhe subjektet private për zbatimin e këtij projektligji kanë qenë të përfshira në konsultimet publike.

Unë ju falënderoj për vëmendje dhe ju lus që ta votoni këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër! Në emër të Komisionit funksional, zoti Besnik Bislimi, nuk është këtu. Zoti Naim Fetahu.

NAIM FETAHU: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2015 shqyrtoi në parim Projektligjin numër 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

1. Të miratohet në parim Projektligji numër 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

2. Rekomandimin e paraqes në emër të Komisionit për Mbikëqyrje Financiare në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit. Komisioni FunkSIONAL para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare e shqyrtoi projektligjin dhe Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, vlerësoi se ai i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit që të procedohet për shqyrtim të parë dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, a ka dikush të thotë diçka, deputetë nuk ka të lajmëruar asnjë.

Përfaqësuesi i Qeverisë e dëshiron fjalën?

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 67 vota për, 2 kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Punës zotin Arban Abrashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritarë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të paraqes para jush për miratim Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Ky projektligj është rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm... ose Ministrisë së Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin e saj.

Projektligji ka për qëllim forcimin e një baze ligjore që do të mundësoj krijimin e mekanizmave ligjor për luftimin e ashpër të kriminalitetit dhe administrimin e levërdishëm dhe profesional të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Ky projektligj qartëson mandatin e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar duke mundësuar ofrimin e këshillave për prokurorin, gjykatën dhe institucione tjera mbi natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar me qëllim të ofrimit të ndihmës për planifikimin e sekuestrimeve apo konfiskimeve të mundshme.

E rregullon çështjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me rastet e pranimi të kërkesës nga shtetet e tjera në lidhja me administrimin e pasurive.

Me këtë projektligj përcaktohet roli ekzekutues i agjencisë si dhe nga i cili organ do të pranohet pasuria.

Ky projektligj përkufizon pasuri të cilat do të administrohen nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si dhe ato që janë jashtë administrimit të saj.

Rregullon një varë çështje që kanë të bëjnë me pranimin, ruajtjen e vlerës, vlerësimin dhe shitjen e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. E gjithë kjo me qëllim të administrimit sa më profesional të pasurive të sekuestruara apo të konfiskuara.

Ky projektligj përcakton se në rastet kur pasuritë të cilat kërkojnë një administrim të veçantë të kompanive, bizneseve të veçanta apo pasuri specifike për të cilat nevojiten njohuri të veçanta në fushën relevante, agjencia angazhon administratorë të pavarur të fushës përkatëse me synim të administrimit efikas të funksionimit më të mirë të kësaj pasurie.

Ky projektligj është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me ekspertë të shquar të brendshëm dhe ndërkombëtarë me qëllim të ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve të agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar në administrimin dhe luftimin e krimi.

Fuqizimi i këtij projektligji është i një rëndësie të veçantë sepse do të kontribuonte krijimit të infrastrukturës së përgjithshme për një funksionim të sistemit të drejtësisë në administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Një funksionim i tillë i sistemit të drejtësisë në administrimin e pasurisë do t'i kontribuon ndërtimit të një shteti të së drejtës dhe një lufte më të ashpër kundër kriminalitetit.

Me inkorporimin e këtij projektligji në sistemin juridik të Republikës së Kosovës do të arrihen qëllimet të shumta e ndër më të rëndësishme është lufta kundër kriminalitetit, avancimi i legjislacionit në këtë fushë dhe po ashtu do ta kemi një sistem të qëndrueshëm në administrimin e pasurisë.

Andaj, ju ftoj ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pas prezantimit të projektligjit e hapi debatin për diskutim në parim. E ftoj nënkryetarin e Komisionit për Legjislacion, zonjën Selvi Halimi, ta marrë fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datën 13.10.2015 e shqyrtoi Projektligjit numër 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqes këtë rekomandim.

Të miratohet në parim Projektligjit numër 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve ose kryetarëve të grupeve parlamentare. Agim Aliu, nga Partia Demokratike e Kosovës.

AGIM ALIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta përkrahë Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky ligj, duke pasur parasysh përmbajtjen që ka ky ligj, si dhe duke pasur parasysh qëllimin që ka ky ligj për të shtuar efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve në administrimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar.

Gjithashtu Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të përkrahë edhe për arsye se ky ligj do të kontribuojë jashtëzakonisht shumë në funksionimin e rendit dhe ligjit dhe gjithashtu do të funksionalizojë edhe më shumë luftën kundër kriminalitetit.

Prandaj, duke pasur parasysh këta faktorë ftojmë deputetët që të japim kontributin e tyre gjatë fazës së amendamentimit dhe të plotësojnë edhe më shumë këtë ligj kaq të rëndësishëm për institucione dhe në përgjithësi për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe të njëjtën kohë i ftoj ata që të votojnë pro këtij projektligji.

KRYETARI: Faleminderit! Armend Zemaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Ne e kemi pasur një ligj të tillë dhe po ashtu e kemi edhe një agjenci e cila administron pasurinë e sekuestruar apo edhe të konfiskuar.

Ndryshimet që janë paraqitur me këtë projektligj të ri përkrahen nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, por më duhet të theksoj ky nuk është një ligj i cili thekson qartë edhe nga fjala e vetë e ministrit i cili lufton krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Projektligji i cili duhet të vijë këtu është Projektligji apo Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Atëherë do t'i gjendet punë edhe kësaj agjencie dhe do të jetë në funksion edhe ky projektligj, sepse ky ka të bëjë me administrimin e pasurisë e cila konfiskohet edhe sekuestrohet, qoftë nga Prokuroria dhe qoftë nga gjykatat, doganat edhe institucionet tjera.

Sido që të jetë ne e dimë që edhe në strategjinë legislative është e paraparë që të vije ai projektligj por besoj që krahas këtij projektligji mendoj që Qeveria duhet ta sjell edhe Projektligjin për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme e cila është kërkesë e vazhdueshme qoftë e deputetëve të Kuvendit, qoftë e shoqërisë civile por edhe institucioneve që e mbështesin Republikën e Kosovës.

Si do që të jetë, ne japim përkrahje në parim dhe Grupi Parlamentar do ta votojë këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Shefi i Grupit Parlamentar të Listës serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniči Vlade,

Poštovani poslanici,

Poslanička grupa Srpske liste razmatrala Nacrta zakona o upravljanju zaplenjenom i konfiksovanom imovinom i mi ćemo u načelu podržati ovaj Nacrt zakona, imajući u vidu cilj ovog Zakona i njegovu posebnu važnost. Pozivamo i sve poslanike koji su prisutni da podržavaju ovaj Nacrta zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”. Danush, urdhëro!

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar projektligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Në parim do ta përkrahim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur deputetë. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

68 deputetë kanë votuar, 68 deputetë për.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Arsim Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër, kolegë ministra,

Më lejoni që ta prezantoj Projektligjin për profesionet e rregulluara. Ky ligj nxirret për herë të parë në Republikën e Kosovës dhe synon ta standardizojë kornizën kombëtare të profesioneve të rregulluara.

Ligji për profesionet e rregulluara është një praktikë tani më e rregullt me Bashkimin Evropian dhe ka për qëllim ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë.

Në fakt, ky ligj pretendon që profesionet që janë në interes publik që përcaktohen me këtë ligj siç është profesioni i mjekut, profesioni i stomatologut, i fizioterapeutit, profesioni i mësuesit, profesioni i inxhinierit dhe disa profesione tjera të jenë profesione të rregulluara dhe të gjithë të diplomuarit në universitete publike dhe kolegje private pas diplomimit para se të plasohen në tregun e punës do të duhej t'i japin testet shtetërore, testet kombëtare. teste këto që do të jenë një verifikim i cilësisë apo kualitetit të sistemit të arsimit të lartë dhe tekste që do të shkruhen në partneritet të plotë midis pjesës akademike dhe pjesës praktike apo shoqatave që merren.

Në fakt ky ligj pretendon që të implementohet nëpërmjet një agjencie shtetërore e cila do të themelohet me qëllim të ngritjes së standardeve, të testeve kombëtare me qëllim të vlerësimit të këtyre testeve dhe e tëra kjo do të ndihmojë që vërtetë të rritet cilësia e arsimit të lartë dhe të rritet kompetenca e kuadrove që plasohen në tregun e punës.

Ligji tani më është gjerësisht i përhapur në Bashkimin Evropian dhe njëkohësisht ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit i drejtpërdrejtë me Republikën e Shqipërisë me të cilën kemi nënshkruar marrëveshje shtetërore dhe jemi pajtuar që të marrim përvojën e cila tanimë atje aplikohet më shumë se katër vjet.

Në hartimin e këtij ligji janë kyçur ekspertët evropian dhe ekspertët e universitetit dhe gjithashtu ky ligj ka kaluar debatin publik më tepër se 45 ditë në të gjitha universitetet dhe është mirëpritur si diçka shumë e nevojshme për të ngritur cilësinë e në mënyrë të veçantë për të promovuar shkasit dhe kompetencat e njerëzve të diplomuar në universitete në mënyrë që ata të kyçen në tregun e punës, duke qenë se kjo përvojë ka qenë e munguar dhe është një detyrim i Kosovës karshi integritimeve evropiane.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj ta votoni në leximin e parë dhe pastaj bashkë me Komisionin për Arsim ne do të punojmë së bashku që brenda amendamenteve ta përsosim edhe më tej këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Urdhëro, kryetari i Komisionit FunkSIONAL për arsim, zoti Nait Hasani, e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Arsim, më 27 tetor 2015, rekomandon për Projektligjin numër 05/L066 për profesionet e rregulluara në republikën e Kosovës.

Rekomandimi të miratohet në parim Projektligji për profesionet e rregulluara të Republikës së Kosovës.

Mendojmë që ky projektligj është mjaftë i qëlluar për kohën dhe pse ka disa të meta të cilët besojmë që gjatë plotësimit në shqyrtim, në amendamentim kemi mundësi t'i ndryshojmë ose t'i plotësojmë dhe ta bëjmë më të avancuar si ligj.

Kuvendi i Kosovës duhet ta miratoj në parim dhe duhet sa më shpejtë t'i miratoj po ashtu edhe në lexim të dytë që të jetë një ligj që të ju ofroj mundësi të paktën për gjeneratat që po vijnë të jenë ata më të përgatitur për tregun e punës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Nait! Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Bekim Haxhiu, nga Partia Demokratike e Kosovës.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritarë,

I nderuar ministër i Arsimit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë, domethënë që është një ligj shumë i qëlluar përmes të cilit rregullohet përcaktimi i.. për pjesëmarrje në disa profesione të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesit publik, sigurisë publike dhe shëndetit dhe respektimin e parimeve, të shqyrtimit të pavarur dhe tek autonomia profesionale.

Mendoj që është një ligj i cili del edhe nga direktivat e Bashkimit Evropian dhe Parlamentit Evropian mbi njohjen e kualifikimeve profesionale dhe mendoj si ligj i tillë plotëson nevojat dhe kriteret.

E përgëzoj Ministrinë për këtë nismë ligjore e cila ka qenë më se e domosdoshme t'u pasur parasysh nivelin e ngritjes profesionale dhe edukative, duke pasur nevojë që profesioni shëndetësor sot po arsimohen dhe po edukohen në dy nivele edhe në sektorin publik dhe në sektorin privat dhe njohja e kualifikimeve përmes profesioneve të rregulluara edhe në sektorin e shëndetësisë po edhe atë të mësuesisë dhe të arkitekturës është më se e domosdoshme. Prandaj, ministrinë e përgëzoj ndërsa ne si Komision mendoj që do të japim kontributin e nevojshëm.

Po edhe si Grup Parlamentar mbështetjen e duhur. Prandaj ju ftoj të gjithëve që ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Salih Morina, nga Grupi Parlamentar Lidhja Demokratike e Kosovës.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka analizua dhe ka shqyrtua këtë projektligj dhe mendon që në parim duhet të votohet ky projektligj dhe kontributin tonë do ta japim gjatë leximit të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Slavko Simiq, nga Lista serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa Srpske liste u načelu podržava ovaj Nacrt zakona, i mi ćemo učestovati usavršavanju glavnog cilja ovog Nacrta zakona .. u stalnoj Komisiji u kojima su poslanici Srpske liste zastupljeni kao podpredsednici kao... Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Myfera Serbica Shinik, nga “6+”.

MÜFERRA ŞİNİK: Teşekkür ederim,

Aynı şekilde bu Yasa Tasarısına “6+” Parlamenter Grubu birinci okunuşunu kabul etmektedir. İkinci okunuşuna kadar komisyonlarda katkımızı sunacağız.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk ka deputetë tjetër të paraqitur për diskutim.

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se 67 deputetë kanë votuar, 67 vota për dhe Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Punës, zotin Arban Abrashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që të praqes para jush për miratim Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Finalizimi i këtij projektligji është bërë në konsultim dhe në koordinim të ngushtë me Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe aktorë të tjerë relevantë.

Ndryshimet kryesore që parashihen në këtë ligj ndërlidhen me funksionalitetin dhe ruajtjen e kontinuitetit të punës së këshillit, mundësisë së emërimit të anëtarëve të këshillit edhe për një mandat tjetër pesë vjeçar, si dhe specifikon momentin e fillimit të punës së Këshillit Prokurorial në përbërje të re.

Kërkesa për ndryshim dhe plotësim të tillë ka ardhur nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe si i tillë nëpërmjet këtij ndryshimi dhe plotësimi të ligjit shmanget një lëshim i cili është bërë gjatë fazave të miratimit të ligjit bazë për Këshillin Prokurorial të Kosovës në kuadër të ligjeve të pakos së Gjyqësorit, përkatësisht Prokurorisë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj çështje ju ftoj që ta miratojmë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Selviqe Halimi, e ka fjalën në emër të Komisionit FunkSIONAL.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 3. 11. 2015, e shqyrtoi Projektligjin numër 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

Të miratohet në parim Projektligjit numër 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani janë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike e Kosovës, Nezir Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar Projektligjit numër 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe njëherësh i fton deputetët ta votojnë.

Ndërsa gjatë shqyrtimit të dytë të ligjit aktual ne do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend Zemaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Neve edhe ashtu para pak muajsh e kemi miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Është pa që 2-3 nene janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe mandatin e Këshillit Prokurorial dhe tash rregullohen me këtë plotësim-ndryshim që ka ardhur. Kështu që edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Danush Ademi, nga “6+”. Le të bëhet gati Lista serbe.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Në parim do ta përkrahë këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, Danush! Slavko Simić, e ka fjalën nga Lista Serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Poslanička Grupa Srpske liste, razmatrala Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o tužilačkom savetu Kosova i mi čemo dati svoj doprinos kroz funkcionalni stalne komisije i pozivamo sve poslanike da podrže ovaj Nacrta zakona.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Para se të shkojmë në votim kisha kërkuar nga deputetët, ka ndonjë të mos tregohet shumë entuziazëm për të votuar dy herë. Herën e kaluar i kemi pasur 66 deputetë me prani fizike në sallë, i kemi 67 vota, rezultati i votimit. Të kemi parasysh pse s’është opozita, mos tregoni entuziazëm, 67 vota, 66 veta të pranishëm. Ka problem, unë e them këtë veç çfarë Administrata ma sjell, ta keni parasysh.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 61 vota për, një kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mjekësinë ligjore

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Punës, zotin Arban Abrashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Ministra, deputetë,

Më lejoni që të paraqes para jush për miratim Projektligjit për mjekësinë ligjore.

Me miratimin e këtij projektligji do të arrihen këto synime: avancimi i fushës së mjekësisë ligjore në Kosovë, rritja e efikasitetit dhe efektivitetit sa i përket autopsive dhe ekzaminimeve mjeko ligjore, harmonizimi i dispozitave ligjore të Ligjit për mjekësinë ligjore dhe të Ligjit për departamentin e mjekësisë ligjore me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, si dhe departamenti aktual i mjekësisë ligjore do të avancohet në nivel të agjencisë si organ qendrorë i administratës shtetërore dhe do të funksionon në mbarësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Përmes avancimit të legjislacionit të fushës së mjekësisë ligjore pos që do të harmonizohet me rekomandimet e Këshillit të Evropës që i dedikohen kësaj fushe synohet që në mënyrë indirekte të ndikohet edhe në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë pasi që shërbimet mjeko ligjore para së gjithash janë në shërbim të sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial.

Me miratimin e këtij projektligji do të avancohet fusha e mjekësisë ligjore në mënyrë që të shmangen pengesat, vështirësitë dhe mospërputhjet e legjislacionit aktual të kësaj fushe si dhe ekspertët e mjekësisë ligjore do të mund të jenë më efikas në punën e tyre në ofrimin e ekspertizave dhe ekzaminimeve mjeko-ligjore.

Në kuadër të projektligjit parashihen afatet si për kryerjen e ekzaminimeve mjeko-ligjore po ashtu edhe për përgatitjen e raportit mjeko-ligjor, pastaj obligimi për ruajtjen e fshehtësisë së informacioneve si dhe obligimi për mbulimin e shpenzimeve të cilat bien në barë të organit me urdhrin e të cilit është kryer ekzaminimi.

Departamenti aktual i mjekësisë ligjore do të ngrihet në nivel të Agjencisë në cilësi të personit juridik me çrrastë parashihet dhe definohet orari i punës dhe rrezikshmëria në punë për personelin e agjencisë, po ashtu dhe definimet dhe kategorizimi i personelit të agjencisë dhe atë në tri kategori, ekspertët mjeko-ligjor, shërbyesit shëndetësorë dhe shërbyesit civilë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj çështje ju ftoj të miratojmë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Ministri i Drejtësisë ka borxh shumë se krejt punën ia ke krye sot. Zonja Selviqe halimi, nënkryetare e Komisionit për Legjislacion, e ka fjalën.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13. 10. 2015, e shqyrtoi Projektligjin numër 05/L-060 për mjekësinë ligjore dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqes këtë rekomandim.

Të miratohet në parim Projektligji numër 05/L-060 për mjekësinë ligjore.

Më duhet të them këtu në Kuvend se në Komision kemi pasur disa çështje për të cilat kemi ngritur si dilema, mirëpo mendojmë se gjatë fazës së amendamentimit do t'i tejkalojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, Nezir Çoçaj nga Partia Demokratike e Kosovës. Ju lutem, lajmërohuni grupet parlamentare.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka shqyrtuar dhe analizuar Projektligjin numër 05/L-060 për mjekësinë ligjore dhe si të tillë do ta mbështesë.

Ndërsa gjatë leximit të dytë do të paraqesim apo do ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Agim Ademaj, nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për mjekësinë ligjore dhe e përkrahim në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Slavko Simiq, nga Lista serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa Srpske liste razmatrala ovaj Nacrt zakona o sudskoj medicini, i mi ćemo na čelu podržati ovaj Nacrt zakona, jer on će povećati sigurno efikasnost sudske medicine unapređivanje ovog Zakona otkloneće se mnogi nedostaci. Zato pozivam sve poslanike da podrže ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Danush Ademi, nga "6+" e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi "6+" e ka shqyrtuar Projektligjin për mjekësinë ligjore dhe në parim do ta përkrahë këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Janë 64 deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për mjekësinë ligjore.

Lus deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se 63 deputetë janë për, një kundër dhe Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mjekësinë ligjore.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patentë shofer

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Infrastrukturës zotin Lutfi Zharku, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar!

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për sigurinë në komunikacionin rrugor, i paraparë me programin legjislativ për vitin 2015 ka pësuar ndryshime duke u ndarë në tri projektligje: Projektligjin për patentë shofer, Projektligjin për rregullat e komunikacionit rrugor dhe Projektligjin për automjete.

Ndarja e Projektligjit për siguri në komunikacion rrugor, është bërë sipas rekomandimit nga takimi sektorial, infrastruktura e cila bëhet në kuadër të dialogut të procesit të stabilizim-asociimit me Komisionin Evropian.

Projektligji për patentë shofer mundëson ngritjen e cilësisë së shërbimeve, ngritjen e normave të sigurisë, ngritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e normave, për regjimin e ngasjes, ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e patentë shoferëve, si dhe mbrojtjen e pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor.

Më lejoni të përmendi çështjet kryesore të cilat i rregullon Projektligji për patentshofer dhe cilat mungojnë në ligjin ekzistues për siguri në komunikacionin rrugor.

Licencimi i autoshkollave për secilën kategori, pa e kushtëzuar me posedimin e licencës për kategorinë B; Rritja e fondit të orëve nga pjesa teorike dhe praktike nga 16 orë sa është aktualisht në 25 orë teori dhe 30 praktikë; Personat e emëruar nga Ministria për vlerësimin e kandidatëve për dhënien e provimit për patentë shofer janë të ndarë për pjesën teorike dhe praktike.

Pyetësit e pjesës praktike janë profesionistë, të cilët duhet t'u nënshtrohen trajnimeve dhe provimeve profesionale.

Standardet minimale të aftësive psikofizike, të nevojshme për të fituar të drejtën për ngasje të automjetit;

Trajnimet dhe provimet për shofer profesionistë;

Vlefshmëria e patentë shoferit për kategorinë B është e kufizuar në 15 vjet. Shoferi nuk e humb patentë shoferin për mosaplikimn.

Subjektet e autorizuar nga Ministria që ofron shërbime në fushën e patentë shoferit i nënshtrohen kushteve dhe kritereve shtesë duke e rritur cilësinë e shërbimeve pa krijuar monopol.

Zyrtarët e ministrisë në trajnimet e organizuara nga subjektet e autorizuar nga Ministria nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në vlerësimin e tyre me rastin e licencimit apo çfarëdo forme të vlerësimit të organizuar nga ministria me të cilën përjashtohet konflikti i interesit.

Zbatimi i projektligjit nuk parasheh implikime buxhetore shtesë në krahasim me buxhetet e aprovuara nga periudhat e kaluara.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e fushës së patentë shoferëve, si dhe avancimet që do të bëhen në Projektligjin e ri, ju ftoj që ta miratoni në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër! Tani, pas këtij prezantimi të Projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim.

E ftoj nënkryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Sasha Milosavljeviq, që ta marrë fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Na osnovu člana 56. Poslovnika Skupštine, Funkcionalna komisija pre prvog razmatranja Nacrta zakona na plenarnoj sednici, razmotrila je u načelu Nacrt zakona broj 05/L-064 o vozačkoj dozvoli.

Komisija je konstatovala da je ovaj Nacrt zakona jer su bolje regulisani standardi, kvaliteti i procedure, usklađivanje sa zakonodavstvom evropske unije kao i osiguravanje preduslova, priznavanja vozačke dozvola od strane drugih zemalja.

Komisija nakon razmatranja u načelu nacrta zakona broj 05/L-064 o vozačkoj dozvoli ocenila je da isti ispunjava uslove predviđenih članom 56 Poslovnika Skupštine i istog je jednoglasno usvojila u načelu. Pozivamo sve prisutne poslanike da danas ovaj zakon podržimo u načelu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Partia Demokratike e Kosovës nuk ka, Lidhja Demokratike e Kosovës nuk ka të lajmëruar, Lista serbe

nuk ka të lajmëruar. Qerim Bajrami nga “6+”-i, as ai. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Atëherë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për patentë shofer. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 63 vota për, 1 kundër, 1 abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për patentë shofer.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullon e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e punës, zotin Arban Abrashi, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Deputetë,

Më lejonit të paraqes në këtë sesion plenar të Kuvendit të Republikës së Kosovës Projektligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Projektligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin 01/45 të datës 21 gusht 2015.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në përcaktimin dhe rregullimin e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme.

Me këtë projektligj përcaktohen të drejtat në benificione të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave. Projektligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë është përgatitur nga Zyra e kryeministrit dhe gjatë hartimit të këtij projektligji janë realizuar një seri konsultimesh me pjesëmarrje të gjerë të aktorëve kyç dhe palëve tjera të interesit.

Kam nderin që pata rastin të ju informoj në pika të shkurta për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. Ftoj kryetaren e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticioni, zonjën Lirije Kajtazi, të marrë fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione duke vepruar në pajtim me nenin 56.2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës e shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 05/L-67 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe konstatoi se Projektligji i plotëson kushtet që të kërkohej miratimi i tij në Kuvend.

Unë kërkoj angazhimet tuaja që më tutje, gjatë amendamentimit, të jeni aktivë dhe sidomos Komisionin për Shëndetësi, i cili mendoj e mbulon mirë fushën të cilën e trajton ky projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Zonja Salije Mustafa nga Partia Demokratike e Kosovës.

SALIJE MUSTAFA: Faleminderit kryetar!

I nderuar kryeministër, ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Me këtë ligj përcaktohen të drejtat në beneficione të përfituesve të këtij ligji si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave.

Është me rëndësi që këtyre personave u njihet e drejta për kujdestarë personal dhe mundësia e zgjedhjes së tij nga ana e përfituesit të këtij ligji.

Gjithashtu është me rëndësi që këta persona lirohen nga pagesa e premiumit në Fondin e sigurimeve shëndetësore dhe shumë beneficione të tjera, si për shkollim, udhëtim, përkujdesje për strehim e tjera.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë Projektligj, e përkrah në parim dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin funksional gjatë fazës së amendamentimit, e sidomos do të përkujdesemi që neni 7 paragrafi 2 i këtij projektligji, i cili nen flet për kompensim të këtyre personave për parandalim të plagëve dekubitare ku do të marrin shumë shtesë prej 50 eurove kurse ne do të angazhohemi që kjo shumë të jetë më e madhe sepse nevojat janë shumë të mëdha për këta persona.

Gjithashtu kërkojmë nga Qeveria që sa më shpejt të na sjellë Projektligjin gjithëpërfshirës për aftësinë e kufizuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryetar!

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në parim e përkrah këtë projektligj për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, mirëpo ne si Grup Parlamentar mendojmë se ka hapësirë për amendamentim dhe për kontributin e deputetëve që janë edhe në kuadër të Komisionit por edhe ne që jemi këtu të pranishëm.

Sipas informatave që i kam edhe nga Qeveria dhe nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Arban Abrashi, janë duke punuar për Projektligjin që përfshihen të gjitha kategoritë për personat me aftësi të kufizuar në mënyrë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara, siç janë kategoritë me dëmtime fizike, dëmtime intelektuale, e po ashtu edhe dëmtime të kategorive tjera - të verbrit, që të jenë të përfshirë në mënyrë që të mos i diskriminojmë në kategori, njëres kategori t'i japim më shumë privilegje e tjetra të anashkalohet.

Shpresoj për kontributin e deputetëve dhe ato t'i dorëzojnë te komisioni përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi më të paraqitur për diskutim, as nga grupet parlamentare e as nga deputetët, dhe as përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 64 vota për, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimet

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për sigurimet dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

NASER OSMANI : Faleminderit, kryetar!

Komisioni në mbledhjen e mbajtur ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe i ka rekomanduar seancës për votim dhe për përkrahje, prandaj në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e përkrahim raportin në fjalë.

KRYETARI: Faleminderit! Në qoftë se askush nuk është lajmëruar nga komisionet e përhershme si kanë të drejtën për diskutim në këtë projektligj më lejoni të theksoj janë propozuar gjithsej 46 amendamente. Ne do të vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara në raportin e Komisionit Funksional.

Komisioni Funksional i ka, më lejoni vetëm një moment, atëherë do të shkojmë 46 amendamente janë nga komisioni funksional në qoftë se jeni për në parim shkojmë të gjitha 46, i votojmë përnjëherë që ka kundër le të deklarohet dikush. S'ka kundër. Atëherë shkojmë, jemi duke votuar në fillim vetëm amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional 46. Kush është kundër? A ka abstenim? Atëherë 64 deputetë kanë votuar për amendamentet nga 1 deri 46. Tani të nderuar deputetë votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash në tërësi. 62 deputetë kanë votuar, 62 janë për. Kuvendi miratoi Ligjin për sigurimet.

19. Zgjedhja e një anëtarë joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Urdhëro, zoti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!
Në emër të grupit kërkoj që kjo pikë të shtyhet për një seancë tjetër.

KRYETARI: Ftoj grupet parlamentare tjera, urdhëro zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Edhe ne e përkrahim propozimin që të shtyhet, të hiqet nga rendi i ditës sot të lihet për një seancë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Slavko, nga Lista serbe, urdhëro!

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, predsedniče!
I Poslanička grupa Srpske liste podržava da se ova tačka odloži za neku od narednih sednica.
Hvala!

KRYETARI: Zoti Damka!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Edhe Grupi “6+” e përkrah propozimin për në seancën e ardhshme të shqyrtohet.

KRYETARI: A ka dikush kundër, në qoftë se s'ka kundër vetëm Naiti. Sa veta janë kundër për shtyrje? Sa jeni kundër, ju lutem administrata. A shkojmë në votim elektronik, pra. Shkojmë në votim elektronik.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për propozimin e kryetarët e grupeve parlamentare në mënyrë unanime kanë kërkuar që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për një seancë të radhës,

edhe kush është për voton për këtë propozim, kush është kundër ose abstenim voton ndryshe. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim votojmë tash.

55 vota janë për, për ta shtyrë. 8 kundër, 1 abstenim. Shtyhet pika: Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, shtyhet për një seancë të ardhshme plenare.

20. Zgjedhja e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj kryetarin e komisionit ad hoc, zonjën Xhevahire Izmaqu, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë rekomandimin.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Unë jam për të vazhduar me procedura, nuk e di arsyen pse po kërkojnë kolegët e mi të shtyhet. Mendoj që duhet të vazhdojmë.

Si kryetare e komisionit do të lexoj raportin: Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së në bazë të neneve 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 9. 11. 2015 pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, vendosi që Kuvendit t'ia paraqes këtë rekomandim:

Pra, i rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me votim të fshehur. Për një pozitë të anëtarit të Bordit nga radhët e komunitetit serb propozohen për votim dy kandidatë si në vijim: Ivan Velkoviç dhe Mariana Adamoviç Simiq, Kuvendi pra bën përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së nga dy të propozuarit.

Anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen me mandat 3-vjeçar. Mund të vazhdojmë me votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, të nderuar deputetë për zbatimin e procedurës së votimit të fshehur kërkohet krijimi i një komisioni votues me përbërje nga një deputetë prej secilit grup parlamentar me mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

Ftoj përfaqësuesit e frupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtarë për komisionin votues. PDK-ja?

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar e propozon Blerta Deliu.

KRYETARI: LDK-ja?

ISMET BEQIRI: Ne të përhershmin, Salih Morina.

KRYETARI: “6+”?

MUFERA SHINIK: Kryetar, ne e propozojmë zotin Qerim Bajrami.

KRYETARI: Slavko Simiq?

SLAVKO SIMIĆ: Poslanička grupa Srpske liste predlaže Bojana Mitića za glasačku komisiju. Hvala!

KRYETARI: Duhet një deklaram formal për këtë komision vetëm me një ngritje formale e dorës. Konstatoj që Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

Lus komisionin që të fillojë me procedimin, ndërsa deputetët do të ftohen sipas radhës të votojnë.

Komisioni le të merr vend menjëherë. A është rast unikat sekretar e Arbeni janë të njëmendje, dy interpretues të mi të Rregullores. Jo, jo jemi në pikë të rendit të ditës, vetëm ju lus - komisioni le t’i marrë vendet.

Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylja, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku – Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, , Enver Hoxhaj, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmmkolli, Mexhide Mjaku, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Millka Vuletiq, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani.

Nenad Rashić, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha - Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selviqe Halimi, Srxhan Popović, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petrović, Synavere Rysha, Teuta haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmak, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Kadri Veseli.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: A ka mbetur dikush pa votuar, në qoftë se ka mbetur dikush le të votojë. A ke votuar ti, Kamish? E mirë, Nait ke votuar ti? Në rregull është.

BLERTA DELIU-KODRA: E pavlefshme, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, e pavlefshme, Ivan Belković, Ivan Belković, Mariana Adamović Simiq, Ivan Belković, Mariana Adamović Simiq, Ivan Belković, Ivan Belković, Mariana Adamović Simiq, Ivan Belković, e pavlefshme, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Mariana Adamović Simiq, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, e pavlefshme, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Mariana Adamović Simiq, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, e pavlefshme, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Mariana Adamović Simiq, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Mariana Adamović Simiq, Mariana Adamović Simiq, Mariana Adamović Simiq, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Ivan Belković, Mariana Adamović Simiq, Ivan Belković, Mariana Adamović Simiq, e pavlefshme.

KRYESUESI: Fjalën e ka kryesuesja e Komisionit, zonja Blerta Deliu-Kodra. Zonja Blerta e keni fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehur dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb në seancën plenare të mbajtur më 30 nëntor 2015, konstaton: në votim kanë marrë pjesë gjithsej 71 deputetë, të pavlefshme janë gjithsej 5 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim: Ivan Belković ka fituar 55 vota, Mariana Adamović Simiq ka fituar 11 vota. Në bazë të rezultateve të votimit në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të nenit 26, të Ligjit NR. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe nenin 51 të Rregullores së Kuvendit konstatohet se Ivan Belković zgjidhet anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radha e komunitetit serb me mandat 3-vjeçar.

KRYESUESI: Në bazë të raportit të Komisionit votues, konstatohet si në vijim: Për anëtare të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komunitetit serb u zgjodh Ivan Belković.

Urime zotit Belković!

22. Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për përzgjedhje për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërimin e kandidatëve si në vijim: 1. Ymer Havolli - kryesues, Frederik Artesani - anëtar, Behgjet Haliti - anëtar, Xholi Dikson - anëtarë dhe Ruzhdi Morina - anëtarë për përfaqësimin dhe këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre në Kosovë.

Fjalën e ka zoti Naser Osmani kryetar i Komisionit FunkSIONAL për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni në mbledhjen e mbajtur, më 21. 10. 2015 ka shqyrtuar propozimin e Komisionit për përzgjedhje për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe ka vlerësuar se kandidatët e propozuar Ymer Havolli kryesues, Frederik Artesani anëtar, Behgjet Haliti anëtar, Xholi Dikson anëtar, Ruzhdi Morina anëtar për përfaqësim dhe këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre i plotësojnë kushtet formale juridike të parapara me nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondin Pensional të Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit që anëtarët e Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës me mandat 3 vjeçar në pajtim me Ligjin 04/L-101 për Fondin Pensional të Kosovës të votohen nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani në qoftë se doni ta merrni fjalën kryetarët e grupeve besoj që s'ka nevojë, atëherë po e hedhim në votim raportin me rekomandime.

Kush është për? A, nuk kemi kuorum! Edhe njëherë besoj që kuorum ka të mjaftueshëm janë 63 deputetë. E hedh në votim, votojmë tash propozimin.

A ka dikush pa kartelë që s'ka mundur të votojë? Jo, atëherë e përsëris votimin, sepse në sallë janë 63 deputetë kanë votuar 57. Ju kisha lutur që të votoni nuk është me rëndësi si por vetëm të votoni. Gospodo Živkovič, oče te glasati?

Edhe njëherë pra ju lus që të përgatiteni për votim, votojmë tash. Faleminderit, konstatoj që 58 vota për, 4 abstenime dhe 2 vota kundër. Kuvendi e emëroi kryesuesin dhe anëtarët e Bordit Drejtues për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës me mandat 3-vjeçar.

23. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas

Komisioni për Legjislacion i ka shqyrtuar propozimet për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. E ftoj nënkryetarin e Komisionit FunkSIONAL zonjën Selvije Halimi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit duke u bazuar në nenin 11 dhe 12. 3 të Ligjit për ndihmë juridike falas Nr. 04/L-017 lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas në mbledhjen e mbajtur, më 30 tetor 2015, e rishqyrtoi propozimin e Ministrisë së Drejtësisë kurse në mbledhjen e mbajtur, më datë 03.11.2015 shqyrtoi propozimin nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqes këtë rekomandim: të emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës anëtarët e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas kandidatët: Baki Gimolli, nga Ministria e Drejtësisë; Feim Osmani, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Milena Vuçiq, Ministria për Komunitete dhe Kthim; Enis Spahiu, Ministria e Financave; Safet Voca, Oda e Avokatëve të Kosovës; Valon Tolaj, Gjykata Supreme dhe Adem Lushaj, organizata joqeveritare.

Mandati i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas është 3-vjeçar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që kryetarët e grupeve s’kanë ndonjë vërejtje, as deputetët nuk kanë ndonjë vërejtje.

E hedh në votim emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Atëherë, me 58 vota për, 3 abstenime, 4 kundër, Kuvendi i emëroi anëtarët e Këshillit për Ndihmë Juridike Falas me mandat 3-vjeçar me këtë përbërje: Baki Gimolli nga Ministria e Drejtësisë; Feim Osmani, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Milena Vuçiq, Ministria për Komunitete dhe Kthim; Enis Spahiu, Ministria e Financave; Safet Voca, Oda e Avokatëve të Kosovës; Valon Tolaj, Gjykata Supreme dhe Adem Lushaj, organizata joqeveritare.

24. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor, të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës

Komisioni për Punë të Jashtme ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Është caktuar Blerta Deliu që të flasë në emër të Komisionit për Punë të Jashtme.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryetar i Parlamentit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra, deputetë,

Komisioni për Punë të Jashtme në kuadër të ushtrimit të aktiviteteve të tij pos të tjerash ka mbikëqyrur edhe zbatimin e Ligjit për zbatimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, Grupi Punues i kryesues nga deputetja Puhie Demaku në përbërje të deputetëve Zafir Berisha, Teuta Rugova,

Qerim Bajrami ka zhvilluar aktivitete në misionet konsullore në Gjenevë, Bernë, Shtutgart dhe Frankfurt me qëllim të mbledhjes së informatave mbi nivelin e zbatimit të ligjit.

Kemi arritur të vlerësojmë se Ligji për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës është duke u zbatuar megjithatë gjatë analizave të bëra kemi identifikuar edhe disa mangësi, të cilat i kemi evidentuar dhe ngecje në zbatim që në formë të rekomandimeve Komisioni për Punë të Jashtme në mbledhjen e mbajtur, më 29. 7. 2015 i ka miratuar dhe i ka propozuar me synim që shqyrtimit dhe miratimi i tyre nga mbledhja plenare të avancojë në zbatimin e ligjit në fjalë.

Në vijim po i lexoj rekomandimet që janë propozuar nga Komisioni për Politikë të Jashtme, konkretisht nga grupi punues. Kandidatët e zgjedhur për zyrtarë konsullor në misionet konsullore të Republikës së Kosovës në shtetet pranuese t'i nënshtrohen trajnimit dhe certifikimit nga Ministria e Punës së Brendshme për ushtrimin kualitativ të detyrës së tyre. Në misionet konsullore të Republikës së Kosovës të ndërmerren masa për zbatimin e nenit 12.2 të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës në harmoni me infrastrukturën ligjore në Kosovë dhe atë të shtetit pranues.

Të miratohet sa më parë kërkesa për hapjen e terminalit për pagesat e taksave nga qytetarët tanë pranë misioneve konsullore të Republikës së Kosovës në Berlin, Shtutgart dhe vendet e tjera ku është e nevojshme. Të plotësohet numri i punonjësve administrativ teknik në misionet konsullore që kanë mungesë të stafit dhe pushimet vjetore të tyre të merren në mënyrë të koordinuar me qëllim që të përmbushen nevojat e bashkatdhetarëve gjatë sezonit të verës. Klientët konsullore të ju mundësohet aplikimi i dyfishtë i dokumenteve dhe dërgimi me postë i dokumenteve nëse këto kërkohen.

Ministria e Punëve të Jashtme të klasifikojë lartësinë e taksave konsullore varësisht nga standardet e shteteve ku vepron misioni konsullor. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të brendshme të arrijnë marrëveshje që në misionet konsullore të sigurohen skaner për fotografim të fëmijëve të moshës 0 deri 5 vjeçare. Dhe, rekomandimi i fundit Ministria e Punëve të Jashtme të gjejë mundësinë e sigurimit të ekipeve mobile për kryerjen e shërbimit konsullor për të sëmuret dhe personat me aftësi të kufizuar, posaçërisht në misionet konsullore ku numri i klientëve konsullor është tejet i madh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani të nderuar deputetë po vazhdojmë me votimin e raportit me rekomandimet e Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Ligjit të shërbimit konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Urdhëro, Nait! A do të flasësh diçka? Në rregull, kurrkush s'ishte i paraqitur, në qoftë se ke diçka të thuash. Po tash s'po paraqitet kurrkush, Nait. Nuk është paraqitur askush. Vazhdojmë me votimin e raportit me rekomandimet e Komisionit për Punë të Jashtme jo e humbi të drejtën Naiti, dy herë ia dhashë fjalën, dy herë s'e mori. Hajde, Nait! Zoti Hasani e ka fjalën!

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Për raportin është mirë të flitet jo vetëm për certifikatat që do t'i shtyp fotografitë që do t'i bëjë në Berlin, Shtutgart, në Paris apo kudo tjetër.

Ne vazhdimisht themi duhet të bëjmë integrimet evropiane, do të bëjmë angazhimet tona diplomatike edhe nëse është vetëm angazhim diplomatik me shtyp certifikata nëpër konsullata, atëherë ne nuk e kemi zgjedhur problemin tonë, nuk ka integrim. Shërbimi konsullor dhe konsullatat, ambasadat kanë nevojë për mbështetje, sidomos kanë nevojë për mbështetjen e vendeve dhe Kuintit që po u thoni ju shteteve të fuqishme, siç janë: Gjermani, Franca, Turqia, Amerika dhe Britania.

Nëse me këtë buxhet që e kanë përcaktuar për ambasadat edhe për shërbimet konsullore atje mos mendoni që mund të integrohemi na. E them këtë kemi qenë në Berlin në ambasadën tonë atje, buxheti i një ambassade është buxhet mund të them që brenda ditës shpenzimet ditore që mund t'i kapërthyer Kuvendi i Kosovës aq është. Atë që duhet të bëhet kur të shkoni flisni atje, për atë jemi në këtë gjendje ku jemi sot duke ia bërë rrafsh njëri-tjetrit, duke lëmuar, dhe duke shikuar veç hajt ta kapërcejmë ditën sot. Nuk është problem vetëm ta kalojmë një raport të votojmë, por mendoni që jemi duke shkuar drejtpërdrejtë bllokadës. Shtetet e perëndimit nuk na kanë njohur dhe s'po e njohin zhvillimin tonë, ju kot flisni këtu, ne po integrohemi. Kot thërrasim direktiva evropiane që i kemi mbush krejt ligjet me direktiva evropiane e as nuk zbatohen.

Po, duhet të ndahet buxhet, Qeveria duhet të ndajë buxhet për shtetet e fuqishme që atje të bëhet lobimi. Kemi qenë në Berlin thoshte veç një gazetë na ka ardhur dhe kemi bërë në Prishtinë e kemi shtyp dhe ato jemi si propagandë duke e bërë. Asnjë shërbim konsullor nuk e ka asnjë prodhim vendor atje që duhet të shërbejë dhe duhet ta bëjë reklamën e propagandën për zhvillimin tonë, por të gjitha këto ju duken përralla dikujt e me përralla kemi jetuar që 15 vjet. Me përralla nuk na pranon Evropa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Nait!

Edhe një herë po e përsëris, vazhdojmë me votimin e raportit me rekomandimet e Komisionit për Punë të Jashtme për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! Konstatoj që me 60 vota për, 6 abstenime, 4 vota kundër, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Jashtme për Mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbimin konsullor, të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Jemi në pikën e radhës:

25. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për miratim në seancën plenare.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional zotin Muhamet Mustafa për arsyetimin e raportit me rekomandime. Regjia, ju lutem se po ka problem ngapak. Fjala është për profesorin Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni ka trajtuar raportin vjetor të punës për vitin 2014 të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe ka konsideruar se në këtë sektor është një proces i ndryshimeve të rëndësishme strukturore të cilave me vështirësi disa nga operatorët po iu përmbushen, ndërsa problemi kryesor mbetet tek rregullimi i konkurrencës edhe te operatorët ilegalë, të cilët ky autoritet ende nuk mund t'i kontrollojë dhe t'i evitojë gjë që kjo mbetet një sfidë edhe në të ardhmen.

Ju i keni marrë edhe rekomandimet:

1. Rekomandimi i parë ka të bëjë me atë se Qeveria të harmonizojë legjislacionin me direktivat e Bashkësisë Evropiane, konkretisht të evitojë mos përputhshmërinë e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe Ligjit për komunikime elektronike sa i përket financimit dhe ruajtjes së pavarësisë rregullatore.

2. Qeveria në një afat sa më të shkurtër, besoj që kjo veç është në proces, të procedojë në Kuvend kandidatët për kompletim të bordit.

3. Rregullatori të punojë një platformë dhe të sigurojë zbatimin e masave të nevojshme për matjen e standardeve të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve të operatorëve ndaj konsumatorëve në komunikimet elektronike dhe postare,

4. Rregullatori të dërgojë informata shtesë me shkrim sa u përket operimeve ilegale dhe për çështjen e ankesave të qytetarëve.

Faleminderit për vëmendje dhe ju ftoj që ta votoni raportin me këto rekomandime.

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014, bashkë me rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 65 vota për, 1 kundër, 1 abstenim. Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2014 së bashku me rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

26. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015 të propozuar nga Qeveria dhe Kuvendit ia ka rekomanduar mosmiratimin e tij në seancë plenare.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Ferid Agani, si propozues i çështjes.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministër,

Të nderuar deputetë,

Mua më vjen keq që Komisioni Funkcional e ka rekomanduar mosmiratimin e këtij raporti, sepse në procedurën e shqyrtimit të tij nuk e ka parë të udhës që të konsultohet fare me ministrinë, ose që të jetë ndonjë prej përfaqësuesve të ministrisë i pranishëm në atë mbledhje, kur është dashur që të argumentohet raporti.

Përndryshe, raporti është për herë të parë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, edhe pse ka qenë obligim ligjor me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, në bazë të nenit 25, që Qeveria e Kosovës me propozim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor t’ia paraqesë Kuvendit raportin për gjendjen e mjedisit. Pra, ky raport ka qenë për herë të parë para deputetëve, paraqet një prerje të punës dhe angazhimeve që janë bërë në Ministrinë e Mjedisit në vitin 2013 dhe 2014. Pra, raporti e ka titullin “Raporti i Mjedisit 2015” në bazë të praktikave të shteteve të Bashkësisë Evropiane, që kështu e titullojnë raportin gjithmonë, kur bëhet fjalë për vitet paraprake.

Raporti paraqet një studim analitik të gjendjes aktuale në mjedisin e Kosovës. Pra, raporti është një prerje objektive dhe pasqyrim objektiv i gjendjes në mjedisin e Kosovës dhe paraqet një pikënisje të mirë për analizë dhe për nxjerrjen e përfundimeve të duhura, si dhe, natyrisht, përpilimin e politikave të mëtutjeshme dhe qëndrimeve të Kuvendit të Kosovës përkitazi me mjedisin.

Ne e dimë se mjedisi është një prioritet i madh, së paku deklarativ, i të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, i Qeverisë së Kosovës, por kur vjen puna te konkretizimi i këtij motivacioni dhe këtij vullneti, atëherë gjithmonë, nga viti në vit, në ndarjet buxhetore gjithmonë ngelim në bisht të ngjarjeve dhe me Buxhetin e Kosovës edhe për vitin 2016 parashihet në maksimum rreth 1% e buxhetit për këto projekte, që janë larg prej nevojave reale për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në shtetin tonë, veçanërisht kur janë në pyetje sistemet për mirëmbajtjen e cilësisë së ajrit, pra për mirëmbajtjen e kontrollit të cilësisë së ajrit, të tokës, të ujërave, sistemit për menaxhimin e ujërave të zeza në shtetin tonë.

E dimë mirë se shumë prioritete komunale janë adresuar nëpër komuna të Kosovës, duke filluar nga shkollat, rrugët, objektet tjera me rëndësi publike, por kur është në pyetje trajtimi i ujërave të zeza, kur janë në pyetje impiantet, kur është në pyetje ruajtja e lumenjve tanë prej tyre, aty ka pasur vëmendje shumë të ulët, filluar nga pushteti lokal e duke përfunduar me atë qendror.

Raporti “Gjendja e Mjedisit në Kosovë 2015” është bazuar në modelet e pranueshme të raportimit dhe në rrethanat ekzistuese mjedisore në Kosovë. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, nga kompanitë, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burimet tjera. Të gjitha këto të dhëna të grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative, që tani janë prezantuar në këtë raport.

Ky raport i ka 6 kapituj dhe në pjesën hyrëse të tij është prezantuar metodologjia e përdorur për hartimin e raportit.

Në pjesën e dytë bëhet fjalë për forcat shtytëse në mjedis, ku janë trajtuar disa nga forcat që vlerësohet se janë shtytësit kryesorë mjedisor.

Në pjesën e tretë të raportit trajtohen presionet që i bëhen mjedisit nga sektorë të ndryshëm zhvillimorë.

Në pjesën e katërt trajtohet gjendja e mediumeve mjedisore dhe aspektet tematike të këtyre mediumeve, siç janë: ajri, uji, toka, jodiversiteti, zona të mbrojtura dhe mbeturinat.

Në kapitullin e ndikimeve në mjedis, pjesa e pestë e këtij raporti, janë trajtuar ndryshime klimatike dhe ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës.

Në kuadër të kapitullit për reagimet apo masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së mjedisit janë trajtuar masat kryesore, që janë ndërmarrë nga institucionet, sikurse janë: hartimi i legjislacionit mjedisor dhe transpozimi i tij me direktivat e Bashkësisë Evropiane; hartimi i strategjive dhe planeve mjedisore; sistemi i monitorimit të mjedisit; investimet në mjedis si dhe iniciativat regjionale dhe ndërkombëtare mjedisore.

Në pjesën e investimeve në mjedis prezantohen disa nga projektet kryesore mjedisore: burimet e financimit nga Buxheti i Kosovës dhe burimet nga komuniteti i donatorëve. Kurse, në pjesën e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar janë prezantuar disa prej aktiviteteve, iniciativave dhe programeve, në të cilat kanë marrë pjesë institucionet mjedisore të Kosovës.

Të gjeturat kryesore të raportit tregojnë se si rezultat i nevojave të mëdha të zhvillimit ekonomik ka kërkesa në rritje për shfrytëzimin e resurseve natyrore, ku sektori i energjisë vlerësohet si sektori që ka ndikimin më të madh në mjedis dhe njëherësh është edhe kontribuesi më i madh i emisionit të gazrave serë.

Sa i përket cilësisë së ajrit, konstatohet se përkundër arritjeve, ka tejkalim të vlerave limite, sidomos për grimcat PM-10 dhe PM-2,5, për grimcat e pluhurit.

Treguesit e cilësisë së ujërave tregojnë se ka trend të rritjes së ndikimit dhe cilësinë e ujit, sidomos nga ndikimi i mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, siç thashë.

Unë shpresoj që ju e keni lexuar këtë raport, keni pasur rast të njoftoheni me të dhënat në të. Unë shpresoj se puna që është bërë në këtë raport do të vlerësohet, të dhënat janë këto që janë në këtë

raport dhe janë të verifikueshme, mund të krahasohen, mund të verifikohen me të gjeturat dhe metodologjinë, e cila është përdorur me rastin e arritjes deri te to. Dhe, konsideroj se është bërë një punë e mirë, si pikënisje.

Në qoftë se raportin duam ta vlerësojmë nga këndvështrimi i pajtimit, ose mospajtimit me gjendjen e mjedisit, është çështje tjetër. Atëherë, nga pakënaqësia jonë me gjendjen e mjedisit, me të cilën jemi të rrethuar dhe njëlloj përshtypje, ajo përshtypje personale, nuk është në pajtim me të dhënat e paraqitura në raport, mendoj se nuk është e drejtë që raporti të mos miratohet, sepse diskrepanca është vetëm ndërmjet dëshirave dhe pritjeve tona, asaj që duam në mjedis dhe realitetit që e kemi, por jo ndërmjet të dhënave të raportit dhe realitetit, i cili është në terren. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetë të nderuar,

Mirë është t'i dëgjojmë nga pak diskutuesit, se ministri foli, por patëm pak vëmendje.

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me votimin e raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovës për vitin 2015. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten... keni të drejtë plotësisht. Keni të drejtë. Fikrim Damka dhe tre diskutues të tjerë pastaj janë lajmëruar.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ne si komision dhe në cilësinë e kryetarit të komisionit, dua t'i lexoj rekomandimet që ne i kemi marrë.

Më 29. 9. 2015 e kemi shqyrtuar këtë raport të mjedisit nga Ministria e Mjedisit për vitin 2015 dhe kemi vendosur që të mos miratohet. Pas shqyrtimit të raportit në fjalë vlerësuam se nuk i plotëson kushtet e parapara për ta miratuar atë, nga se nuk paraqet gjendjen reale të mjedisit që e ka Kosova, e cila është megjithatë tejte e ndotur dhe kërkon, së paku, një pasqyrë reale, e cila do të shërbejë për konsolidimin vizual në të ardhmen.

Ndaj, Komisioni rekomandon që raporti të mos miratohet dhe të kthehet për ripunim. Edhe në faqen e parë, ndoshta nuk e njoh shumë mirë gjuhën shqipe, por ky raport nuk është për vitin 2015, ndoshta është në vitin 2015, se ky raport ka ardhur te ne më 07.9.2015, ende nuk është përfunduar 2015-ta. Brenda raportit asnjë vlerë nuk ka, asnjë shifër për 2015-tën nuk ka, e si mund të flasim ne për raportin e mjedisit për 2015-en, të lutem.

KRYETARI: Po bëjmë bashkëbisedim. Po, të gjithë deputetët do ta marrin fjalën. Ministri, pastaj deputetët.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti deputet,

E thashë edhe një herë, është fjala për praktikë evropiane. Këtu e keni raportin për gjendjen e mjedisit në Evropë të vitit 2015. Edhe atje s'ka përfunduar viti 2015 ende, por është praktikë. Raporti për gjendjen e mjedisit i përpiluar në vitin 2015, unë thash, raporti ynë është për vitin 2013 dhe 2014. Të dhënat e këtyre dy vjetëve janë analizuar dhe paraqitur.

KRYETARI: Faleminderit! Emilija Rexhepi e ka fjalën, të bëhet gati Nait Hasani.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala predsedniče!

Poštovani premijeru,

Zameniće premijera,

Predstavnici vlade, kolege poslanici,

Skupština Republike Kosova na osnovu člana 65, tačka 1 Ustava Republike Kosovo u cilju stvaranja standarda o životnoj sredini na Kosovu, u skladu sa standardima Evropske Unije usvojila je Zakon o zaštiti životne sredine. Ovim zakonom se usklađuje privredni razvoj i socijalno staranje sa osnovnim načelima o zaštiti životne sredine, prema konceptu održivog razvoja.

S obzirom da je cilj ovog zakona da promoviše stvaranje zdrave životne sredine za narod Kosova, postepenim prihvatanjem standarda za životnu sredinu Evropske Unije a prirodne vrednosti su delovi prirode, koji zaslužuju posebnu zaštitu, zbog njihove osetljivosti ili naučnog, estetskog, kulturnog, istorijskog, prosvetnog i ekonomskog interesa. Parlamentarna Grupa PDK smatra da je životna sredina na Kosovu i dalje suviše zagađena, te ne može podržati izveštaj Vlade, odnosno Ministarstva za Zaštitu Životne Sredine za 2015. godinu, koji ne pokazuje realnu situaciju na terenu po svim opštinama. I članovi naše grupe će podržati predlog Komisije za Poljoprivredu, odnosno preporuku da se Vladin izveštaj o stanju životne sredine na Kosovu za 2015. godinu vrati na doradu u Vladi, kako bi celokupna situacija imala realan status tokom sledećeg razmatranja u Skupštini od strane svih poslanika. Zahvaljujem se, predsedniče!

KRYETARI: Faleminderit! Nait, e ke fjalën. Të bëhet gati Adem Salihaj.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Atë që e tha kryetari i komisionit, duket shumë e paqartë. Të jesh një kryetar komisioni e të mos jesh në rrjedhat e zhvillimeve, sidomos të raporteve...

Kam qenë kryetar i Komisionit për Bujqësi dhe Mjedis dhe kemi hartuar dhe miratuar raportet, pikërisht për vitet paraprake dhe raportet të cilat vijnë nga Ministria e Bujqësisë me atë buxhet që e ka, nuk ka mundësi t'i tejkalojë të gjitha ato sfida, që i ka përpara. I ka ujërat e zeza, lumenjtë, e ka ndotjen e mjedisit në përgjithësi edhe nga ndotjet e vajrave dhe rrugëve e automobilave.

Prandaj, të gjitha këto kanë ndikuar dhe ndikojnë që buxheti i vogël të mos mund ta tejkalojë këtë gjendje. Megjithatë, ajo që duhet është që ky raport duhet të tejkalohet, duhet të miratohet edhe nga grupi parlamentar edhe nga deputetët tjerë, për shkak se me këtë i përcaktojmë sfidat e mundësitë, të cilat neve na duhet t'i tejkalojmë në të ardhmen në mjedis. Nëse ne nuk e miratojmë këtë raport, ky raport do të kthehet prapë i njëjti, se nuk ka mundësi të ndryshohet atje, e të themi pas një jave do të jetë më i mirë. Gjendja është e tillë. Në raport është konstatuar një gjendje faktike, e cila është. E tash, për ta ndryshuar këtë, varet prej kryeministrit, zëvendëskryeministrave e të gjithë të tjerëve, të cilët e kanë buxhetin, ata që duhet ta ndryshojnë.

Prandaj, kërkoj që të miratohet raporti dhe t'i japim sfidat që duhet të ndryshohen e duhet të përmirësohen, si ujërat e zeza në kanalizime dhe në lumenj, që është një nga sfidat kryesore, sidomos heqja e zhavorrit nga lumenjtë, që ka pasur një vendim kryeministri i atëhershëm e ka

nxjerrë, për një vit të mos nxirrej zhavorri, për shkak se ka qenë plani për tu bërë një projekt e për tu rehabilituar lumenjtë. Por, edhe ajo nuk ka mundur të arrihet dhe kemi pasur pikërisht konfiskime të kamionëve të zhavorrit, të cilët janë objekte të gjyqeve tash, që nuk kanë mundur të adresohen. Neve na duhet ta miratojmë raportin dhe ta zgjidhim këtë problem. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Nait! Fjalën e ka Adem Salihaj, të bëhet gati Bekim Haxhiu, e ka kërkuar fjalën edhe kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së.

ADEM SALIHAI: Faleminderit!

Unë mendoj se është një keqkuptim këtu te fakti, që komisioni unanimitasht ka vendosur ta kthejë këtë raport dhe t'i rekomandojë Kuvendit, që të mos aprovohet.

Keqkuptimi është në faktin që këtu po mendohet, se raporti paraqet gjendjen e keqe dhe për këtë arsye ne kemi vendosur ta kthejmë. Është e kundërta. Raporti paraqet gjendjen e mjedisit në Kosovë shumë të mirë, me një problem minor në Obiliq, vetëm në Obiliq e askund tjetër dhe gjendja tjetër është aq e mirë, aq ideale, sa vështirë që e ka një shtet i zhvilluar diku tjetër.

Pra, problemi është se raporti nuk është real krahasuar me gjendjen e keqe të mjedisit në Kosovë dhe për faktin, që raporti që është për dy vjetët e kaluara 2013-2014 ka ardhur me së paku gjatë muaj vonesë në komision, në Parlament, edhe pse është dashur të vijë në fillim të vitit, ky ka ardhur gati në fund të vitit.

Pra, si komision mendojmë unanimitasht që t'i rekomandojmë Kuvendit që ta kthejë këtë raport, sepse nuk e paraqet gjendjen reale të mjedisit në Kosovë. Pra, s'e paraqet gjendjen e keqe, po e paraqet shumë të mirë, që realisht nuk është ashtu. Kjo është arsyeja, pra që kemi vendosur dhe unë propozoj që të përkrahet rekomandimi i komisionit.

KRYETARI: Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

I nderuar ministër i Mjedisit,

Komisioni përkatës ka pasur një pajtueshmëri si dhe e të gjithë neve është një pajtueshmëri, se gjendja e mjedisit në Kosovë nuk është e mirë. Mirëpo, raporti nuk mund të refuzohet për shkak se nuk i përmbush kushtet për trajtim dhe shqyrtim. E kam lexuar raportin. Raporti është detal dhe paraqet të dhënat detale sa i përket gjendjes së mjedisit dhe është një raport, i cili është i bazuar edhe në Ligjin mbi mjedisin, neni 25 të Ligjit për mjedisin, që ka qenë detyrim i institucioneve relevante, për të informuar dhe raportuar në Kuvend dhe për të hartuar këtë raport në Kuvend, sa i përket gjendjes së mjedisit.

Miratimi i këtij raporti do të jetë obligim edhe për Qeverinë dhe institucionet përkatëse, për ndjekjen e strategjisë që është e paraparë me anë të këtij raporti. Ajo që më mbetet dhe për çka realisht e mora fjalën për të diskutuar, është që disa sfida të cilat në këtë raport paraqiten sa i përket gjendjes së mjedisit, qoftë në aspektin e ndotjes së tokës, qoftë në aspektin e ndotjes së ujërave të zeza apo tek problemet të cilat janë të paraqitura edhe në Raportin e Progresit, sfidat sa i përket ndotjes së ambientit, në veçanti në zonën e Obiliqit, ku ndotja e ambientit është më e

theksuar, pastaj në komunën e Drenasit nga ndotësi i madh “Ferronikeli” atje, pastaj mbetjet minerale në zonën e Mitrovicës dhe mbetje tjera, të cilat nuk ka arritur ministria, që në planifikimet e saj të ndërmarrë hapat e duhur.

Një fakt tjetër shumë shqetësues është trajtimi i mbeturinave. Në raport, keni parasysh këtu, i nderuar ministër, në faqen, ku deklaroni që në sektorin e mbeturinave mbetet sfida investimi në infrastrukturë për menaxhimin e mbeturinave dhe ngritjes së shkallës së vetëdijes, ndërgjegjësimit dhe informacionit për menaxhimin e mbeturinave. Ndërsa, me buxhetin e vitit 2016 nuk keni paraparë asnjë investim, sa i përket infrastrukturës në këtë sektor.

Prandaj, mendoj që ne duhet ta votojmë raportin dhe me këtë raport t’u obligojmë që vërtet ta përmirësoni gjendjen e ambientit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Nuk ka asnjë diskutues të lajmëruar. Shkojmë... Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Ne e dimë të gjithë, se nuk e kemi gjendjen ashtu siç dëshirojmë, si duhet të jetë, por ne duhet të gjykojmë dhe të veprojmë në përputhje me mundësitë tona.

Unë vlerësoj se duke pasur parasysh vërejtjet që u dhanë, propozoj që të votohet për këtë raport, por me kusht që të plotësohen edhe ky raport të plotësohet për të ardhmen, me vërejtjet që u dhanë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë tjerë të lajmëruar. Shkojmë në votim për raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Komisioni e ka sjellë për mosmiratimin e tij, po tash ka qëndrime të ndara. Është interesant rezultati i votimit. Shkojmë...

Është rekomandimi i komisionit që të mos miratohet raporti për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015 dhe t’i kthehet Qeverisë në ripunim. A shkojmë në votim? Votojmë tash! Ju lutem!

Konstatoj se Kuvendi me 30 vota kundër, 27 vota për, 5 abstenime nuk e miratoi raportin për gjendjen e mjedisit. Dëgjo, vetëm pak, i nderuar sekretar, unë e kam të shkruar kështu: Konstatoj se Kuvendi nuk e miratoi raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015. Unë do të thosha se e miratoi raportin për gjendjen e mjedisit në vitin 2015.

Vetëm pak! A ka mundësi ta bëj një sqarim paraprakisht. Më lejoni, vetëm një moment, keni të drejtë, se janë formulimet.

Komisioni e ka sjellë rekomandimin për të mos e miratuar raportin, por kjo seancë ia miratoi raportin ministrisë. Kjo është, se këtë e kisha kontest. Atëherë pra, Kuvendi e miratoi raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2015.

27. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për persona të verbër

Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi, Persona të Pagjetur dhe Peticione ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për persona të verbër dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Ftoj raportuesen e Komisionit FunkSIONAL, deputeten Salihe Mustafa për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit dhe vendimit të komisionit të datës 16 shkurt bëri mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për persona të verbër në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL.

Komisioni me vendim ka formuar grupin punues, i cili ka bërë monitorimin e zbatimit të ligjit për së afërmi dhe ka organizuar takime monitoruese në këto institucione dhe shoqata: në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale; në Ministrinë e Shëndetësisë; në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; në Ministrinë e Infrastrukturës; në Ministrinë e Financave; shoqatat për persona të verbër në Prishtinë, Gjiilan, Pejë, si dhe Shkollën speciale për persona të verbër në Pejë.

Mbi bazën e të gjeturave faktike grupi punues ka hartuar raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, të cilin ia ka paraqitur Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, për shqyrtim dhe miratim.

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 7.10.2015, vendosi...

KRYETARI: Më fal, deputete! A ka mundësi për qetësi, për arsye se nuk po mund të vazhdojmë seancën!? Vazhdo, e nderuar deputete!

SALIHE MUSTAFA: ... që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

I rekomandohet Kuvendit që të miratojë Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për persona të verbër me rekomandimet, si vijon:

- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për personat e verbër nr. 04/L-092;

- Të ndryshohet dhe plotësohet neni 7.3 i ligjit. Ky nen i përjashton personat e verbër nga e drejta e kompensimit nga skemat tjera pensionale kontributdhënëse, e pleqërisë dhe sociale;

- Të ndryshohet dhe plotësohet neni 7.4 i ligjit. Ky nen nuk është plotësisht i qartë, sepse ka përcaktuar të drejtën e kompensimit material për shoqëruesin e personit të verbër, por nuk i ka përcaktuar kriteret, të cilat duhet t'i plotësojë një person për të qenë shoqërues i personit të verbër;

- Të zbatohet dispozitat e neneve 9.2, 10.2, 10.3, 13.1 dhe 15 të Ligjit nr. 04/L-092 për persona të verbër. Këto dispozita të ligjit në fuqi sipas të gjeturave faktike nuk janë duke u zbatuar ende;

- Të nxirren të gjitha aktet nënligjore nga Qeveria dhe ministritë e autorizuar: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministria e Financave; Ministria e Infrastrukturës, në afat prej 6 muajve nga dita e miratimit të rekomandimeve nga Kuvendi.

- Të nënshkruhet marrëveshja e përbashkët e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Shëndetësisë në bashkëpunim me Shoqatën e Personave të Verbër për zbatimin e nenit 10.3 të Ligjit, në afat prej 6 muajve nga dita e rekomandimeve në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ethem Arifi e ka fjalën.

ETHEM ARIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin me rekomandimet për Ligjin për të verbrit. Njëherësh konstatojmë se sipas mbikëqyrjes së ligjit në terren, siç e tha edhe raportuesja e komisionit, ju rekomandojmë që ta votoni raportin me rekomandimet në vijim, siç i përmendi edhe raportuesja e komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mexhide Mjaku-Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Ne si anëtarë të grupit punues kemi pasur qëllim që të kontrollohet Ligji për persona të verbër, shkalla e zbatueshmërisë, qartësia dhe gjithëpërfshirja e materies që është rregulluar me ligj.

Në bazë të planit të veprimit kemi mbajtur takime dhe vizita monitoruese. Nga takimet dhe vizitat e realizuara kanë dalë të gjeturat dhe rekomandimet, që u paraqitën para nesh dhe i keni në raport të gjithë deputetët.

Pos tjerash, mendoj se do të ishte e nevojshme që secila qendër burimore në Kosovë, por edhe drejtoritë komunale të arsimit të kenë një komision vlerësues, diagnostifikues për këtë kategori, sepse në këtë mënyrë do t'i lehtësonte punën edhe ministrisë, si dhe të realizohet një fushatë trajnuese për mësimdhënësit, në mënyrë që të aftësohen sa më mirë në zbatimin e PIA-së, sepse në shkolla të rregullta po mungojnë mësimdhënësit dhe edukatorët mbështetës dhe se po paraqiten vështirësi të natyrave të ndryshme.

Janë të nevojshme trajnimet në vazhdimësi, në mënyrë që mësimdhënësit të jenë të përgatitur me metodat dhe pajisjet moderne dhe në këtë mënyrë të arrihet deri te suksesi i paramenduar.

Po ashtu, Ministria e Punës dhe Ministria e Arsimit duhet të ndërmarrin masa me qëllim që të gjitha institucionet shkollore, universitetet, qoftë ato publike dhe ato private të sigurojnë kushte dhe standarde teknike të objekteve për qasje dhe qëndrim të përdoruesve të karrocave, përpos në hyrje të objekteve apo institucioneve, po ashtu edhe në katet e objekteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, e nderuar deputete! Kërkoj pak qetësi, ose e bëjmë një pauzë, në qoftë se jeni lodhur.

Atëherë, ju lutem për qetësi! Edhe kryetarja, në fakt raportuesja e komisionit e tha një mori gjërash, të cilat ndërlidhen. Kjo kategori me nevoja të veçanta kur të na dëgjojnë, ata mendojnë se do të arrijmë t'i zgjidhim edhe këto çështje të cilat ju i përmendët.

Do të ishte mirë, që të mos kalojnë vetëm si çështje formale, sa i kemi përmendur këtu, bile të paktën disa prej tyre të plotësohen për këtë kategori të veçantë. Se, u përmendën një varg masash, ndërkohë unë e pyeta edhe Administratën, nuk janë obligative me këtë moment edhe në qoftë se e votojmë Raportin me rekomandime. Ndërrimi i ligjit, ku e thatë në disa vende, se duhet të preket, me e pas parasysh.

Ne do të shkojmë në votimin e saj, po e përmenda vetëm për faktin, se janë kategori me nevoja të veçanta. Ngremë shpresën tek ata, gjersa të njëjtën kohë, pas sot mund ta harrojmë këtë çështje edhe nuk e ndërrojmë asgjë nga këtu për t'ua përmirësuar gjendjen e tyre.

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me votimin e Raportit me rekomandime të Komisionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit për persona të verbër. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 61 vota për dhe 1 kundër, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për persona të verbër.

28. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014

Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, deputetin Naser Osmani për arsyetimin e raportit me rekomandime.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

OK! Nuk ka të lajmëruar askush. Shkojmë te votimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash!

Vetëm pak! E ndërpresim procesin e votimit. Nuk pata të lajmëruar, tash u lajmëruat, deputet i nderuar. OK! Urdhëro! Ali Sadriu e ka fjalën. Unë nuk të pashë. Deri në momentin kur ke reaguar me dorë, nuk ka pasur në ekran asgjë. Faleminderit!

ALI SADRIU: Zoti kryetar!

Ju e adresuat në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ndërsa kjo është realisht përgjegjësi e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike. Dhe, unë në emër të kryetarit, i cili i takon opozitës e në këtë rast nuk është këtu, do ta prezantoj raportin. U kërkoj falje të pranishmëve, se e di që janë lodhur, por është raport vjetor dhe do të jetë paksa i zgjatur. Megjithatë, unë do të mundohem ta shkurtoj dhe do të jap disa informacione në pika të shkurta.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike ka shqyrtuar Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014, i cili ka një opinion të kualifikuar, do të thotë një opinion jo të mirë. Sipas ZAP-it ky opinion është dhënë për shkak të klasifikimit të keq të Buxhetit, shpenzimeve për mallra dhe shërbime, si dhe subvencione dhe transfero në vlerë prej 24,5 milionë euro, ishin klasifikuar keq si investime kapitale. Nga 24,5 milionë euro si shpenzim i klasifikuar keq janë 15,7 milionë euro ishin të shkaktuara nga Ministria e Financave, ndërsa 8,8 milionë euro...

KRYETARI: Profesor i nderuar!

Më fal! Po e bëj një ndërhyrje. Në qoftë se jam gabim, kërkoj falje. Se, më vonë mos e kemi këtë pikë të rendit të ditës. Është pika e 31-të. Lënda rekomandimet për raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014.

ALI SADRIU: Ajo është pika e radhës, zoti kryetar!

KRYETARI: Mirë! Vazhdoni, kërkoj falje!

ALI SADRIU: Sipas Ligjit të financave publike dhe përgjegjësive deficiti i parashikuar me buxhet ka qenë i parashikuar 2% të bruto-produktit vendor dhe nuk është dashur të tejkalohet. Ndërsa, Buxheti i vitit 2014 është dizajnuar mbi këtë pozicion dhe në këtë rast kemi tejkalim për 0,59%.

Shqetësues është niveli i ulët i implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e vitit paraprak. Zyra e Auditorit kishte dhënë 48 rekomandime për Qeverinë, 15 për Kuvendin, 3 për kryetarë të komunave dhe 3 për komunat. Po mundohem ta shkurtoj, që të mos ju lodh juve, por vërtet është një raport vjetor dhe duhet disa gjëra të thuhet.

Një çështje tjetër mjaft shqetësuese janë obligimet e papaguara të organizatave buxhetore, të cilat në vitin 2014 ishin 165,3 milionë euro. Prej tyre 148,2 milionë euro i takojnë nivelit qendror dhe 17,1 milionë euro niveli lokal. Kjo vlerë është bartur për pagesë në vitin 2015. Krahasuar me vitin 2013 obligimet janë rritur për 111,7 milionë.

Rritja e obligimeve krahasuar me vitin 2013 ishte rezultat i rritjes së obligimeve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, obligimet e papaguara dhe këtu kemi të bëjmë kryesisht me shpronësime. Në kuadër të auditimit të brendshëm ende ka organizata buxhetore, të cilat nuk i

kanë themeluar njësitë e auditorit të brendshëm dhe është imperativ i kohës, që ato të cilat janë të kushtëzuara me ligj, në bazë të numrit të punëtorëve, gjegjësisht nivelit të buxhetit të tyre, ato t'i plotësojnë këto vende.

Kemi edhe disa institucione buxhetore, të cilat komitetet e auditimit nuk u funksionojnë, ose funksionojnë jo drejtë. Sfidë kryesore mbetet zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal.

Në të gjitha fushat, në indikatorët janë vërejtur variacione të konsiderueshme, madje edhe në komuna me madhësi të përafërta. Komunat kanë tendencë të shfrytëzojnë maksimumin e fondeve nga grandet qeveritare, ndërsa të hyrat vetjake i bartin i bartin nga viti në vit.

Një fakt tjetër shqetësues është shpenzimi i madh për dreka zyrtare në disa komuna, siç mbetet edhe sistemi i shërbimit civil, ku janë vërejtur këto mangësi: mosrespektimi i kriterëve në kuadër të komisionit gjatë rekrutimit të stafit; avancimi i kuadrit në karrierë pa procedura të avancimit; pagesa e pjesës shtesë pa aprovim paraprak dhe pa dëshmi përkatëse për punën shtesë; pozitat e mbajtura nga ushtrues detyre më shumë se ç'parasheh ligji, do të thotë mbi gjashtë muaj dhe atë në pozita udhëheqëse; mos azhurnimi i dosjeve të personelit.

Të gjeturat kryesore të raportit të auditimit në fushën e prokurimit me theks të veçantë janë: planifikimi i dobët i prokurimit; mangësitë në përgatitjen e dosjeve të tenderit; gjatë ekzekutimit të pagesave kishin shmangie nga devijimi nga procedurat e Thesarit; ndarja e tenderëve me qëllim të shmangies së procedurave të hapura të prokurimit; dobësi në vlerësimin e tenderëve; vonesa në realizimin e projekteve dhe procedura të prokurimit më rastin e bashkëfinancimit. Auditimi i jashtëm i ndërmarrjeve publike, po ashtu është një brengë. Një çështje të cilën Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike ka vërejtur të sinjalizuar edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, ishte që në kuadër të Kuvendit duhet të themelohet njësi e auditorëve të brendshëm për auditimin e raporteve të agjencive, të cilat i japin llogari Kuvendit drejtpërdrejt, numri i të cilave kalon mbi 30.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ia ka adresuar Kryesisë së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit e ka aprovuar këtë rekomandim para një viti, ndërsa i njëjti nuk është zbatuar. Unë nuk e kuptoj pse Administrata e Kuvendit nuk e ka themeluar njësinë e auditimit të brendshëm. Është imperativ. Për çdo vit auditori e prezanton të tillë.

Dhe krejt në fund, këtë raport është dashur ta prezantojë Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, por ne e prezantuar me këto rekomandime, dhe kërkojmë që të miratohet si i tillë bashkë me rekomandime.

KRYETARI: Do të ishte mirë të dëgjojmë, se nuk po dëgjohej... I nderuar profesor, Administrata ka vërejtje. Ajo vërejtja juaj qëndron, Administrata ka vërejtje në Kryesi, ku jam edhe unë, se nuk e ka përkrahur për ta krijuar atë zyrë dhe s'ka financa. Kjo është arsyeja pse s'e ka krijuar Administrata. Domethënë përgjegjësia është politike, e jona, s'i kemi dhënë përkrahje. Pa buxhet janë, kjo është arsyeja, veç edhe për hir të publikut, për t'u ditur.

Profesor, e dëshironi sërish fjalën! Urdhëro!

ALI SADRIU: Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike në bazë të kërkesës së Zyrës së Auditorit, e përsëritur si kërkesë, ia kemi dorëzuar kërkesën Kryesisë së Kuvendit për ta themeluar njësinë e auditorëve të brendshëm. Kryesia e Kuvendit e ka miratuar, ne e kemi vendimin. Pse nuk është buxheti, për atë është dashur të kujdeset Administrata e Kuvendit, ta kërkojë buxhetin dhe ta ndajë atë buxhet.

KRYETARI: Atëherë, është çështje e interpretimit. Kam tjetër interpretim nga Administrata, por e lëmë tjetër herë, për arsye që të mos e bëjmë debat.

Safete Hadërgjonaj e ka kërkuar fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Këtu diçka nuk është në rregull me pikën e rendit të ditës, sepse në pikën e 28-të, të cilën ne po e shqyrtojmë, është shqyrtimi i raportit vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014. Raportin financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm e ka shqyrtuar Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe ka të bëjë vetëm me buxhetin dhe me shpenzimet, të cilat i ka pasur Zyra e Auditorit Gjeneral brenda vitit 2014.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike këtë material që na ka ardhur neve në kutia dhe që është i njëjtë me pikën e rendit të ditës, ka shqyrtuar, domethënë raportin financiar të Zyrës së Auditorit Gjeneral për vitin 2014.

Të nderuar deputetë,

Drejtimi i këtij institucioni të rëndësishëm për kontrollin e financave publike nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm, i përcaktuar në këtë detyrë në mënyrë jo të rregullt, për një kohë kaq të gjatë, reflekton edhe në punën e këtij institucioni. Në raportin financiar të Zyrës së Auditorit Gjeneral vërejmë, se mjetet në kategorinë paga dhe mëditje janë shpenzuar 100%, në mallra dhe shërbime janë shpenzuar 97%, në shërbime publike 80%, kurse investimet kapitale janë shpenzuar 59%.

Të nderuar deputetë, në materialin i cili na është ofruar nga Zyra e Auditorit Gjeneral, shohim se është bërë një transfero i mjeteve në vlerë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në kategorinë paga dhe mëditje, në vlerë 106 725 euro, që nuk është një transfero i tillë i rregullt dhe zakonisht Zyra e Auditorit Gjeneral për transfere të tilla u jep vërejtje pothuajse të gjitha institucioneve, të cilat bëjnë transfero të tillë të mjeteve, nga mallra dhe shërbime në kategorinë paga dhe mëditje dhe kërkesa për transfere të tilla ka mjaft, që i drejtohen edhe Ministrisë së Financave, por njëkohësisht shpeshherë ka ndodhur që këto institucione të pavarura t'i drejtohen edhe Komisionit për Buxhet dhe Financa, që sipas rregullit edhe nuk duhet të përkrahen.

Shpenzimi i mjeteve 100% të buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime në Zyrën e Auditorit Gjeneral është pothuajse i pamundur, kështu që për efikasitetin dhe rregullsinë e shpenzimeve të mjeteve në këtë kategori por edhe në kategoritë tjera, mbetet ta vërtetojë auditori i pavarur, i cili e auditon Zyrën e Auditorit Gjeneral.

Komisioni për Buxhet e ka shqyrtuar, rekomandimin e kemi për ta miratuar një raport të tillë dhe ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrahim këtë raport dhe i ftojmë deputetët ta miratojnë.

KRYETARI: Ali Sadriu e ka kërkuar sërish fjalën, se na është krijuar një konfuzion, edhe pse u bë ora 21:00 e ca. Urdhëro, e pastaj ti Arben e ke fjalën.

ALI SADRIU: Ka një konfuzion ndërmjet pikës 28 dhe pikës 31 të rendit të ditës. Kolegia që prezantoi, realisht i referohet pikës 31.

KRYETARI: Dëgjo, ne do ta bëjmë kështu, Arben, po e marr fjalën. Dy komisionet i kemi dëgjuar përnjëherë. Urdhëro, Arben, e ke fjalën!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm sa për sqarim, se po më duket se seanca është komplet në lajthitje. Po flasim për dy tema të ndryshme. Kështu që, të lutem orientoheni seancën dhe tregoni në cilën pikë të rendit të ditës saktësisht jemi, sepse këtu u fol për dy raporte. U fol për raportin e punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe u fol për raportin financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Raporti i punës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm shkon në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ndërsa raporti financiar i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm shkon në Komisionin për Buxhet dhe Financa, prandaj ka ndodhur kjo lajthitje.

Të lutem, sqaroja seancës se në cilën pikë të rendit të ditës jemi. Faleminderit!

KRYETARI: Unë do të mundohem, se ju jeni... mund të jenë edhe profesori edhe Safetja më ekspertë të lëmit, unë do të mundohem me këtë që e kam para vetes. Ne kemi një raport me rekomandime lidhur me Raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014, i cili është nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Cilën?... Unë u mundova ta them. Edhe pastaj kalojmë në atë pjesën. Ne i kemi kryer të dyja përnjëherë. Por, ta përfundojmë votimin në këtë, e cila është e Komisionit për Buxhet dhe Financa, pastaj në mbajmë në mend edhe të profesorit atë raportimin dhe i kompletojmë.

Shkojmë me raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Nuk ka kuorum. Janë vetëm 56 vota. Janë duke ardhur deputetët. Ju lutem, se duhet të futemi edhe njëherë në votim, për arsye se herën e parë 53 për, 3 abstenime.

A kemi kuorum, së pari? 64 deputetë janë aktualisht në sallë. Shkojmë edhe një herë. Jemi duke votuar për Raportin me rekomandim lidhur me raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash!

Atëherë konstatoj se me 62 vota për, 2 abstenime, asnjë kundër, Kuvendi e miratoi raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.

Po ndërlidhem menjëherë edhe me kërkesën e juaj, deputetë. Në qoftë se ka vërejtje ndokush, vetëm reagoni.

- Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014

Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen Financave Publike e ka shqyrtuar këtë raport vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e rekomandimeve së bashku me raportin vjetor të auditimit për vitin 2014.

Ndërsa, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Profesori Ali Sadriu tashmë e tha raportin. Profesor, keni edhe diçka? OK. Naser Osmani nga Komisioni për Buxhet dhe Financa e dëshiron fjalën. Për arsyetim nuk ka nevojë.

Atëherë, shkojmë drejt në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim të rekomandimeve lidhur me Raportin e auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.

Votojmë tash!

Konstatoj se me 64 vota për, 1 abstenim, asnjë kundër, Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike së bashku me Raportin vjetor të auditimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2014.

29. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane për vitin 2014

Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka shqyrtuar Raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integrimeve Evropiane për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014 dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimet për miratim.

Ftoj nënkryetarin e parë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputetin Ali Sadriu për arsyetimin e rekomandimeve.

ALI SADRIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike ka shqyrtuar dhe ka pasur dëgjim publik Raportin e auditimit për këtë temë. Ky opinion është opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është arsyeja pse i është dhënë theksi i çështjes, se në shënimin shpjegues pasqyra jokapitale është nënvlerësuar për 71 500 euro.

Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të vitit 2013 ka rezultuar me 9 rekomandime kryesore. menaxhimi kishte përgatitur një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve, por nuk e kishte mbikëqyrur.

Subvencionet, projektet të refuzuara nga Komisioni Vlerësues në shumë prej 17 674 euro, projekt i cili ishte refuzuar me urdhër të ministrit paguhet nga Ministria për Integritet, që është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Dobësi tjetër është në menaxhimin e burimeve njerëzore. Një zyrtar, edhe pse ishte në pushim të lehonisë, futet si anëtar i komisionit dhe është paguar për punën, që kinse e ka bërë, sepse realisht ajo ka qenë në pushim të lehonisë.

Dobësi tjetër është dobësi sistematike në menaxhimin e shpenzimeve. Përherë udhëtimet i kanë bërë me biznes klasë e jo me klasën ekonomike dhe rezulton, që në vend se të paguhet 3 722 euro për udhëtime, kanë paguar 9 444 euro.

Dobësi tjetër është shfrytëzimi i shërbimeve telefonike mobile pa ndonjë kriter të nënshkruara me operatorët ekonomikë. Shërbimet e këtij operatori shfrytëzohen vetëm për kabinetin e ministrit. Testimi i një mostre numri telefonik ka identifikuar se shpenzimet vetëm për një muaj të një telefoni kanë qenë 2 936 euro.

Një dobësi tjetër, që po ashtu cek raporti i Auditorit, është tejkalimi i shpenzimeve të akomodimit. Shpenzimet e akomodimit për tri udhëtime zyrtare ishin tejkaluar në vlerë prej 1 335 euro, për të cilat nuk kishte ndonjë shpjegim të vlerësimit të dhënë për këto shpenzime.

Dobësi tjetër, po ashtu në raport figuron planifikim jo i drejtë i shpenzimeve, që lidhet kryesisht me faktin e shpenzimeve të parapara në raport me atë që ka tejkalim për shumën 3 800 euro.

Komisioni vjen në përfundim me një rekomandim, të cilin kërkojmë që bashkë me raportin të miratohet dhe ai është: Ministria e Integritetit Evropiane në afat prej 3 muajve të hartojë Planin e veprimit për adresimin e të gjitha rekomandimeve të dala nga ky raport dhe të njëjtin t'ia dërgojë Kuvendit nëpërmjet Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani askush nuk është më i lajmëruar për diskutim.

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me votimin e rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Integritetit Evropiane për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014.

A i kemi deputetët në sallë? Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 58 vota për, 3 abstenime dhe 1 kundër Kuvendi miratoi rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Integritetit Evropiane për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014.

30. Shqyrtimi i rekomandimeve lidhur me raportin e auditimit të performansës për mirëmbajtjen dhe servisimin e veturave zyrtare, si dhe raportit të auditimit të pasqyrave financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014

Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin e auditimit të performansës dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimet për miratim.

E ftoj nënkryetarin e parë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputetin Ali Sadriu, për arsyetimin e rekomandimeve.

ALI SADRIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Opinion i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të vitit 2014 është se ato prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale. Është opinion i pakualifikuar.

Pavarësisht, linjat e llogaridhënies dhe komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta dhe raporteve me shkrim. Në shumicën e fushave kontrollet e brendshme nuk janë aplikuar në mënyrë efektive dhe nuk kanë arritur të parandalojnë gabimet sistematike gjatë vitit. Me theks të veçantë kontrolli ishte jo efikas në fushën e prokurimit, subvencioneve, menaxhimit e pasurisë, më tutje në pasqyrat vjetore të vitit 2013 Auditori i Përgjithshëm ka dhënë 15 rekomandime, mirëpo vetëm një prej tyre është adresuar dhe si pasojë mangësitë e njëjta vazhdojnë të përsëriten nga viti në vit.

Deri në fund të auditimit për vitin 2014 janë adresuar plotësisht 6 rekomandime, 7 janë pjesërisht kurse 2 nuk janë adresuar fare. Ministria kishte arritur ta shpenzojë buxhetin për 96%. Megjithatë, një pjesë e madhe e buxhetit ishte shpenzuar në tremujorin e fundit me përqindje 48% për mallra dhe shërbime dhe për investime kapitale 31%.

Volumi i madh i pagesave në fund të vitit rrit rrezikun për gabime dhe anashkalim të kërkesave ligjore. Vlera e obligimeve të papaguara ndaj operatorëve ekonomikë në fund të vitit 2014 ishte 1 138 212 euro. Marrë parasysh që buxheti është shpenzuar për 96% kjo tregon se ministria ka hyrë në obligime pa buxhet, duke e ngarkuar buxhetin pasues.

Kontrollet nuk ishin funksionale as në fushën e prokurimit, ku si pasojë mangësitë ishin evidente nga inicimi i procedurave për prokurim deri te kryerja e punëve sipas planit dinamik dhe kryerjes së pagesave.

Edhe menaxhimi i burimeve njerëzore në disa raste nuk ishte në pajtim me ligjet në fuqi. Ushtrues detyre në dy raste përtej afatit të lejuar me ligj. Kompensimet nga fondi i kuadrove jo në pajtim me rregull, po ashtu edhe avancim pa aplikimin e procedurave paraprake. Ky fond, vlen të ceket, se asnjëherë nuk është bërë transparent për Kuvendin.

Më tutje, nuk ishte respektuar rregullorja e brendshme për subvencionimin e subvencionit ishin dhënë vetëm në bazë të vendimit të ministrit, pa ndonjë marrëveshje paraprake me përfituesin. Edhe menaxhimi i pasurisë është fushë e cila kërkon përmirësim.

Kontrollet joadekuate në menaxhimin e automjeteve zyrtare kanë rezultuar me mungesa të informacioneve rreth evidencës së kaluar dhe justifikimit për shpenzimet e derivateve. Shitja e 16 automjeteve pa aprovimin paraprak nga Ministria e Financave dhe tjera. Inventarizimi i pasurisë nuk ishte bërë në afatin e caktuar kohor dhe stafi i larguar nga puna, dorëhequr, nuk ishin kthyer pasuritë me të cilat kishin qenë të ngarkuar.

Njësia e auditimit të brendshëm ishte efektive duke i ofruar menaxhmentit informata dhe vlerësime, se sa efektiv ishte kontrolli i brendshëm, se si funksionoi. Megjithatë menaxhmenti nuk kishte përgatitur plan veprimi për implementimin e tyre. Si pasojë e kësaj ngecjeje në implementimin e rekomandimeve të auditorit të brendshëm. Rregullorja me të cilën ata punojnë, duhet që brenda muajit ta njoftojnë Qeverinë për të gjitha këto çështje që këtu u ceken më lartë.

Nëse jeni të mendimit, ne e kemi edhe Këshillin Gjyqësor dhe Policinë, po e përfundojmë menjëherë, e kemi në radhë apo ndalemi te rekomandimet e tyre dhe pastaj dalim në tjetër. Rekomandimet i keni, unë nuk po e shoh të udhës t'i lexoj. Për këtë janë... 12 rekomandime i ka. Nëse jeni lodhur, e lëmë për ndonjë ditë tjetër, por rendi është që të shqyrtohen.

KRYETARI: Profesor, ne sonte do ta mbarojmë, vazhdo!

ALI SADRIU: Mirë! KQZ-ja ka aplikuar një procedurë efektive për menaxhimin dhe monitorimin e rekomandimit të Auditorit të Përgjithshëm. Bazuar në planin e përgatitur për veprim, si rrjedhojë ende një pjesë e rekomandimeve kishte mbetur pa adresuar plotësisht. Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me planifikimin dhe realizimin e pagesave, kategorizimin e tyre.

Është hera e parë, që është bërë një auditim i performansës në mënyrën e mirëmbajtjes dhe servisimit të automjeteve në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në Policinë e Kosovës, në Doganë dhe në Administratën tatimore.

Ju lutem, e di që jeni të lodhur, por dua ta tërheq vëmendjen, sepse këtu kemi të bëjmë jo me keqmenaxhime, siç rregullisht themi, por mund të jetë edhe keqpërdorimi. Shumë auto-pjesë të cilat janë furnizuar dalin se janë përtej 3-8 jo përqindje, por 3-8 herë më shtrenjtë, se sa çmimi që është në treg. Ndryshon çmimi nga Prishtina në Prizren, jo më pak se prej 3-8 herë çmimi i tyre.

Ju lutem, në raport i kemi të gjitha këto dhe janë dhënë rekomandimet për adresim dhe, që nga këtu unë ftoj të gjitha institucionet që merren me këto çështje, të jenë objekt i hulumtimit të tyre, sepse një diçka e tillë është e tejskajshme. Dhe, derisa nuk i luftojmë këto, ne nuk mund të flasim për një ulje të korrupsionit. Ky është një korrupsion. Nuk ka koment.

Nëse në treg e ke një çmim shumë transparent dhe ti furnizohesh me tetë herë më shtrenjtë, kjo nuk do koment dhe unë nuk do ta kisha zgjatur më shumë. Është shumë keq, që kjo ndodh në Këshillin Gjyqësor, ndodh në Polici, ndodh në Doganë, ka diçka edhe në Administratën Tatimore.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Qëllimisht nuk desha nga pika 28 deri këtu, pasi u bisedua për punën e Auditorit të Përgjithshëm dhe desha të ju kursej nga koha, por ajo që më shtyri të flas është e njëjta situatë me atë që folë paraprakisht të Projektligji për menaxhimin e financave publike, për faktin se ne si Kuvend i Kosovës vite me radhë po e marrim raportin e auditimit dhe të Auditorit të Përgjithshëm në shumë institucione dhe ministri të Kosovës, por, fatkeqësisht, të gjitha këto të gjetura që kanë gjetur shkelje dhe keqpërdorime financiare, e ne si Kuvend i Kosovës vetëm po i miratojmë si rekomandime, ndërsa s'kemi asgjë konkrete.

Është e papranueshme si një vend me një shkallë të lartë të papunësisë, me një varfëri rreth 40% të kemi shpenzime marramendëse luksoze, për të gjitha qeveritë e kaluara, pas luftës, brenda vetë kabinetit të ministrave, nga stafet e tyre shpenzime marramendëse luksoze, udhëtime jashtë vendit, keqpërdorime me derivate dhe të gjitha këto që i ka gjetur Auditori i Përgjithshëm vite me radhë ne si Kuvend i Kosovës vetëm i kemi miratuar, ndërsa në praktikë ende asgjë nuk është realizuar.

Unë mendoj se është koha e fundit që Qeveria aktuale ta marrë gjithë këtë përvojë nga vitet e kaluara dhe tash të dalë me veprime konkrete, mos të jetë vetëm në letra, sikur ai Projektligji për prokurimin publik, për menaxhimin e financave publike.

Të lutem, për gjetjet dhe shkeljet që i ka gjetur auditori Qeveria duhet të ndërmarrë hapa konkrete, të ndalë njëherë e përgjithmonë këto keqpërdorime dhe shpenzime marramendëse sepse Kosova nuk e ka atë luks të shpenzojë edhe në udhëtime, edhe brenda vetë stafit të ministrisë, me vetura luksoze dhe pothuaj se gati në çdo mandat kemi ndryshimin e veturave nga vetë ministrat dhe zëvendësministrat. Prandaj, është koha e fundit që Qeveria e Kosovës të reagojë dhe të gjitha këto gjetje të auditorit t'i ndërpresë njëherë e përgjithmonë dhe qytetari i Kosovës ta gëzojë vërtet atë që e meriton.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë tjerë të lajmëruar për diskutim dhe as përfaqësuesi i Qeverisë.

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me votimin e rekomandimeve të Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 60 vota për, 6 abstenime dhe 2 kundër, Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare për Ministrinë e Administratës Publike, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Policinë e Kosovës për vitin 2014.

35. Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Grupi Parlamentar Lista serbe e ka propozuar zëvendësimin anëtarëve në komisione parlamentare sinë vijim:

Deputeti Nenad Rashiq propozohet nënkryetar i dytë në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në vend të deputetit Slavko Simiq.

Deputeti Nenad Rashiq propozohet anëtar në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, në vend të deputetit Slavko Simiq.

Të nderuar deputetë, kërkohet nga ju që nëpërmjet një votimi me ngritje të dorës të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të Listës serbe. Urdhëroni!

Konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

32. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë propozim rekomandimet lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, deputetin Muhamet Mustafa, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër dhe zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, sipas planit të vet me prioritet ka marrë që t'i shohë problemet që janë në sektorët e ndryshëm prodhues dhe të kujdeset për rritjen e aftësisë së tyre konkurruese dhe përmirësimin e pozitës së tyre.

Gjithashtu i kemi marrë edhe kërkesat e aktorëve të interesuar dhe lidhur me këtë janë zhvilluar edhe aktivitete në Ministrinë për Tregti dhe Industri, edhe në Ministrinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe në Agjencinë për Ushqim e Veterinë.

Kemi pasur edhe vizita te prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit, kemi angazhuar edhe një ekspert të pavarur që t'i shohë në mënyrë neutrale të gjitha këto probleme dhe kemi pasur edhe një raport të NDP-së me financim të Zyrës britanike.

Në bazë të gjithë kësaj, ne kemi zhvilluar 3-4 herë debate në komision dhe dëgjim publik dhe kemi ardhur deri te rekomandimet, dhe ju e keni edhe arsyetimin për rekomandimet e unë do të kaloj nëpër rekomandime në mënyrë që të jemi të vetëdijshëm për çka po votojmë.

1. Rekomandimi i parë i drejtohet Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që të marrë masa të nevojshme për një mbrojtje sezonale të qumështit dhe produkteve të qumështit në periudhën 1 prill - 31 korrik, ose alternativë 1 maj - 15 gusht, duke vënë një taksë fikse sezonale, e cila do ta sigurojë një konkurrencë të barabartë ndërmjet industrisë së vendit dhe të prodhimeve nga importi dhe kjo do të duhej të ishte në pajtim me Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim, Rregullat e tregtisë së lirë, të cilat lejojnë që kur çrregullohet tregu e rrezikohet pozita e prodhuesve, të merren masa tjera.

2. Rekomandimi i dytë është që Qeveria e Kosovës përkatësisht ministritë përkatëse për një kohë të vendosin një akcizë në importin e produkteve të qumështit me yndyrë nga origjina bimore.

Disa vende fqinje e kanë këtë praktikë dhe ne konsiderojmë që përmes të kësaj një tregu të çrregulluar po i bëhet një konkurrencë edhe nga problemet e mosintervenimit të inspektorëve të tregut dhe Agjencisë së Veterinës që të sigurohet ekspozimi korrekt i këtyre produkteve në vende të posaçme në mënyrë që të mos prezantohet si djathë ose kaçkavall, ajo që është diçka krejt tjetër, dhe kjo mandej i rrezikon produktet vendore.

3. Asociacionet e biznesit dhe të konsumatorëve, në bashkëpunim me mediat duhet të zhvillojnë një fushatë vetëdijesimi për përparësitë e konsumimit të qumështit të freskët, sepse Kosova ka mjaft dhe prodhon bukur shumë qumësht të freskët por ekziston shprehia që të konsumohet më shumë produkti në ‘tetrapak’, edhe pse të gjitha analizat tregojnë se është më i shëndetshëm ky tjetri.

4. Rekomandohet që të sigurohen informata përkatëse lidhur me çmimin importues të qumështit me bazën e doganimit të produkteve të qumështit, sepse konsiderohet se edhe këtu ka nganjëherë probleme si dhe të rregullohen me dispozita ligjore apo akte nënligjore që të evitohet importi i produkteve me afat të shkurtër para skadimit. Ndodhë nganjëherë që importuesit të bien qumështin me çmime shumë të ulëta 5 ditë para skadimit dhe ajo mandej është një konkurrencë që krijon probleme për prodhuesit tanë.

Gjithashtu prodhuesit vendorë dhe asociacionet janë të zëshëm në prezantimin e problemeve të tyre, por janë indolentë në kompletimin e dokumentacionit që t’i provojnë ankesat e tyre, prandaj edhe ata duhet të kujdesen më mirë që t’i dokumentojnë këto.

5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet të sigurojnë statistika të sakta mbi prodhimin vendor dhe importin e qumështit për arsye se ne kemi pasur shumë probleme dhe vlerësimet janë që ne i plotësojmë nevojat me qumësht 50 deri 60% kurse një vlerësim tjetër është 80%. Domethënë në qoftë se nisemi me premisa të tilla shumë vështirë që ndërtojmë edhe politika konsistente.

6. I rekomandohet Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që të bëjnë një raport vlerësimi lidhur me efektet e politikave të subvencionimit të prodhuesve dhe

përpunuesve të qumështit me qëllim të arritjes së efekteve më të mëdha si dhe ta informojë Kuvendin lidhur me këtë raport.

Të dhënat tregojnë se përkundër subvencionimit në 2-3 vjetët e fundit, edhe numri i gjedheve, nuk është rritur as prodhimi i qumështit vendor, prandaj ne do të shohim se subvencionimi çfarë efekti do të ketë.

7. Të analizohen kushtet higjienike të shitjes së qumështit në tregun e gjelbër dhe të stimulohet ndërlidhja e prodhuesve të vegjël me industrinë e qumështit si dhe kalimi i fermerëve të vegjël në zonën e formalitetit.

8. Rekomandohet që asociacioni i biznesit të ketë sektor, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural, Ministrinë e Tregtisë e Industrisë dhe faktorët tjerë të hartojnë dhe zbatojnë një program masash integral për rritjen e aftësisë konkurruese të këtij sektori, për përmirësimin e cilësisë së produkteve, avancimin e marketingut, të dizajnit dhe tjera, dhe gjithashtu duhet të analizohet ndikimi i mënyrës së përlllogaritjes së TVSH te prodhuesit fermerë të qumështit.

9. Dogana e Kosovës dhe Agjencia e ushqimit dhe Veterinës, të ngrenë shkallën e performansës dhe të sigurojnë informata më të sakta për sasinë dhe cilësinë e mallrave të importuara.

10. I rekomandohet Qeverisë iniciimi i plotësim ndryshimit të Ligjit për prokurimin publik, për çka edhe sot u bisedua dhe besoj se këtu e kemi biseduar, do të thotë në vend që të thuhet ofertues vendor, duhet të thuhet prodhues vendor, sepse këtë çështje e lejon edhe Marrëveshja për Asociim.

11. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri do ta përcjellë zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe do ta informojë Kuvendin në një periudhë gjashtëmujore mbi aktivitetet dhe rezultatet në zbatimin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka asnjë diskutues tjetër! Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e ka kërkuar fjalën. Ju lutem!

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës, i ka dy ligje për të cilat obligohet që Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përkatësisht Departamenti i Tregtisë t'i implementojë me qëllim që të mbrojnë prodhimin vendor dhe të marrë masa sa herë që prodhimi vendor rrezikohet, dhe këto ligje janë Ligji për masat antidamping dhe masat kundërbalancuese dhe Ligji për masat mbrojtëse në importe.

Ndërsa sa i përket masës, taksës së veçantë që e keni rekomanduar si Komision Parlamentar që të aplikohet 2 herë në vit për të mbrojtur prodhimin vendor, kjo masë nuk parashikohet në asnjërin nga dy ligjet e lartpërmendura për faktin se kjo masë duhet të aplikohet në ato raste kur kemi të bëjmë me kosto të lartë të prodhimit vendor, kur kostoja është më e lartë se sa importi.

Të dy ligjet e lartpërmendura, ai për masat mbrojtëse dhe për masat kundër-balancues dhe antidamping për të cilat MTI është e gatshme që t'i implementojë dhe kemi bërë të gjitha matjet që gjatë vitit t'i implementojë nuk parashohin faktikisht që të implementohet kjo masë.

Masat mbrojtëse dhe masat kundër-balancuese përdoren vetëm në rastet kur industria e qumështit dëmtohet seriozisht përmes dy formave të importit, nëse kemi të bëjmë me çmimet damping ose në qoftë se kemi me rritje të madhe të importit, të cilat konsiderohen se po, e dëmtojnë prodhimin vendor.

Pra, as në ligjet aktuale, që janë në fuqi, por as situata e cila ka ndodhur gjatë verës që shkoi në këtë sektor nuk ka krijuar hapësirë për një masë të tillë të cilën ju e keni propozuar në pikën e parë sepse, bazuar edhe në të dhënat e ofruara nga Shoqata e Prodhuesve dhe e Përpunuesve të Qumështit, kostoja e prodhimit vendor e ofruar është më e lirë se importi.

Kosova në tre vjetët e fundit nuk është ballafaquar me rritje të madhe të importit por as me çmime të lira, më të lira se sa produkti vendor, andaj ne konsiderojmë se një masë e tillë është vështirë të aplikohet.

Ishte edhe rekomandimi tjetër, që ka të bëjë me rekomandimin e Tregtisë dhe Industrisë për ngritje të kapaciteteve, për mbledhje të statistikave, ne i nderuar kryetar i Komisionit, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shërbehet me statistika që i merr prej agjencive të tjera, të cilat i marrim prej Agjencisë së Statistikave, Ministrisë së Bujqësisë, të Doganave dhe ATK-së dhe nuk kemi kapacitete për mbledhje të statistikave.

Dhe një rekomandim tjetër, të cilin ju e keni, sa i përket Ligjit të prokurimit, duhet ta shohë Komisioni parlamentar se rekomandimin që e jepni për t'u dhënë përparësi produkteve vendore a është në harmoni me plotësim-ndryshimin e Ligjit të prokurimit të cilin sot vet më herët e keni kaluar. Do të thotë, të shohim e mos të votojmë rekomandime të cilat më vonë janë të pa implementueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni! Besim Beqaj e ka kërkuar fjalën, pastaj prapë profesori Muhamet.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Meqenëse u tha se rekomandimet janë votuar në mënyrë unanime, unë dua të them se unë si anëtar i këtij komisioni kam qenë kundër për rekomandimin 1 dhe 2, duke marrë parasysh se është në kolizion me ligjet tjera dhe respektivisht çfarëdo lloj mase mbrojtëse dhe çfarëdo lloj takste shtesë është ngarkesë për qytetarët, ky ka qenë arsyetimi thjeshtë i imi të cilin unë e kam bërë, ndërsa në pikën 2 kur flasim për vendosjen e akcizës në mallrat me yndyra me origjinë bimore, fokusi kryesor ka qenë se këto nuk janë cilësore dhe besoj që ka qenë gabim, sepse në shumë vende yndyrat bimore janë më të shëndetshme se sa yndyrat shtazore, prandaj edhe këtu kam qenë gjithashtu kundër këtij rekomandimi.

Sido që të jetë, unë besoj se rekomandimet të cilat bëhen në Kuvend duhet të kihet parasysh të mos jenë në kolizion me ligjet të cilat janë aktualisht në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Besim! Urdhëroni, profesor Muhamet!

MUHAMET MUSTAFA: Këtë që e tha zoti Beqaj, ai ka diskutuar, është e vërtetë çka ka thënë, por kur kemi votuar s'ka qenë aty, prandaj ne kemi votuar njëzëri, a ta që kanë qenë aty. Ky është sqarimi.

Unë mirëkuptoj edhe ministrin që thotë s'kemi ligje. Por, ky Kuvend dhe kjo Qeveri është me bë ligje të cilat na i lejon MSA dhe tregtia e lirë.

Në qoftë se industrinë njëqindvjeçare në rajon, brenda CEFTA-s dhe brenda MSA-ve që i kanë nënshkruar para neve dhe brenda të gjithave marrin masa të tilla të ngjashme edhe një industri emergjente e qumështit që është ndërtuar në Kosovë duhet me pas një qëndrim më mirëkuptues për prodhuesit, ju lutem.

Në qoftë se i kemi prurë do ligje të cilat krijojnë vështirësitë në sektor të caktuar, ne duhet të kemi një fleksibilitet më të madh. Kurse sa i përket se i ngarkojmë konsumuesit, këtu s'ka të bëjë me ngarkim të konsumuesve. Kjo është një taksë që paguhet në doganë. Dhe, nëse prodhuesit vendorë i rritin çmimet, atëherë në vendimin për futjen e saj, Ministria thotë, menjëherë hiqet kjo taksë.

Prandaj, janë çështje që ne duhet t'i shikojmë me sensibilitet më të madh. Në Kosovë kemi ndërtuar sektor emergjent të industrisë që i duhet një ndihmë që të rriten.

Nejse! Nëse është kjo punë për të qeshë, le të qeshet! Dhe, na derdhet qumështi vazhdimisht dhe unë mendoj se nuk është për të qeshur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Gëzim Kelmendi e ka kërkuar fjalën. Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

Ajo që më shtyri prapë të marrë fjalën, është pasi kemi të bëjmë me një temë mjaft të ndjeshme e cila e prek drejtpërdrejt shëndetin publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Pra, atë që dua ta ngre është shqetësimi i shumë veterinarëve të Republikës së Kosovës që ka të bëjë me kualitetin dhe përbërjen kimike të qumështit, që do të thotë se këtu i bie drejtpërdrejt përgjegjësia mbi prodhuesit kosovarë. Fatkeqësisht këtu është duke u bërë një abuzim me produkte të qumështit për faktin se shumë prodhues kosovarë nuk i respektojnë kriteret e terapisë së bagëtive të cilat janë prodhuese të qumështit. Do të thotë, ka shumë bagëti të cilat janë nën regjim të terapisë dhe ajo terapi, kryesisht terapi antimikrobijale dhe antibiotike e kërkon një afat kohor prej 7, 15 deri në 30 ditë që të eliminohet antibiotiku prej gjakut dhe qumështit, ndërsa prodhuesit kosovarë nuk e marrin për bazë fare këtë kriter, e qesin qumështin në treg dhe atë qumësht e përdorin qytetarët e Kosovës, do të thotë me antibiotikë dhe me terapi të ndryshme, prandaj në këtë mënyrë edhe rrezikohet drejtpërdrejt shëndeti publik i qytetarëve të Kosovës.

Unë mendoj se Komisioni duhet të marrë parasysh këtë kriter, të vlerësohet përbërja kimike e mikrobiologjike e qumështit dhe në këtë mënyrë të ruhet shëndeti publik i qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Përsëri Muhamet Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Ne nuk e kemi pasur këtë informatë që e prezantoi këtu zotëri deputet Kelmendi, por nëse kjo është e saktë, duhet ta vërtetojnë inspektoratet. Unë s'mund ta komentoj sepse ne asnjë informatë të tillë s'e kemi pas dhe mendoj që informatat e tilla duhet të bazohen në informata shumë të sakta në dokumente sepse paraqitja e tillë mund të krijojë shqetësim. E në qoftë se është e saktë, është për brengosje, por janë inspektoratet të cilat duhet t'i caktojnë.

Unë e thash por edhe një herë po e theksoj, në pikën 1 propozoj që të shtohet ky tekst “në pajtim me MSA-n dhe rregullat e tregtisë së lirë lidhur me situatat kur çrregullohet tregu dhe prodhimet vendore”. Ky është tekst që shtohet në pikën e parë.

KRYETARI: Edhe një herë, meqë jemi para votimit, Gëzim e do fjalën, se s'je lajmëruar? Urdhëro, Gëzim!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

Çdo respekt për profesorin nga komisioni dhe nuk dua ta replikoj, por unë mendoj se kjo është përgjegjësi kryesore e Komisionit. Komisioni duhet të punojë në mënyrë profesionale, duhet të ftojë në takime edhe shoqatën përfaqësuese nga veterinarët e Kosovës, pra Shoqata e Veterinarëve dhe ata kanë mjaft argumente për këtë shqetësim që unë e ngrita. Ata mua më kanë thënë drejtpërdrejt në sy, por hendi kepi është se nuk jam anëtar as i atij komisioni dhe as i ndonjë komisioni tjetër parlamentar, prandaj komisioni ka për detyrë të mbledhë fakte dhe argumente, të cilat janë të bollshme ngase veterinarët i posedojnë këto argumente.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka tjerë deputetë të paraqitur për ta marrë fjalën. Para se të votojmë për këto rekomandime të komisionit, unë lus edhe një herë profesorin Muhamet Mustafa ta shtojë atë pjesën të cilën e vëmë për votim, dhe edhe ajo futet, që shtënë përputhshmëri me MSA-në. Pra, urdhëro dhe të futet edhe kjo kur të votohet, që është për protokoll.

MUHAMET MUSTAFA: Domethënë, në pikën 1, në fund të tekstit, “importi”, vihet presje, në vend të pikës dhe shtohet teksti: “në pajtim me MSA-në dhe rregullat e tregtisë së lirë lidhur me situatat kur çrregullohet tregu dhe rrezikohet konkurrenca e barabartë e prodhimit vendor”.

KRYETARI: Faleminderit! Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 60 vota për, 1 kundër dhe 7 abstenime, Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me pozitën aktuale të prodhuesve dhe përpunuesve në industrinë e qumështit.

Këtu përfshihet edhe propozimi i profesorit!

33. Kërkesë të kryetarit të Komunës së Prishtinës për dhënien e pëlqimit për renovimin e sheshit “Adem Jashari” në Prishtinë

Ju njoftoj se Komuna e Prishtinës këtë vit ka planifikuar të bëjë renovimin e sheshit Adem Jashari që gjendet në mes të komunës së Prishtinës dhe Kuvendit të Kosovës dhe prona në të

cilën gjendet sheshi figuron si pronë e komunës së Prishtinës dhe e Kuvendit të Kosovës, andaj për të vazhduar me procedura e prokurimit, kryetari i Komunës së Prishtinës ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës një pëlqim formal për renovimin e këtij sheshi.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2015 ka vendosur që kërkesa të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.

Ky projekt bëhet në bashkëpunim me projektin DEMOS, të financuar nga Qeveria zvicerane.

Ganimete Musliu është paraqitur për fjalë! Urdhëro, e nderuar deputete! Pastaj fjalën e ka Ismet Beqiri!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Më vjen mirë që ka ardhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës kërkesa e kryetarit të Komunës së Prishtinës për dhënien e pëlqimit për renovimin e sheshit “Adem Jashari” në Prishtinë, por megjithatë me dhënien e këtij pëlqimi unë i rekomandoj Kuvendit sot që t’ia shtoj edhe kërkesën ose thjesht një rekomandim nga kjo seancë që në këtë shesh të vendoset edhe shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari.

Është e pakuptimtë, për të mos thënë që është e turpshme, që edhe 16 vjet pas lufte ne nuk e kemi Adem Jasharin në Prishtinë. Kemi shtatore gjithandej, por më meritoren nuk e kemi në Prishtinë, prandaj unë mendoj se është momenti i fundit që Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë një vendim të drejtë dhe Adem Jasharin ta sjellim në Prishtinë, sepse ai është meritore që ne sot marrim edhe këto vendime këtu.

Nuk dua ta zgjas më shumë, sepse e kishim një seancë të gjatë, mirëpo Kuvendit i rekomandoj që me dhënien e pëlqimit të citoj edhe këtë rekomandim që në sheshin “Adem Jashari” të vendoset edhe shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, në formulim të rendit të ditës, nuk qëndron kjo “rinovim” se rinovim nënkupton kur është diçka e ndërtuar dhe atje sheshi nuk ekziston i punuar por duhet të njoftoj kolegët e nderuar deputetë se një vendim i tillë i Kuvendit Komunal për ndërtimin e sheshit “Adem Jashari”, që bile ne e kemi quajtur “Sheshi i Lirisë” dhe kështu është në vendim “Adem Jashari”. Është diku në vitin 2004.

Kanë qenë disa probleme rreth objektit dhe ju e dini, aty është një hapësirë, trekëndëshi e disa probleme, që në kohën dhe për atë kohë po flas, ka pasur probleme prej UNMIK-ut dhe nuk ka mund të implementohet.

Ajo çfarë duhet ky Kuvend të vendosë, është shumë mirë që e jep pëlqimin jo vetëm formal, por esencial sepse me dhënë pëlqimin për një pjesë të tokës që është pronë e Kuvendit të Kosovës ia mundëson realizimin në një mënyrë, nëse ka pasur pengesa, edhe të natyrës të tillë, është kompetencë ekskluzive e Kuvendit Komunal do të thotë ta ndërtojë sheshin dhe ta vendosë gjithsesi shtatoren.

Unë po dua të ju siguroj se një vendim të tillë e përmban po ashtu në pikë të caktuar, edhe vendosjen e shtatores, sepse s'ka logjikë të quhet një shesh ose të emërtohet një shesh - "Sheshi i Lirisë" në këtë rast "Adem Jashari", e të mos e ketë edhe shtatoren.

Prandaj, ky Kuvend e ka këtë obligim, të japë pëlqimin për atë pjesë të pronës dhe Kuvendi Komunal i Prishtinës të implementojë një vendim që e ka për ndërtim të këtij sheshi të quajtur "Sheshi i Lirisë - Adem Jashari" dhe ku është po ashtu i paraparë edhe ndërtimi i shtatores dhe gjithsesi ne, si Grup Parlamentar dhe si Kuvend e përkrahim që të jepet kjo pjesë e pronës së Kuvendit të Kosovës dhe së bashku me pronën e Kuvendit Komunal të ndërtohet ky shesh dhe shtatorja e Adem Jasharit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë tjerë për fjalë. Ne duhet ta votojmë dhe vazhdojmë me votimin e kësaj kërkesë dhe nga kjo që deputetja e nderuar Ganimetja e tha dhe po ashtu edhe ish-kryetari i Komunës së Prishtinës, e tash shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Pra, ne kemi një vendim të Kuvendit Komunal për ngritjen e shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari në Prishtinë.

Mund ta votojmë dhënien e pëlqimit për rregullimin e sheshit "Adem Jashari" në Prishtinë dhe implementimin e vendimit të Kuvendit Komunal për ngritjen e shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari dhe ia shtojmë edhe këtë se për të gjitha shpenzimet, në qoftë se Komuna nuk mund financiarisht, i merr përsipër Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Urdhëroni! Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Meqenëse është fjala për një shesh, i cili krejtësisht, në mënyrë burimore ka një status të përcaktuar do të thotë sheshi Adem Jashari që nënkupton se ai duhet t'i përkushtohet heroit kombëtar, Adem Jashari.

Unë mendoj se ne duhet të kërkojmë që Kuvendi i Komunës së Prishtinës t'ia dorëzojë projektin e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ky Kuvend ta ketë një herë projektin dhe mbi atë projekt pastaj të vendosë lidhur me dhënien e sipërfaqes dhe që ky Kuvend mos të bien vendime paraprakisht për deri sa deputetëve nuk u dorëzohet projekti. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, e kemi një situatë, aq ka njerëz të mençur në Kosovë që për një muaj ditë e sjellin një projekt ideor dhe implementimin e bëjnë po ashtu institucionet e Republikës së Kosovës në afat shumë të shkurtër. Mirëpo, a të shkojmë drejt vendimmarrjes? Urdhëro, i nderuar zëvendëskryeministër! Ju lus për vëmendje!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë nuk kam më shumë çka t'i shtojë më tepër që e tha edhe kryetari i Kuvendit dhe kryeministri, pasi kryeministri ka qenë edhe kryetar i Prishtinës dhe e njeh shumë mirë këtë problematikë, por unë mendoj se duhet ta kemi një qartësim, duke e mbështetur plotësisht propozimin e Ganimetes: A është projekt investiv dhe për çka është apo është projekt i detajuar për "Sheshin e Lirisë - Adem Jashari"? Nëse është vetëm projekt, investim të ndryshojë diçka pllaka, është çështje tjetër. E nëse është projekt për rregullimin e "Sheshit të Lirisë - Adem Jashari", atëherë vërtet edhe Kuvendi duhet ta japë një mbështetje të fuqishme, por edhe Qeveria të marrë përgjegjësi të veta që i takojnë.

Prandaj, mendoj se do të ishte mirë që ne të japim një afat prej një kohe të caktuar Komunës së Prishtinës me na e sjell jo vetëm një platformë apo projekt ideor, por të detajuar, e pastaj ne të japim mbështetjen tonë dhe natyrisht edhe ministritë përkatëse që janë në këtë drejtim dhe të mbështesim fuqishëm.

Pra, këtu ne kemi një dallim se është kërkuar vetëm mbështetje për projektin, por nuk dihet për çka, duke i dhënë vazhdimisht mbështetje propozimeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A e do fjalën ndokush? Profesori e ka kërkuar fjalën, pastaj Arbeni! Urdhëro, profesor Sabri!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Unë po dua vetëm të sqaroj dhe të shoh se është shumë logjike kjo që e ka bërë Kryesia e Kuvendit.

Të gjitha idetë që u shpalosën këtu janë diskutuar në dy mbledhje të Kryesisë së Kuvendit, janë edhe tekste, dhe është strikt kjo që u tha sot këtu.

Jam unë që e kam kundërshtuar formulimin formal dhe kam kërkuar plan të detajuar - si do të zhvillohet? Ka ardhur një skicë deri te ne dhe ne e kemi zbritur problemin në Kuvend dhe mendoj se kemi bërë shumë mirë, sepse është Kuvendi i Republikës i cili duhet të marrë vendime të tilla.

Pajtohem që të shkohet edhe një hap më tutje, e që projekti të jetë edhe i skicuar deri në imtësi, edhe i realizueshëm, dhe si do të jetë. Nëse kjo bëhet shpejt, e unë nuk di sa u duhet kohë atyre, ata nëse janë përgatitur e kanë, atëherë të merret vendimi final.

Vërtet ne e kemi përkrahur si Kryesi, por kemi dashur të merret vendimi në Kuvend dhe mendoj që kemi bërë shumë mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që koha është të jemi më praktikë dhe në kuadër të praktikitetit të shohim mundësitë se si të trajtohet kjo çështje.

Mendoj se do të ishte mirë që të ngarkohet dikush me u marrë me këtë çështje nga Kuvendi, nga Qeveria dhe nga Komuna, në mënyrë që mos të hedhet topi - faji ndërmjet palëve.

Normalisht, Ministria e planifikimit dhe e ambientit mund të marrë përsipër prej anës së Qeverisë ose Qeverisa vendos dikë tjetër, komisioni adekuat prej Kuvendit mund të marrë përsipër dhe Komuna e Prishtinës kryetari si titullari më i lartë dhe bashkërisht të vijnë për Kuvendin me një propozim konkret që u propozua këtu dhe të veprohet më shpejt, sepse në raste të kundërta do të kishim hedhje topi - jo s'e solli Qeveria, jo Kuvendi, jo Komuna dhe nuk realizohet kurrë.

Nëse ka mundësi të shihet mundësia e ndërtimit të një delegimi të përfaqësuesve adekuatë për trajtimin e kësaj çështjeje mendoj se do të ishte ide e mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Bekim Haxhiu prapë e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, Bekim!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në vazhden e propozimeve që i tha edhe deputetja Musliu, por edhe në vazhden e kërkesave të qytetarëve që të kemi “Sheshin e Lirisë - Adem Jashari” në Prishtinë, me shtatoren e komandantit legjendar në Prishtinë, mendoj që për të dalë nga kjo situatë e rrugës është që të votojmë sot propozimin për dhënien e pëlqimit me një klauzolë që ky vendim do të hyjë në fuqi pas miratimit edhe të projektit detal në Kuvend. Do të thotë, mos të dalim me dilema të tilla se është refuzuar një kërkesë e tillë e Komunës së Prishtinës, por ne jemi që kjo të implementohet dhe që sot Kuvendi ta miratojë këtë me klauzolën shtesë që ky projekt, ky vendim do të hyjë në fuqi pas miratimit të projektit detal apo aprovimit të projektit detal nga ana e Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, nëse më kishit lejuar, të bëj një sqarim. Profesori Sabri Hamiti ka qenë insistues në mbledhjen e Kryesisë që vendimmarrja të kalojë nëpërmjet seancës. Këtë pastaj e kemi përkrahur të gjithë, propozimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe tani jemi te vendimmarrja me votim, në qoftë se ne vendosim të dalim me votim.

Pra, kemi mundësi që të votojmë për dhënien e pëlqimit për renovimin e sheshit “Adem Jashari” dhe ngritjen e shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari, ta votojmë këtë dhe Kuvendi Komunal i Prishtinës, ose na e krijon ne mundësinë si Qeveri, ose e autorizojmë Komisionin për Buxhet dhe Financa, sikur që e tha Arbeni, ose Ministrinë e Ambientit, por të merret drejtpërdrejt me mbarrëvajtjen e projektit dhe mos të jetë vetëm fjalë ose vendimmarrje e thatë këtu brenda Kuvendit.

Armendi e ka kërkuar fjalën, e pastaj Arbeni, dhe të formulojmë përfundimin për vendimmarrje.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Po mundohemi të kontribuojmë në formulim për atë çka po duam të bëjmë, për të qenë e realizueshme, sepse edhe vetë kërkesa e kryetarit të Komunës së Prishtinës është pak konfuze me

atë çka kërkohet dhe çka po dëshirojmë ne këtu si qëllim i përbashkët që ta kemi shtatoren e heroit Adem Jashari në Prishtinë.

Saktësisht, po thotë, ky renovim dhe po flet për një shesh, po flet për një renovim, nuk po flet për ndërtim të sheshit të ri. Është paraparë që të ndërrohen pllakat, të shtohet gjelbërimi dhe të rregullohen shtigjet e këmbësorëve dhe ndriçimi në shesh. Nuk po flet për gjëra tjera.

Dhe, cila është kompetenca e Kuvendit tash që të interferojë në pushtetin lokal për ndërtimin e shtatores? Do të thotë, le ta sqarojmë.

Nëse ne thirrëmi se është pronë e Kuvendit, atëherë le t'i mbetet përgjegjësi dhe financim i Kuvendit. Pra, duhet ta saktësojmë sepse po flasim këtu se është kërkesë për procedura të prokurimit, një investim i huaj, që pengesë është prokurimi për dhënien e këtij tenderi për renovim, është fjala, gjithmonë po flasim për renovim.

Prandaj, unë mendoj se prapë më përmbajtësore është që të kemi plan të detajuar, ta dijë Kuvendi çka po jep dhe çka po dëshiron të arrijë.

Ndërsa, nëse mbetemi kështu në formulime, ta quaj, vetëm për atë dëshirore, atëherë kjo do të mbetet e parealizueshme.

KRYETARI: Urdhëro, Arben! Pastaj e ka radhën Shpejtimi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Do të mundohem të jem shumë konkret. Mendoj se Kuvendi duhet të formulojë qëndrimin e vet për dhënien e pëlqimit për hartimin e projektit, dhënien e pëlqimit për hartimin e projektit për "Sheshin e Lirisë - Adem Jashari", ku do të jenë të përfaqësuar edhe përfaqësuesi i Qeverisë, edhe përfaqësuesi - Komisioni i Kuvendit për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Do të thotë, t'i kemi të tri palët që janë të interesuara për hartimin e projektit, jo për fillimin e punimeve por për hartimin e projektit, i cili pastaj do të aprovohet edhe në Kuvendin e Komunës së Prishtinës dhe në Kuvendin e Kosovës dhe kështu është një projekt i cili është projekt dinjitoz dhe projekt i cili zbatohet këtu, dhe mendoj se është një propozim i arsyeshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shpejtim Bulliqi e ka fjalën! Adem Salihaj e ka kërkuar fjalën, pastaj vazhdojmë me tjerët.

SHPEJTIM BULLIQI: Kryetar!

Unë po mendoj kështu: Meqë veç qenka kjo pronë e përbashkët pjesërisht e Kuvendit dhe pjesërisht e Komunës së Prishtinës, nuk është shumë e madhe ta marrë përsipër këtë projekt dhe ta realizojë vetë Kuvendi i Kosovës, në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe s'ka nevojë fare të jepet as pëlqim Komunës së Prishtinës dhe ta marrim përsipër këtë shpenzim, sepse ne edhe ashtu kemi bërë lloj-lloj shpenzimesh dhe edhe në qoftë se e bëjmë këtë shpenzim nuk bëhet nëmi.

KRYETARI: Faleminderit! Adem Salihaj e ka fjalën, dhe Arben Gashi prapë e ka kërkuar, por do të shkojmë drejt përkufizimit. Arbeni tërhiqet, dhe fjalën e kanë Adem Salihaj dhe Ganimetja...

ADEM SALIHAI: Unë desha ta sqaroj një çështje. Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka kërkuar vetëm pëlqim për ngastrën që është pronë e Kuvendit të Kosovës. Pra, s'ka kërkuar pëlqim për asnjë variant të projektit për rregullimin e sheshit. Në fakt, projekti i Komunës së Prishtinës, parashih siç e tha edhe Armendi, vetëm njëfarë lloji rregullimi të sheshit, jo ndryshim esencial të tij, por ndërrimin e pllakave dhe disa çështjeve tjera.

Pra, nuk parashihet një shesh që do ta mbajë emrin e komandantit Adem Jashari, që ta ketë edhe shtatoren e tij, që do të ishte krejt normale, e bile e domosdoshme, sepse një shesh që mban një emër të heroit nuk ka domethënie nëse nuk është hero i aty në formë të shtatores, bustit ose një forme tjetër.

Prandaj, unë mendoj që është në rregull propozimi i kryeministrit që ta kemi një afat shtesë dhe ta kërkojmë projektin e Komunës dhe nëse ai projekt i komunës nuk i plotëson ato kriteret për të cilat ne po flasim këtu, atëherë duhet të bisedohet me Komunën e Prishtinës dhe ky projekt të përmbajë ato elemente që i duhet një sheshi me emrin e komandantit Adem Jashari.

Përndryshe, sa për informim të deputetëve, për çështjet e përmendoreve dhe komplekseve memoriale është kompetent Komisioni për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, përkatësisht Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ganimete Musliu, dhe pastaj e ka fjalën edhe kryeministri!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Mendova se nuk do të jetë kaq shumë e komplikuar ky rekomandimi që e dhashë unë sepse tashmë sikur po gjuhet topi herë te Komuna e Prishtinës dhe herë te Kuvendi.

Në rend të parë, ajo çka s'po më pëlqen, nuk mendoj se duhet t'i ketë dy emra ai shesh, "Sheshi i Lirisë - Adem Jashari", por ta ketë emrin "Sheshi Adem Jashari".

Dhe, e dyta, për mua është shumë e pakuptimtë, kur dola ta them edhe rekomandimin që në Stamboll ta kenë shtatoren e Adem Jasharit, e të mos e kemi në Prishtinë. Prandaj, ka shumë pak rëndësi se kush e ndërton shtatoren. E rëndësishme është që ne ta kemi shtatoren e Adem Jasharit në Prishtinë, sepse u bënë 16 vjet pas lufte, dhe nuk e kemi.

KRYETARI: Të shkojmë në mënyrë të qetë! Zëvendëskryeministri, zoti Hashim Thaçi e ka fjalën dhe do të shkojmë drejt të një propozimi përfundimtar.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Kryetar!

Mendoj që Ganimetja pati të drejtë kur thotë ta kemi "Sheshin e Lirisë - Adem Jashari", por në të njëjtën kohë përsëri mendoj se duhet ta bëjmë vetëm një qartësim, a po e mbështetim projektin e Komunës për ndërrimin e pllakave, ndonjë hapësirë të gjelbërimit, ndryshimit diçka përreth Kuvendit këtu, pronës së Kuvendit. Do të thotë një projekt investues të Komunës së Prishtinës,

apo po e mbështetim një projekt që nënkupton investim, në kuptimin edhe të ndryshimit të dizajni, të pllakave, të gjelbërimit, të ndonjë peme dhe ndërtimit të bustit të komandantit legjendar Adem Jashari. Këtë duhet pasur të qartë.

Në anën tjetër, ne edhe më herët i kemi shikuar disa gjëra dhe duhet të kemi parasysh edhe diçka, dhe duhet të jemi shumë të hapur, se pse s'ka ndodhur deri tash fillimi i punimeve për ndërtimin e bustit të komandantit legjendar Adem Jashari, ka qenë edhe çështje e përmendores, ju të gjithë e dini, po kurrkush s'po e potencon, që është në mbrojtje të shtetit si trashëgimi çfarë është, prandaj duhet të ballafaqohemi edhe me këtë sfidë. Dhe, unë mendoj se do të ishte shumë me rëndësi që kurdo që ju mendoni të diskutojmë shumë hapur dhe të marrim një vendim përfundimtar si Kuvend, ose tek e fundit një propozim si Kuvend, po nëse e aprovojmë propozimin e Prishtinës është propozim nga ajo që u dëgjua këtu, dhe unë s'e kam lexuar, është projekt investiv të ndryshimit të pllakave, të një pjese të gjelbërimit, ndonjë pemë aty-këtu, ndonjë lule, dhe tërë kjo hapësirë përreth trekëndëshit. Se në disa dokumente ky shesh thirret "Sheshi i Lirisë" dhe në disa "Bratstvo Jedinstvo", zyrtare sot që e kemi. Kjo është e vërtetë. Po flas, çka është me ligj.

Dhe, nëse e marrim një vendim dhe ndryshojmë gjithçka, atëherë unë jam plotësisht në favor qysh të vendosë Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci e ka fjalën!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që, ajo që është për mua thelbësore është se të gjithë po pajtohemi me propozimin e deputetes Ganimete Musliu. E dha sqarimin edhe ish-kryetari i Komunës së Prishtinës se një vendim i tillë qenka dhe ne tash ne duhet vetëm të kërkojmë projektin e detajuar dhe jo të marrim vendim kuturu siç tha kryeministri nëse mbështetemi në kërkesën e Komunës së Prishtinës, e kemi shumë të qartë, për të bërë rinovim të sheshit. Aty nuk ka rinovim, por aty duhet të ndërtojmë një shesh të ri dhe të emërtohet shumë qartë: "Sheshi i Lirisë - Adem Jashari" dhe të ngrihet shtatorja e komandantit legjendar, Adem Jashari.

Prandaj ne sot duhet të kemi të qartë çka po vendosim. Unë nuk e jap votën për kërkesën e Prishtinës për rinovim. Vota ime do të shkojë, dhe i lus të gjithë deputetët të votojmë për projektin e detajuar dhe propozoj jo në këtë seancë por në një seancë të radhës kur ne të na vjen projekti i detajuar, ose e autorizojmë Ministrinë e Ambientit, Komisioni parlamentar mund të kyçet dhe nëse duam kërkojmë edhe prej Komunës së Prishtinës dhe kur të na vijë projekti i detajuar ne marrim vendim dhe e gjejmë edhe financimin.

Duhet të kemi edhe diçka të qartë, se këtu bëhet fjalë që këtë projekt për rinovim, sipas informatave që i kemi - sa janë të sakta, investimi apo donacioni është i një shteti tjetër, i Qeverisë Zvicerane, prandaj edhe këtë duhet ta kemi të qartë, se Qeveria Zvicerane mund të japë ndoshta për rinovim apo ndryshim të pllakave sikur që tha zëvendëskryeministri por nuk e jep për ngritjen e shtatore. Prandaj ne duhet të qartësojmë dhe marrim obligim që është e domosdoshme. Pajtohem që jemi vonuar dhe vërtet është e pafalshme për të gjithë ne, pa përjashtim, pse deri sot - 16 vjet pas luftës ne nuk e kemi shtatoren. E kemi sheshin, por nuk është punuar...

Prandaj, unë propozoj këtë ta lëmë për një seancë tjetër, të propozojmë formimin dhe përbërjen e komisionit dhe në seancën e ardhshme të na vjen projekti i detajuar dhe të marrim vendim, edhe ta përcaktojmë financimin. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri e ka kërkuar fjalën, pastaj e ka fjalën prapë Arbeni!

ISMET BEQIRI: Kryetar!

Unë u kërkoj falje kolegëve që e mora për herë të dytë fjalën lidhur me këtë çështje, pra të pronësisë, sigurisht të veçantë.

Jam plotësisht dakord që ne si Kuvend të autorizojmë komisionin e caktuar dhe të dimë se çka po do Komuna, e njëkohësisht edhe ne çka po duam. Dhe për mendimin tim, ne e dimë çka duam, të implementohet një projekt, një vendim që ekziston në Kuvend për sheshin, unë po e them, të lirisë Adem Jashari, se ka shumë domethënie ta quajmë të lirisë Adem Jashari se edhe kështu ekziston në vendim të Kuvendit të Komunës së Prishtinës. Dhe, kompetencë e komunës është me i emëruar sheshet, rrugët dhe këtë ju e dini, dhe ky emërim i sheshit Adem Jashari ekziston. Dhe për ne të gjithë këtu, për Komunën e Prishtinës është valid dhe zyrtar emërimi ose emërtimi: “Sheshi i Lirisë - Adem Jashari”, dhe kështu është vendimi e ne mund ta gjejmë dhe asnjë emër tjetër, unë ju siguroj, dhe çdo gjë që mund të thotë dikush... E tha zëvendëskryeministri më herët qysh është quajt, dhe është e vërtetë që është quajtur dhe kushdo që thotë diçka ndryshe eventualisht nuk qëndron.

Unë do ta gjej vendimin, do ta gjej pra edhe këtë vendim sigurisht, por ajo që ne sot mund të vendosim, për çka edhe jam plotësisht me kolegë... Po çfarë renovimi i pllakave, e lulishte aty me bë, prandaj të autorizojmë një komision, të kërkojmë projekt çka po do komuna me bë, a është i përfshirë dhe çka është e përfshirë, a është shtatorja dhe si do të duket sheshi përafërsisht dhe ne e japim pëlqimin për pronën, sepse fundi i fundit është kompetencë e Kuvendit të implementojë projektin kurse e jona është ta ndihmojmë, qoftë financiarisht, nëse ka nevojë, qoftë me tokën që e kanë kërkuar.

Kjo është ajo që mund të bëjmë sot, dhe jo me dhënë një pëlqim që tash, vërtet kur e shohim, është një kërkesë absolutisht për mua absurde për të thënë se vetëm do t'i bëjmë këto ndryshime, që janë kozmetike ato, dhe në thelb rinovimi i sheshit “Adem Jashari”. Po për atë shesh s'është implementuar dhe nuk ke çka rinovon aty, vetëm heqjen e pllakave.

Shkurt, kryetar unë kisha propozuar që ky Kuvend ta autorizojë një komision dhe ky komision konkretisht të vë kontakte me Komunën, të shprehë gatishmërinë e Kuvendit të Kosovës që të kontribuojë, por mundeni edhe ju vetë si kryetar i Kuvendit dhe të vëni kontaktin e tillë, dhe ndoshta është më së miri dhe ta thoni këtë qëndrim të Kuvendit të Kosovës se ne duam të dimë çfarë ju keni ndërmend të bëni si komunë me projektin e sheshit “Adem Jashari”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E do ndokush tjetër fjalën? Adem, të shkojmë drejt përfundimit, të lutem!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

U kërkoj falje të gjithëve! Jam plotësisht dakord, të formohet komisioni por edhe të afatizohet. Jo të jetë i pakufishëm, por të ketë një afat të caktuar kur do të na vijë propozimi i detajuar në Kuvendin e Kosovës.

KRYETARI: Kështu! Unë do të shkoja përafërsisht me këtë propozimin që e thatë ju. Foli edhe kryeministri, edhe zëvendëskryeministri dhe shumica e deputetëve.

Pra, një pjesë është pronë e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe një pjesë e Komunës dhe Kryesia jo rastësisht e ka sjell vendimmarrjen këtu dhe kryetari i Komunës ka pas qëllim të mirë, ka biseduar edhe me mua, dhe qëllimi ka qenë të mos e humbim atë donacionin për rregullimin e pllakave.

Pra kisha propozuar që ne ta autorizojmë kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe kryetarin e Komisionit për Ambient dhe të shkojnë të bisedojnë në Komunën e Prishtinës dhe ta qartësojnë këtë pjesë, e pastaj është çështja e projektit se si bëhet më tutje.

Pra, ne duhet të marrim një vendim se duam të ketë implementim të vendimit të Kuvendit Komunal të 2004 që shtatorja të jetë aty.

A mund ta përkufizojmë vendimmarrjen në këtë mënyrë sonte. Kemi biseduar aq gjatë për ta shtyrë sonte dhe ne kurrëgjë s'po ndryshojmë nga realiteti i cili është. Po e autorizojmë kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa... Ose, të mbetet vetëm çështje e fjalës që e konsumuam sa për të folur, gjysmë ore e kemi humbur për këtë çështje. Urdhëro Arben dhe ta përfundojmë!

ARBEN GASHI: Më fal, kryetar!

Mendoj se ideja po strukturoret. Mund të shtyhet vendimmarrja e Kuvendit me rekomandim që komisionet ta shqyrtojnë dhe të vijnë në Kuvend për të marrë një vendim final. Ne nuk marrim vendim për propozimin e Komunës, deri sa këto dy komisione të na e bien një rekomandim. Do të thotë, po e shtyjmë vendimmarrjen me rekomandim për t'u ngarkuar këto dy komisione për të marrë vendim. Faleminderit!

KRYETARI: Është Kryesia e Kuvendit dhe unë s'dua ta anashkaloj Kryesinë e Kuvendit, thjesht dhe për atë arsye unë dëshirova të shkojmë me hapa drejtpërdrejt të bisedojmë me komunën, prandaj thashë që të shkojnë komisionet përkatëse, edhe i buxhetit e financave, edhe i ambientit, edhe Ministri i ambientit ka mund të jetë, që të mos e politizojmë dhe unë besoj që ka mirëkuptim edhe nga Komuna e Prishtinës, por duhet gjetur modalitetin të kryhet. Adem!

ADEM GRABOVCI: Kryetar!

Ne jemi kah e rumbullakojmë çështjen. Komisioni për mua është i domosdoshëm, sepse të gjithë jemi të përcaktuar të bëjmë zgjidhje.

Pajtohem plotësisht kur i propozon dy komisione, shumë drejt, dhe ministri i Ambientit, por unë kisha propozuar që për të mos u anashkaluar Kryesia, pjesë përbërëse e këtij komisioni të jetë edhe vet kryetari i Kuvendit, dhe në seancën tjetër të na paraqitet një propozim konkret çka po duam dhe pastaj ne vendosim.

KRYETARI: Faleminderit! Kështu! A ka mundësi, Naser Osmani, Fikrim Damka dhe Nait Hasani të shkojnë nga Kuvendi, të bisedojnë me Komunën? Nuk do të shkojmë të gjithë të bisedojmë për projekt, por ta kemi një përfundim. Pra, t'i propozojmë 3 emra, e të mos shkojmë 100 veta, por ta përfundojmë çështjen. Pra, ju kisha lutur të shkojmë në vendimmarrje.

(Ndërhyrje)

E thërrasim, s'prish punë. Dëgjo, mos ta komplikojmë çështjen e komunikimit, kur ka pasur mirëkuptim. Pra, e keni parasysh, te kryetari i Komunës ka pasur mirëkuptim. Prandaj, Kuvendi duhet adresuar, së bashku me Komunën sepse është pronë e përbashkët, janë dy subjekte juridike të cilat duhet të komunikojnë njëra palë me tjetrën. Adem, urdhëro!

ADEM GRABOVCI: Kryetar!

Me rëndësi është të kemi një komision i cili do të na raportojë. Ne të gjithë kolegët, besoj që jemi dakord, në daç me këtë përbërjen e fundit, në daç të jetë edhe ministri, dikush prej Qeverisë, por nëse duam vetëm të Kuvendit i votojmë këta 3 emra që i propozuat dhe këta të obligohen në një afat të caktuar të na vijjnë e raportojnë për propozimin konkret.

KRYETARI: Atëherë, ata 3 dhe ministri, që thatë, janë 4. Urdhëro Mufera, se si ide e ke Stambollin.

MUFERA SHINIK: Faleminderit kryetar!

Për ta respektuar barazinë gjinore, edhe sponsorizuesen Ganimete e propozoj unë.

KRYETARI: Atëherë, ky komision t'i ketë 5 veta: Ganimete Musliu, Naser Osmani, ministri Ferid Agani, Fikrim Damka dhe Nait Hasani.

Pra, a ka mundësi që t'i autorizojmë si Kuvend të shkojnë dhe bisedojnë në Komunën e Prishtinës?

Të deklaroheni me ngritjen e dorës!

Pra, është aprovuar të bisedoni me Komunën e Prishtinës për ngritjen e monumentit për sheshin "Adem Jashari".

34. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 23 nëntor 2015 ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën plenare me 30 nëntor 2015 t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve. Ftoj kryetarët – përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që ta propozojë 1 deputet për kryetar të Komisionit dhe 1 deputet për anëtar të komisionit.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit kryetar!

Ky komision e ka rëndësinë shumë të madhe, duhet të ketë njerëz me përvojë. Përvojën e kanë fituar Xhevahire Izmaqi, si kryesuese dhe Zenun Pajaziti si anëtar i këtij komisioni, nga Partia Demokratike.

KRYETARI: Faleminderit! Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të LDK-së t'i propozojë 2 deputetë.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike për këtë komision e propozon Doruntina Maloku dhe Armend Zemajn.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” mbetet ta plotësojë komisionin. Grupi Parlamentar i AAK-së mbetet ta plotësojë. Lista serbe?

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poslanička grupa Srpske liste u ad hoc komisiji predlaže gospodina, našeg cenjenog kolegu Nenada Rašića. Hvala!

KRYETARI: “6+”?

MUFERA SHINIK: Faleminderit, kryetar!

Për këtë komision, “6+” e propozon deputetin Fikrim Damka.

KRYETARI: Grupi parlamentar “Nisma” duhet ta plotësojë!

Të nderuar deputetë,

Para se të procedojmë me votim, Kuvendi më nuk ka asnjë pikë të mbetur të rendit të ditës. Është me rëndësi për publik. Pra, nuk e kemi asnjë pikë të rendit të ditës në pritje për Kuvend. Asnjë! Ta keni parasysh!

Për këtë pikë të rendit të ditës, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota për, 2 abstenime dhe 1 kundër, Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kërkohej nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës të veprojnë në pajtim me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës.

Faleminderit! Opozita, le të vijën në Kuvend, këtu e ka vendin! Natën e mirë!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*